



Botues: Rolf Gollob, Peter Krapf dhe Wiltrud Weidinger
Përkthyes: "UEGEN"
Përgjegjës për botimin shqip: Astrit Dautaj

Të eksplorojmë të Drejtat e Fëmijëve

Nëntë projekte të shkurtëra për arsimin bazë

Rolf Gollob, Peter Krapf, Wiltrud Weidinger (Redaktorë)

Të ekplorojmë të drejtat e fëmijëve

Veprimtari mësimore për klasat 1 - 9



**Lehrmittelverlag
Zürich**

Redaktorë

Rolf Gollob, Wiltrud Weidinger
Qendra IPE – Projekte Ndërkombëtarë në Edukim
Universiteti i Zyrihut për Formimin e Mësuesve

Peter Krapf

Seminari Shtetëror për Didaktikën dhe Trajnimin e Mësuesve
Weinngarten, Gjermani

Autorë

Rolf Gollob
Peter Krapf

Ilustrimet dhe kopertina

Peti Wiskemann

Faqosja

Rene Schmid

©Këshilli i Evropës

Idetë e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e autorëve dhe jo doemos pasqyrojnë politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose të përcillet në çdo formë ose me çdo mjet, elektronik (CD-Rom, Internet etj.) ose mekanike, duke përfshirë shumëfishimin, regjistrimin ose çdo ruajtje e informacionit ose rikthim sistemi, pa lejen paraprake me shkrim nga Sektori i Botimeve të Informimit Publik dhe Drejtoria e Komunikimit (F-67075 *Strasbourg Cedex* ose publishing@coe.int).

Vëllimi V i Vëllimeve I-VI për EQD/EDNJ

Edukimi për Qytetari Demokratike dhe

Edukimi për të Drejtat e Njeriut në praktikën

Shkollore, njësi mësimore, koncepte, metoda dhe modele

www.coe.int/edc

Parathënie

Të gjitha vendet që kanë ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, kanë premtuar se do ta bëjnë këtë të njohur në vendin e tyre. Modelet e mësimave në këtë libër tregojnë si nxënësit mund të drejtohen për t'u bërë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre si dhe për t'i zbuluar dhe ushtruar ato.

Libri përmban të zhvilluar një projekt për çdo vit shkollor, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë (përafërsisht katër nësimi secili). Secili prej projekteve tregon si fëmijët dhe të rinjtë mund të eksplorojnë në mënyrë aktive të drejtat e fëmijëve dhe, përmes kësaj, t'i njohin ato.

Kjo qasje nuk përqendrohet në raste të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, por në zbulimin e të drejtave të fëmijës në mënyrë aktive gjatë mësimit. Në shumë veprimtari, kërkohet dhe zhvillohet pjesëmarrja e nxënësve, duke mbështetur, në këtë mënyrë, nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara, i cili u jep fëmijëve dhe të rinjve të drejtën e fjalës për të gjitha çështjet që ndikojnë në rrethanat e jetës së tyre. Me anë të kësaj, Konventa për të Drejtat e Fëmijës siguron mbështetje ligjore për atë që mësuesit e mirë kanë bërë gjithmonë: të dëgjojnë fëmijët dhe të marrin seriozisht pikëpamjet e tyre dhe të të rinjve.

Shumë elemente të këtij libri mund të gjenden në forma të ngjashme, në botime të ndryshme. Megjithatë, ky botim, për herë të parë, tregon si lexuesit mund të ndeshen me të drejtat e tyre hap pas hapi, përmes një kurrikule spirale. Ide qendrore e këtij manuali nuk është çështja "Kur mësove për të drejtat e fëmijëve", por "Si mësove për të drejtat e fëmijëve dhe në cilën klasë?".

Çdo vend që bën pjesë në Këshillin e Evropës vendos në mënyrë të pavarur për përkthimin e këtij dokumenti në gjuhët e ndryshme kombëtare.

Falenderime

Botimi i parë i këtij libri u bë i mundur si rrjedhojë e nismës së Institutit Pedagogjik në Banja Luka, Bosnje-Hercegovinë. Pilotimi në praktikë i draftit të parë të autorëve u krye në bashkëpunim me një grup mësuesish nga Evropa Jug-Lindore. Për ta shkojnë falenderimet tona të përziermëta. Këto përvoja pozitive çuan në përshtatjen e manualit për Këshillin e Evropës dhe në përkthimin e tij në vende të ndryshme.

Botimi i dytë u rishikua, u riorganizua dhe u testua në bashkëpunim të ngushtë me Shtëpinë Botuese të Zyrihut për Materialet Shkollore (Lehrmit-telverlag Zurich), Autoritet Arsimore Lokale të Zyrihut (VSA) dhe Universitetin e Formimit të Mësuesve (PH Zurich). Ne dëshirojmë të falenderojmë përkthyesen Sabrina Marruncheddu dhe lektorin Basil Schader për punën e kujdesshme. Për pilotimin në shkallë Evropiane, ne dëshirojmë të falenderojmë, së pari dhe mbi të gjitha, të gjithë nxënësit e Bosnjë – Hercegovinës, të Maqedonisë, të Serbisë, të Kosovës dhe të Svicrës. Me shpirtin e tyre kritik, ata garantojnë që nenet e Konventës të mos mbeten tigrat prej letre, por të shpalosin ndikimin e tyre në jetën e përditshme.

Zyrih dhe Weingarten, Mars 2014

Rolf Gollob, Wiltrud Weidinger dhe Peter Krapt

Përmbajtja

| | Page |
|--|------|
| Hyrje: Çfarë përmbajnë të nëntë kapitujt (Klasa 1-9) | 9 |

Pjesa 1: Veprimtari mësimore

| | |
|---|----|
| 1. Mësimi: Unë kam një emër – Ne kemi një shkollë..... | 11 |
| 2. Mësimi: Emrat jamë më shumë se shkronja! | 15 |
| 3. Mësimi: Me jemi magjistarë! | 21 |
| 4. Mësimi: Të drejtat tona-Thesari ynë | 27 |
| 5. Mësimi: Ne i bëjmë rregullat për klasën tonë | 31 |
| 6. Mësimi: Të drejtat e fëmijëve: një vepër arti! | 38 |
| 7. Mësimi: A është ajo që dua edhe ajo për të cilën unë kam nevojë? | 42 |
| 8. Mësimi: Të drejtat e fëmijëve- hulumtuar tërësisht | 46 |
| 9. Mësimi: Përse duhet t'i bindemi rregullave? | 51 |

Pjesa 2. Informacion ndihmës

| | |
|---|----|
| 1. Pyetje të bëra shpesh për Konventën për të drejtat e fëmijës | 60 |
| 2. Të drejtat e fëmijëve - pjesë e procesit të të drejtave të njeriut | 60 |
| 3. Si u krijuan të drejtat e fëmijëve? | 63 |
| 4. Të drejtat e fëmijëve:përjetimi, njohja dhe zbatimi i tyre | 64 |
| 5. Qasja pedagogjike: të mësuarit përmes shëmbullit | 65 |
| 6. Të mësuarit me bazë detyre : të mësuarit shoqëruar | 66 |
| 7. Mësimdhënia e të drejtave të fëmijëve. | 68 |
| 8. Por, kjo do të thotë që unë kam të drejtë të bëj një pushim, apo jo? | 70 |

Pjesa 3 - Dokumente dhe materiale mësimore

| | |
|---|----|
| 1. Versioni i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për nxënësit | 72 |
| 2. Grupimi i të drejtave të fëmijëve në katër dimensione | 77 |
| 3. Konventa për të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara | 79 |
| 4. Të drejtat e fëmijëve të ilustruara (kartat e të drejtave të fëmijëve) | 94 |

Hyrje:

Çfarë përmbajnë të nëntë kapitujt (Klasa 1-9)



Secili prej 9 kapitujve ka objektivat e të mësuarit të paraqitura me një tabelë që mbulon përmbajtjet kryesore, udhëzimet dhe pyetjet në ndihmë të mësuesit. Çdo tabelë tregon temat dhe përmbajtjen kryesore nga pikëpamja e mësuesit, ndërsa më poshtë janë pyetjet për nxënësit. Tabela ndihmon mësuesit të parashikojnë pyetjet e nxënësve, por mbi të gjitha, i ndihmon ata të kujtojnë objektivat e të mësuarit për çdo kapitull. Në tabelë bëhet dallimi ndërmjet tre dimensioneve: “ushtrimi”, “njohja” dhe “zbatimi” i të drejtave të njeriut. Broshura në vijim merr parasysh të tre këto aspekte: eksplorimi me bazë detyre, elementet njohës të fitimit të dijeve dhe zbatimi në jetën e përditshme.

Eksplorimi i të drejtave të fëmijëve fillon me klasën e parë dhe përparon, duke u bërë më kompleks drejt klasave më të larta të arsimit të detyruar. Objektivi i këtij manuali është pikërisht mënyra e arritjes së këtij objektivi.

Të nëntë kapitujt, të përbërë nga veprimtari mësimore, japin shembuj dhe sugjerime konkrete për zbatimin e të drejtave të fëmijëve për vitin e parë të arsimit fillor deri në vitin e fundit të arsimit të detyruar. Në këtë mënyrë, ai përdor modelin spiral të zhvillimit.



Elementet e mëposhtëm shërbejnë si udhëzime:

Hyrje e shkurtër me informacion për kuadrin konceptual dhe të të mësuarit përmes shembullit. Nëntë projekte klase (kapituj) për çdo klasë (1-9), të përbërë nga katër mësimet secili. Planifikim i detajuar i mësimet.

Të mësuarit me bazë detyre: çdo kapitull ka projektin si objektivi.

Mjedisi i të mësuarit është i hapur dhe bashkëpunues dhe përputhet me parimet e Edukimit për qytetari dhe për të drejtat e njeriut.

Një shtojcë me materiale të larmishme mësimore (duke përfshirë edhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës) dhe me informacione ndihmëse për të drejtat e fëmijëve.



Pjesa II dhe III ofron informacione ndihmëse dhe materiale mësimore që mund të gjenden në internet ose në tekste të tjera. Ideja ka qenë që të përgatitet një grupim burimesh të rëndësishme që mund të përdoren menjëherë më klasë, pa shumë kërkime shtesë. Përveç kësaj, tekstet e shkurtëra ofrojnë informacion të vlefshëm për prezantime, si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit. Të drejtat e fëmijëve, të ilustruara në fund të manualit, mund të përdoren në mënyra të ndryshme, në mësimet të ndryshme. Ato janë të përshtatshme dhe ofrojnë shumë mundësi për të mësuarit. Ato sigurojnë edhe një nxitës pamor për shumë veprimtari dhe mund të përdoren si karta kujtese ose karta kuptimi. Komentet nga mësuesit e vendeve të ndryshme tregojnë se, përveç qasjes eksploruese, mund të jenë të dobishme edhe elementet e të ushtruarit dhe të mësuarit jo përmendesh. Megjithatë, kjo nuk e zëvendëson trajtimin e çështjeve të rëndësishme dhe thellimin e të kuptuarit hap pas hapi.



Pjesa 1: Veprimtari mësimore

Kapitulli 1 (Arsimi fillor, klasa I)

Unë kam një emër - Ne kemi një shkollë

A Planifikimi

| | Pyetje kyç/tema mësimore | Detyra kryesore | Burimet |
|----------------|---|---|--|
| Mësimi 1 | Fëmijët mësojnë emrat e njëri-tjetrit | Fëmijët u prezantojnë të tjerëve emrat e tyre. | Fletë letre me ngjyra |
| Mësimi 2 dhe 3 | Sa të ndryshëm janë fëmijët në klasën tonë? | Fëmijët bëjnë lule për veten e tyre me fotot e tyre në mes. Me këto krijohet një tufë lulesh. | Fletë letre me ngjyra, një foto e çdo fëmije, dhe një fletë e madhe letre për tabelën. |
| Mësimi 4 | Çfarë dimë ne për njëri-tjetrin? | Reflektim në një raund plenar | Posteri i përfunduar |

B. Informacion dhe objektivat mësimore

Fëmijët bëhen të vetëdijshëm për larminë e madhe të emrave në klasën e tyre. Ata vlerësojnë se secili prej tyre ka një emër të veçantë që i dallon nga njëri-tjetri; ata kuptojnë se emri i tyre nuk mund të hiqet nga ta dhe i takon atyre si një ngjyrë.

Fëmijët kuptojnë se emra të ndryshëm qëndrojnë për personalitete të ndryshme dhe të gjithë së bashku, si një tufë lulesh e pasur dhe shumëngjyrëshe, formojnë një klasë. Si variacion ju mund të punoni me pikat e shiut ose vagonët e trenit, copat e një formuesi shprehjeje ose figure etj. Ajo çfarë duhet të bëhet gjithmonë e qartë është se: së bashku ne jemi më shumë se shumë të njëjlojtë. Ne bëhemi një tufë lulesh, një re ose një liqen, një tren, një melodi, një formues misterioz dhe kështu me radhë.

Fëmijët kuptojnë se klasa formon një komunitet të mësuar.

Fëmijët kuptojnë dhe vlerësojnë se shkolla është për t'i mbështetur ata, tani dhe në të ardhmen, si më vete edhe së bashku me të tjerët, për të mësuar më shumë e dhe në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të tyre.

Ata zbulojnë se shkolla nuk është vetëm një detyrë, por është krijuar edhe për shkak se fëmijët kanë të drejtë të shkojnë në shkollë dhe të arsimohen, dhe se prindërit, mësuesit dhe shteti garantojnë këtë të drejtë.



C. Pyetjet kryesore për reflektim për kapitullin 1

| Përjetimi i të drejtave të fëmijëve | Njohja e të drejtave të fëmijëve | Zbatimi i të drejtave të fëmijëve |
|---|---|--|
| <i>Mësuesi</i> | | |
| Si janë thjeshtuar parimet e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe në klasë? | Çfarë dinë fëmijët për të drejtat e fëmijëve? | Të mësojnë si të ndërmarrin veprime jashtë shkollës: çfarë kanë mësuar nxënësit për jetën e tyre në të ardhmen? |
| Shkolla është pjesë e jetës sonë; klasa është një mikro-komunitet në të drejtën e vet. Një simbol i fuqishëm për këtë është tufa e luleve. Nenet e përmendura në të djathtë mund të shprehen nga fëmijët në këto mësim. | Neni 7, 28 (shih shtojcën: Konventa për të Drejtat e Fëmijës e KB) | Fëmijët marrin pjesë në vendimin se ku do të vendoset buqeta me lule. |
| <i>Nxënësit</i> | | |
| Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në klasë? | Çfarë unë kam mësuar për të drejtat e fëmijëve? | Cilat janë veprimet që jam në gjëndje të ndërmarr tani? |
| Secili prej nesh është unik. Çdo fëmijë është i mirëpritur në klasë. Do të ishte për të ardhur keq nëse njëri prej nesh do të mungonte nga klasa jonë. Ne të gjithë kemi të drejta të njëjta | Ne kemi të drejta të veçanta si fëmijë: Ne kemi një emër që askush nuk mund të na e heqë nga ne (neni7). Ne kemi të drejtë të shkojmë në shkollë dhe të mësojmë se si të lexojmë dhe të shkruajmë. Pa shkollë askush nuk do të mund të gjejë një punë si i rritur. | Unë e di tani se ndihem më mirë si anëtar i një klase që është një grup i mirë. Unë do të përpiqem për të mbështetur fëmijët e tjerë në klasë që ata të ndihen po aq mirë sa unë. |

D. Procedura

Mësimi 1

Fëmijët ulen në formë rrethi. Në mes të rrethit, në dysheme, vendosen zemra prej letre me ngjyra të ndryshme. Çdo zemër mban emrin e një fëmije dhe ka një spango të lidhur me të. Është edhe një zemër që mban emrin e mësuesit mbi të, e vendosur në mes të rrethit.

Mësuesi i nxit fëmijët të marrin pjesë në një bashkëbisedim:

- A i dimë të gjithë emrat? Prezantohuni!
- Çdo fëmijë merr një zemër me emrin e një fëmije tjetër në të. Çfarë më pëlqen në lidhje me këtë fëmijë? Çfarë aktiviteti kam bërë unë deri tani me të? Pse do të më mungonte mua, nëse ai, nuk do të ishte aty?
- Pyetje të tjera që mund të përfshihen këtu janë: Çfarë mund të thotë një person tjetër për atë fëmijë, për shembull, një mësues, një anëtar i familjes, mashkull apo femër, vetë fëmija për vetveten, një mik, dikush tjetër në dhomë, në shkollë ose komunitet?

Pasi të gjithë fëmijët të shprehin idetë për fëmijët e pikturuar në zemrën e zgjedhur, ata ia dhurojnë atë fëmijës së pikturuar.

Çdo fëmijë e vendos zemrën e tij në gjoks dhe e mban atë si shenjë identifikimi gjatë mësimit. (Kjo mund të mbahet edhe gjatë mësimeve në vijim, deri sa të gjithë fëmijët të njohin mirë njëri-tjetrin).

Mësuesi drejton diskutimet përmbyllëse me pyetjet: "Përse kam marrë ngjyra të ndryshme dhe nuk kam përdorur vetëm një?"

Mësuesi u kërkon fëmijëve të sjellin një fotografi portret në mësimin tjetër. (Mësuesi mund t'u bëjë nxënësve foto dhe t'i printojë ato për mësimin e ardhshëm)

Mësimi 2 dhe 3

Mësuesi, duke paraqitur mësimin e dytë, u shpjegon nxënësve se: Çdo fëmijë në këtë botë është i ndryshëm. Çdo fëmijë është unik nga ngjyra, karakteri, personaliteti dhe emri i tij!

Fëmijët kanë edhe të drejta, që quhen "Të drejtat e fëmijës", të cilat janë pranuar pothuajse në çdo vend të votës. Këto të drejta përfshijnë për shembull:

- e drejta për të pasur një emër (neni 7 mund të lexohet me zë të lartë ose mund të përdoret një version i thjeshtuar i tij);
- e drejta për të pasur arsimim shkollor (neni 28).

Vetëm dikush që ka një emër mund të thërritet nga të tjerët. Pra, është e rëndësishme t'i dimë emrat!

Mësuesi e fton klasën në një diskutim për pikat e trajtuara deri tani dhe kërkon nga nxënësit të bëjnë pyetje ose të shprehin mendimin e tyre. Si përfundim: Të gjithë ne, me të gjitha cilësitë dhe llojet e ndryshme të karakterit, me gjithë ngjyrat tona, përbëjmë këtë klasë.

Ne bëjmë një fotografi të klasës sonë. Ajo nuk është e përbërë nga zemrat, por nga lulet e mbledhura dhe të vendosura në një vazo. Vazoja përfaqëson shkollën, ndërtesa e shkollës përfaqëson klasën tonë. Dhe të gjithë ne jemi lulet në vazo.

Mësuesi shpjegon fazat e aktivitetit:

Fëmijë bëjnë lulet e tyre.

Ata ngjyrosin petalet dhe ngjiten një foto të vetën në mes të lules.

Lulet janë vendosur së bashku për të formuar një tufë.

Tufa është e mbërthyer në një poster.

Në këtë mënyrë, ne kemi bërë një fotografi të klasës sonë me ngjyra.

Fëmijët mendojnë edhe një herë dhe përpiqen të interpretojnë pamjen e luleve në vazo. Mësuesi mbledh mendimet dhe idetë e tyre të larmishme. Fëmijët mund të zhvillojnë idetë e tyre lirshëm, duke iu referuar ndoshta pyetjeve të tilla si këto në vijim:

Çfarë nënkuptojnë lulet?

Çfarë nënkupton vazoja?

Pse është e rëndësishme që të kemi një emër?

Në varësi të kohës dhe materialeve që janë në dispozicion, ky aktivitet mund të përshtatet në mënyra të ndryshme, për shembull:

Nxënësit mund të vizatojnë, të presin dhe të zbukurojnë vetë lulet e tyre ose atyre u jepen për të prerë lulet dhe për t'i zbukuruar.

Mësuesi përgatit qendrën e lules, nxënësit krijojnë petale.

Fotot priten për t'u përshtatur në qendrën e lules.

Fëmijët që kanë mbaruar punën e tyre më shpejt, vizatojnë lule të tjera më të vogla pa foto.

Në fund, në një nga muret e klasës vendoset një afishe me titull “buqeta e klasës”. Vazoja tregon një version të shkurtër të të drejtave të fëmijëve të trajtuara nga fotot (Neni 7 dhe 28).

Mësimi 4

Vendosja:

Posteri është fiksuar në dërrasën e zezë ose në mur.

Nxënësit ulen në një gjysmë-rrethi të madh; në një klasë të madhe dy gjysmë-rrathë mund të jenë të nevojshëm. Të gjithë nxënësit duhet të kenë një pamje të mirë të fotos.

Nxënësit mendojnë për pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë më pëlqeu mua gjatë këtij aktiviteti?
- Çfarë kam mësuar?
- Çfarë di unë në lidhje me fëmijët e tjerë?
- Çfarë mësova për mësuesin?

Mësuesi udhëzon nxënësit që të ndajnë komentet dhe reagimet e tyre me njëri-tjetrin.

Përpara se të përfundojë, mësuesi u jep nxënësve më shumë informacion për Konventën e të Drejtave të Fëmijës. Ai u referohet, në veçanti, dy të drejtave të treguara në vazo dhe informon fëmijët për Ditën Universale të Fëmijëve (20 nëntor).

Në përfundim, ai diskuton me klasën nëse posteri duhet të ekspozohet në korridorin e shkollës apo në hollin e hyrjes. Klasa diskuton qëndrimet pro dhe kundër. Ku duhet të varet posteri në mënyrë që të gjithë vizitorët të mund ta shohin? Çfarë do të bëjmë nëse kur të na bashkohen fëmijë të rinj në klasën tonë?

Kapitulli 2 (Arsimi fillor, klasa 2)
Emrat janë më shumë se shkronja!

A. Planifikimi

| | Çështjet themelore/temat | Detyrat kryesore | Burimet |
|----------------|--|---|--|
| Mësimi 1 | Të gjitha emrat tanë! | Të gjithë fëmijët mësojnë më shumë për emrat e njëri-tjetrit (qasja ndërvepruese). | Letër A4 |
| Mësimi 2 | Si ma kanë vënë mua emrin tim? | Klasa mendon për arsyet se si i vihet emri një fëmije. | Shirita letre me fjalitë kryesore; seti i broshurave |
| Mësimi 3 dhe 4 | Të gjithë fëmijët kanë një histori për të treguar! | Nxënësit i japin njëri-tjetrit informacione në lidhje me jetën e tyre. Ata bëjnë një foto të vetes së tyre, në madhësi reale. | Informacion në lidhje me familjet e fëmijëve (detyrë shtëpie); një fletë letre tabele për fëmijë; lapustila dhe ngjyra |


B. Informacion dhe objektivat mësimore

Neni 7 i Konventës për të drejtat e fëmijëve mbron të drejtën e fëmijës për të pasur një emër. Emri i dytë ose i familjes shënon lidhjet e fëmijës me grupin më të afërt rreth tij. Megjithatë, emri i parë bën që fëmija të jetë një individ, krijesë unike në këtë botë.

Fëmijët duhet të jenë krenarë për emrat e tyre, dhe duhet të dinë se çfarë do të thotë emri i tyre, cilat shpresa shprehin ato dhe pse prindërit e tyre zgjodhën pikërisht këtë emër për ta.

Mësuesi duhet të kujdeset kur trajton këtë temë. Për gjithfarëlloj arsyesh, në klasë mund të ketë fëmijë që nuk jetojnë me prindërit e tyre natyralë ose që kanë humbur emrat e tyre kur janë detyruar të migrojnë ose të internohen. Mësuesi do të duhet të jetë i ndjeshëm dhe dashamirës kur i afrohet fëmijëve të tillë.

Në këtë kapitull “Fëmijët janë më shumë se shkronja” lidhet me kapitullin 1 “Unjë kam një emr-ne kemi një shkollë”. Për këtë arsye, ky mësim vazhdon në linjat e mësimit paraardhës, por mundet të qëndrojë plotësisht edhe si një mësim më vete.



C. Pyetjet kryesore për reflektim në orët e të drejtave të fëmijëve

| Përjetimi i të drejtave të fëmijëve | Njohja e të drejtave të fëmijëve | Zbatimi i të drejtave të fëmijëve |
|---|---|---|
| <i>Mësuesi</i> | | |
| Si janë thjeshtuar parimet e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe në klasë? | Çfarë dinë fëmijët për të drejtat e fëmijëve? | Të mësojnë si të ndërmarrin veprime jashtë shkollës: çfarë kanë mësuar nxënësit për jetën e tyre në të ardhmen? |
| Shkolla është pjesë e jetës sonë; klasa është një mikro-komunitet në të drejtën e vet. Fëmijët bëhen të vetëdijshëm për identitetin e tyre duke ditur emrat e të gjithë fëmijëve të tjerë dhe duke u thirrur me emrat e tyre nga të gjithë personat në klasë. Të drejtat e përmendura në të majtë përjetohej gjatë kësaj njësie në klasë. | Neni 7, 8, 12, 13 28 (shih shtojcën: Konventa për të Drejtat e Fëmijës e KB) | Fëmijët marrin pjesë në vendimin se ku do të vendoset posteri i tyre. Ndoshta duhet të sigurohet hapësirë, kështu që kjo pyetje mund të duhet të diskutohet me mësuesit e tjerë, asistentët e shkollës, apo drejtorin e shkollës. |
| <i>Nxënësit</i> | | |
| Çfarë unë kam mësuar për të drejtat e fëmijëve? | Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në klasë? | Cilat janë veprimet që jam në gjëndje të ndërmarr tani? |
| Unë kam parë se të gjithë fëmijët e tjerë dhe mësuesi më kanë vënë re. Ata të gjithë kanë dëgjuar për mua, dhe tani të gjithë e dinë emrin tim. Me emrin tim unë jam veçantë, dikush që është i ndryshëm nga gjithë të tjerët. Unë i di emrat e të gjithë fëmijëve të tjerë në klasë. Unë di diçka në lidhje me jetën e tyre. | Ne kemi të drejta të veçanta si fëmijë: Ne kemi një emër që askush nuk mund të na e heqë (neni 7). Si fëmijë, unë kam tashmë historinë e jetës sime, një jetë që është e ndryshme nga ajo e përjetuar nga fëmijët e tjerë. Kjo do të jetë gjithmonë pjesë e vetes sime (Neni 8). Unë mund të kem mendimin tim dhe mund të them atë që mendoj dhe të gjithë fëmijët e tjerë mund të bëjnë po kështu (nenet 12, 13). | Kur takoj dikë në një shesh lojërash ose diku tjetër, unë do t'i pyes ata për emrat e tyre dhe do t'u tregoj atyre emrin tim. |

D. Procedura

Mësimi 1: Të gjithë emrat tanë!

Mësuesi ullet në një rreth me nxënësit e tij ose të saj. Fëmijët janë të ulur në karriget e tyre. Ata mbajnë rripa letre që tregojnë emrat e tyre, me shkrim të theksuar. Edhe mësuesi ka një rryp letre me emrin e tij. Secili thotë me radhë emrin e tij. Nxënësit duhet të kuptojnë dhe të dinë emrat e fëmijëve të tjerë. Kjo mund të bëhet me anë të lojërafve të ndryshme, disa prej të cilave vlen edhe në raste kur nxënësit e njohin njeri-tjetrin.:

Fëmijët japin emrat e tyre dhe ato të fëmijëve të ulur në të majtë dhe në të djathtë të tyre, "Emri im është ..., dhe në të majtën time është ulur..., dhe... është ulur në të djathtën time."

Identifikoni disa nga tipare që nxënësit tuaj i kanë të përbashkëta, për shembull, ngjyra e xhinseve ose të fundit të tyre, inicialet, syzeve, ngjyra e flokëve të tyre etj., dhe formoni një enigmë: "..., ..., dhe ... të gjithë kanë diçka të përbashkët. Kush mund të më thotë se kush është ai?" Përsëriteni këtë disa herë.

Mblidhni të gjitha kartat me emrat në to. Të gjithë fëmijët, me rradhë, tërheqin nga një kartë, pa lexuar emrin. Ata të gjithë tregojnë kartat e tyre. Kush është në gjendje të vendosë regullin në këtë konfuzion, për shembull, duke i vënë emrin e saktë çdo fëmije?

Hipja në autobus: në mënyrë të rastësishme, një fëmijë fillon me deklaratën e mëposhtme: "Unë jam Ana dhe unë po hip në autobus. "Fëmija ngjitur me të vazhdon: "Unë jam Sandra dhe unë po hipi në autobus me Anën. "Fëmija ulur pranë Sandrës vazhdon në të njëjtën mënyrë, duke përfshirë të gjithë fëmijët e mësipërm, " Unë jam Tomi dhe kam hipur në autobus së bashku me Anën dhe Sandrën." Mbani të njëjtën rregull në të cilin fëmijët janë ulur në rreth, pasi kjo do t'ua bëjë më të lehtë të kujtojnë emrat. Vazhdoni në këtë mënyrë, derisa të gjithë fëmijët të jenë ulur në autobus. Kujdesuni të mos vini në siklet fëmijën që harron një emër dhe i lini fëmijët të ndihmojnë njëri-tjetrin.

Mësuesi përfundon mësimin duke zhvilluar një dialog mësimor. Pyetjet e mëposhtme shërbejnë si stimuj për nxënësit:

A më pëlqen emrin im dhe, nëse po, pse?

Ndonjë herë emrat shkurtohen në pseudonime ose ndryshohen. A më pëlqen apo nuk më pëlqen emri im i ri, dhe pse?

Por, nga njëherë është e rëndësishme që të kesh një emër tëndin. Çfarë do të ndodhte nëse të gjithë në shkollë do të kishin të njëjtin emër apo nuk do të kishin emër fare?

Mësimi 2: Si e kam marrë unë emrin tim!

Mësuesi ka përgatitur shirita letre në të cilat ka shkruar fjalitë e mëposhtme (natyrisht, është i mundur çdo lloj variacioni: ndryshim, heqje ose shtim i më shumë deklaratave etj):

| |
|--|
| Është e rëndësishme që të kemi një emër. |
| Emri im - Ky jam unë. |
| Nga emrat tanë, ne njohim veten dhe njëri-tjetrin. |
| Emri ynë thotë diçka për ne (gjinia, gjuha, vendi i origjinës) |
| Duke pasur një emër, një fëmijë bëhet anëtar i një shteti. |
| Duke zgjedhur një emër të caktuar, prindërit shpesh shprehin dëshira, shpresa dhe ndjenja të caktuara |

Mësuesi i lexon klasës deklaratat e shkruara në një rrip letre, e vë atë përmbys dhe i kërkon fëmijëve të shprehin kuptimin me fjalët e tyre.

Pastaj ai shpërndan fletët e punës të cilat nxënësit do t'i mbushin si detyra shtëpie (shih Burimet më poshtë). Mësuesi bën pyetjet e mëposhtme, për t'u siguruar që çdo fëmijë i kupton ato:

- Kur kam lindur?
- Në çfarë ore?
- Cila ditë e javës ishte kur linda?
- Si ishte moti?
- Ku kam lindur?
- Kush ishte i pranishëm kur kam lindur?
- Sa i gjatë kam qenë dhe sa peshoja?
- Pse më vunë këtë emër të veçantë?
- Çfarë kuptimi ka emri im?
- Ku mund të gjendet emri im, çfarë kuptimi ka emri im në gjuhë të tjera?

Mësimet 3 dhe 4:

Të gjithë fëmijët kanë një histori për të treguar!

Fëmijët ulen në një rreth dhe i tregojnë njëri-tjetrin për atë ç'ka kanë folur me prindërit e tyre. Mësuesi i inkurajon ata për të shqyrtuar disa nga pyetjet në thellësi.

Për shembull, ai përgatit një listë në dërrasë, që tregon në çfarë ore të ditës kanë lindur të gjithë fëmijët e klasës. Ndoshta do të lindë një model interesant. (Interneti mund të shërbejë për të gjetur ditët e javës në të cilën kanë lindur fëmijët)

Sigurisht, do të ishte shumë interesante nëse disa fëmijë do të mund të përgjigjeshin në pyetjen e fundit, dmethënë, të japin arsyet e prindërve të tyre për vënien e emrave të tyre. Për të shpjeguar kuptimin e emrave, mësuesi mund të përdorë një fjalor, internetin (një punë e veçantë mund të ishte gjetja e emrave evropianë)

Në vijim, fëmijët marrin detyrën në mënyrë individuale për të krijuar një poster për veten e tyre dhe për të përfshirë në të të gjithë informacionin që lidhet me veten e tyre. Në varësi nga aftësitë e të shkruarit,

mësuesit mund t'i nevojitet të ndihmojë disa prej nxënësve.

Nëse është e mundur, fëmijët duhet të vizatojnë një foto të vetes së tyre, në madhësi natyrale. Kjo mund të bëhet në këtë mënyrë: një fëmijë shtrihet poshtë mbi një fletë letre të shtruar në dysheme, duke zgjedhur një pozicion të caktuar, për shembull, duke vrapuar ose duke qëndruar me krahë të hapura. Një tjetër fëmijë skicon figurën. Modeli që del pritet dhe ngjyrosset me bojëra uji ose bojëra poster. Mund të priten balona thëniesh dhe të ngjiten te figura për të treguar fëmijët që prezantojnë veten: "Emri im është..." ose, në figurë, mund të ngjitet një fletë letre me të dhënat personale.

Fëmijët shpenzojnë mësimin e katërt duke kompletuar këto postera.

Në fund, posterat ose figurat paraqiten para klasës dhe nxënësit diskutojnë se si do t'i paraqesin posterat në ndërtesën e shkollës. Mësuesi i ndihmon në marrjen e vendimit.

Burimet: Fletë pune për nxënësit
Emri im ka historinë e vet – Çfarë do të përpiqem të zbuloj

| |
|---|
| Kur kam lindur unë? |
| Në çfarë kohe? |
| Cila ditë e javës ishte? |
| Si ishte moti? |
| Ku kam lindur unë? |
| Kush ishte i pranishëm kur kam lindur? |
| Sa i madh dhe sa i rëndë isha? |
| Pse më vunë këtë emër të veçantë? |
| Çfarë kuptimi ka emri im? |
| Ku mund të gjendet emri im, çfarë kuptimi ka emri im në gjuhë të tjera? |

Kapitulli 3 (Arsimi fillor, klasa 3)
Në jemi magjistarët!

A. Planifikimi

| | Çështjet themelore/temat | Veprimtaritë kryesore | Burimet |
|----------|---|--|--|
| Mësimi 1 | Çfarë mund të bëjë një njeri i zakonshëm me një problem? Çfarë mund të bëjë një magjistar? | Nxënësit mësojnë për të dalluar mes zgjidhjeve realiste dhe magjike për probleme të llojeve të ndryshme. Ata vizatojnë pamjen e një personi të zakonshëm ose një magjistari. | Dërrasa e zezë është e përgatitur që më parë për të mbledhur idetë e fëmijëve; vizatimet; shiritin ngjitës; fletë letre me madhësi A 4, shkumësa me ngjyra |
| Mësimi 2 | A mund të gjejmë ne zgjidhje nëpërmjet diskutimit tonë? | Në një diskutim plenar nxënësit mësojnë të dallojnë mes zgjidhjeve të mundshme dhe të pamundshme për problemet e përditshme. | Figurina letre të prera; shkumësa me ngjyra |
| Mësimi 3 | Çfarë zgjidhjesh mund të gjej? Si mund të ndihmoj? | Nxënësit përpiqen të gjejnë zgjidhje për situata të vështira në jetën e tyre të përditshme. Ata paraqesin zgjidhjet e tyre me aktrim dramatik. | |
| Mësimi 4 | Si mund të tregojmë zgjidhje për problemet me një aktrim dramatik? Çfarë kemi mësuar ne në këtë mënyrë? | Nxënësit përsëritin si të luajnë rolin e tyre dhe e aktrojnë atë në klasë. | Përgatitje për rolin që luan nëse kërkohet |

B. Informacion dhe objektivat mësimore

Fëmijët shpejt bëhen të vetëdijshëm për faktin se shumë gjëra janë jashtë kontrollit të tyre. Ata janë subjekt i vendimeve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre, por ata janë shpesh në gjendje për të ndikuar mbi to. Por fëmijët janë gjithashtu të aftë për të udhëtuar në një botë të imagjinatës së tyre. Kjo duhet të jetë një përpjekje për të shpëtuar nga bota e vërtetë. Bota e imagjinatës është edhe sfera ku krijohen plane të reja, përvojat mund të reflektohen dhe ku një person mund të fitojë forcë para se të kthehet në botën e vërtetë.

Për projektin e mësimdhënies në kapitullin 3, ne sugjerojmë vizatimin në kapacitetin imagjativ të fëmijëve dhe duke u dhënë atyre mundësinë për të transformuar idetë e tyre në zgjidhje për jetën reale, në lidhje me të drejtat bazë të fëmijëve.

Fëmijët e përfytyrojnë veten magjistarë. Ata duhet të përpiqen të gjejnë, si magjistarë, një zgjidhje për një problem të komunitetit dhe ta vënë në praktikë (për shembull të përqendrohen në një problem të mjedisit të pastër në klasë dhe në oborrin e shkollës).



Ky kapitull mbështetet në komunikimin në klasë. Prandaj është me rëndësi të madhe që fëmijët të ulen në vende të përshtatshme. Kur komunikojnë në grupe, të gjithë pjesëmarrësit duhet të ulen ballë për ballë. Përpiquni të shmangni uljen me fytyrë nga dërrasa e zezë e të gjithë nxënësve. Ulja në rreshta i vë fëmijët që janë në skaje në dizavantazh. Përkundrazi, fëmijët duhet të ulen në një rreth ose rreth një tavoline.

Mësuesi vendos kur t'i zhvillojë mësimet e këtij kapitulli, megjithatë, ne sugjerojmë javën e dytë dhe të tretë të nëntorit, pasi përputhet me Ditën Universale të Fëmijëve (shihni edhe sugjerimet në fund të mësimet të katërt).

C. Pyetjet kryesore për reflektim në orët e të drejtave të fëmijëve

| Përjetimi i të drejtave të fëmijëve | Njohja e të drejtave të fëmijëve | Zbatimi i të drejtave të fëmijëve |
|--|--|--|
| <i>Mësuesi</i> | | |
| Si janë thjeshtuar parimet e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe në klasë? | Çfarë dinë fëmijët për të drejtat e fëmijëve? | Të mësojnë si të ndërmarrin veprime jashtë shkollës: çfarë kanë mësuar nxënësit për jetën e tyre në të ardhmen? |
| Shkolla është si një mikro-shoqëri. Nxënësit diskutojnë probleme së bashku dhe gjejnë zgjidhje për problemet e tyre në klasë dhe në jetën e tyre. Ata bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, jo vetëm me mësuesit. | Neni 13, 14, 28, 31 (shih shtojcën: Konventa për të Drejtat e Fëmijës e KB) | Nxënësit mendojnë për situata të jetës reale dhe fillojnë të vënë në jetë zgjidhje për problemet që janë të vërteta për vetë ata dhe për të tjerët. |
| <i>Nxënësit</i> | | |
| Çfarë unë kam mësuar për të drejtat e fëmijëve? | Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në klasë? | Cilat janë veprimet që jam në gjëndje të ndërmarr tani? |
| Ne kemi dëgjuar njëri tjetrin dhe kemi zbuluar se disa nga dëshirat dhe problemet tona mund të jenë shumë të ndryshme. Ne kemi parë se si mund të gjejmë së bashku zgjidhje për probleme të tilla. | Unë di se fëmijët kanë të drejta të veçanta, të drejtat e fëmijëve. Unë e di se ka një Ditë Universale të Fëmijëve më 20 nëntor. Unë po mësoj të shoh dallimin mes mrekullive dhe zgjidhjes së problemeve në jetën reale. | Unë e di që njerëzit e tjerë dhe unë kemi të drejta, por unë duhet të bëj diçka për t'u siguruar që këto të drejta të mbrohen, si të miat ashtu edhe ato të njerëzve të tjerë. Gjetja e një zgjidhje për një problem nuk është gjë e lehtë për të bërë. Ne nuk mund t'i zgjidhim të gjitha problemet menjëherë. Disa nga dëshirat tona nuk do të përmbushen për një kohë të gjatë |

D. Procedura

Mësimi 1

Mësuesi i mblodh nxënësit në një gjysmërrethi, përballë dërrasës së zezë, për t'i mundësuar çdo fëmije një pamje të mirë të tabelës.

Mësuesi vizaton dy persona në dërrasë: një grua ose burrë të zakonshëm dhe një magjistar. Edhe fëmijët, në çifte, duhet të vizatojnë dy figura dhe të përpiqen t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme, së bashku:

- Cili është ndryshimi ndërmjet një njeriu të zakonshëm dhe një shtrige ose magjistari?
- Çfarë bën personi i zakonshëm në situata të caktuara, për shembull, kur nuk ka bukë në

shtëpi?

- Çfarë bën magjistari në të njëjtat situata?
- Për të nxitur imagjinatën, mësuesi mund t'u kërkojë nxënësve të identifikojnë situata të tjera të mundshme dhe i ndihmon nëse është e nevojshme. Më pas, ai i mbledh të gjitha përgjigjet e nxënësve në një listë në dërrasë, duke përdorur tabelën e mëposhtme:

| | Person i "Zakonshëm" | Shtrigw ose magjistar |
|------------------------------|----------------------|-----------------------|
| Situata 1 (p.sh. Uria) | | |
| Situata 2 (p.sh. Varfwria) | | |
| Situata 3 (p.sh. Mërzia) | | |
| Situata 1 (p.sh. Ditëlindja) | | |
| Etj. | | |
| | | |

Fëmijët ndajnë dhe diskutojnë zgjidhjet e problemeve të ndryshme. Për të zgjeruar diskutimet mund të përdoren pyetjet e mëposhtme:

A mund të shihni ndonjë zgjidhje ose ide të bërë nga një magjistar i mirë apo i keq? Si do të vepronte një magjistar i mirë në këtë raste. Po një magjistar i keq dhe dinak?

Kur keni dëshiruar për herë të fundit të kishit qenë magjistar, dhe çfarë donit të ndryshonit atëherë?

Cila është dëshira juaj më e madhe tani? Si do ta përmbushnit kwtw dwshirw nwse do tw kishit fuqi magjike. Si do ta pwrmbushnit kwtw dwshirw nw realitet?

Etj.

Mësuesi i nxit nxënësit të dalin përpara me idetë e tyre dhe u jep të gjithëve mbështetje pozitive. Ai shpjegon se klasa do të flasë për magjistarët disa herë në mësimet e ardhshme dhe u jep nxënësve si detyrë të shohin për foto të magjistarëve në revista ose libra dhe, nëse është e mundur, t'i sjellin ato në klasë. Fotografitë dhe librat duhet të shfaqen në një ekspozitë të vogël.

Në pjesën e mbetur të mësimet, fëmijët duhet të përfundojnë vizatimet e tyre të magjistarëve dhe personave të zakonshëm dhe t'i ngjyrosin ato. Këto vizatime mund të përfundojnë edhe si detyrë shtëpie

Mësimi 2 (kohëzgjatja rreth ½ mësimi)

Hyrje: duke parë dhe komentuar ekspozitën, nëse ajo është bërë shumë e madhe për t'u paraqitur.

Mësuesi nxit nxënësit për të sjellë foto dhe libra mbi magjistarët dhe për të përfunduar vizatimet e tyre.

Fëmijët tani ulen në një rreth. Mësuesi u tregon atyre që, disa vite më parë, janë shkruar disa të drejta të veçanta që merren me jetën dhe gjendjen e fëmijëve. Këtu rekomandojmë leximin e Deklaratës së të Drejtave të Fëmijës (1959), të cilën mësuesi mund ta përshtatë dhe ta shkurtojë sipas nevojave.

Mësuesi duhet të bëjë përshkrimin sa më të thjeshtë, për t'u kuptuar nga nxënësit, me shembuj nga jeta reale dhe të lidhura me përvojat vetjake të nxënësit.

Për të përmbyllur, mësuesi mund të hartojë një listë me çështjet kryesore së bashku me fëmijët dhe ta shkruajë atë në dërrasën e zezë. Nxënësit mund ta shkruajnë listën në fletoret e tyre të punës.

Fëmijët duhet të kuptojnë këtë:

Të drejtat e njeriut ekzistojnë.

Këto të drejta janë të vlefshme për çdo fëmijë, edhe në vendin tuaj.

Qëllimi është të aftësohen fëmijët të rriten në mënyrë të plotë e të shëndetshme (kjo përfshin zhvillimin e tyre: fizik, moral, psikologjik, mendor dhe atë social).

Fëmijët duhet të gëzojnë si lirinë edhe respektin e dinjitetit të tyre personal.

Në hapin e parë fëmijët duhet të kuptojnë këtë parim. Integrimi i shoqatave dhe kontributeve të fëmijëve, mësues i shpjegon konceptet dhe se si janë të lidhura ato.

Pastaj, ai paraqet rreth 20 figurina djemsh dhe vajzash që ai ose nxënësit i kanë prerë më parë. Këto figura ndahen në katër grupe prej pesë në dysheme. Mësuesi sqaron se çdo grup ka një problem të veçantë:

Grupi 1 po përjeton një rrezik për mirëqenien fizike (ushqim, shëndet etj.).

Grupi 2 po përjeton një rrezik për mirëqenien shpirtërore (diskriminim, e drejta e privatësisë etj.)

Grupi 3 po përjeton një rrezik për shanset arsimore (e drejta për arsim, për informacion etj.)

Grupi 4 po përjeton një rrezik për mjedisin shoqëror (familja, shokët).

Pas këtij shpjegimi, klasa ndahet në katër grupe, ku secili është përgjegjës për një nga grupet e figurave prej letrave. Udhëzimi: Merrni pesë figurat tuaja dhe shkruani në secilën një fjali për atë që kanë nevojë, çfarë u mungon dhe për çfarë vuajnë. Përdorni fjalitë në vetën e parë. Për shembull, grupi mirëqenia shpirtërore mund të shkruajë fjali të tilla si "Njerëzit qeshin me mua, sepse jam i huaj". Une vuaj sepse nuk kam shokë", I jam i trishtuar sepse njerëzit qeshin me mënyrën si eci" etj.

Fëmijët punojnë në katër grupe, pastaj i prezantojnë rezultatet te njeri-tjetrin dhe diskutojnë për të gjetur shembuj për grupet e tyre të figurave (p.sh. Për çfarë tjetër mund të mendoni ju?) dhe, mundësisht, të shkruajnë më shumë në to.

Në vijim, grupet bëhen magjistarë dhe shtriga dhe dëshirojnë të ndihmojnë fëmijët të përjetojnë të drejtat e fëmijëve. Figurat që janë shkruar shihen një nga një. Për secilën bëhet pyetjet e mëposhtme:

Lexoni çfarë është shkruar për fëmijët: për çfarë vuan?

Si mund të ndihmojë magjistari ose shtriga? Çfarë mund të bëjnë që fëmija të ndihmohet sot, nesër dhe në të ardhmen?

Çfarë mund të bëjë vetë fëmija për t'u ndier më mirë?

Çfarë mund të bëjnë njerëzit për fëmijët, pa ndihmën e magjistarëve dhe shtrigave?

Kjo veprimtari mund të bëhet me të gjitha klasën ose, në varësi të madhësisë së klasës, mund të ndahet edhe në dy grupe.

Mësimi 3

Mësuesi përsërit dhjetë të drejtat më të rëndësishme të fëmijëve. Sot ne shohin situata konkrete në jetën reale, ku të drejtat luajnë rol të rëndësishëm. Mësuesi motivon fëmijët të mendojnë për vende dhe situata të jetës së përditshme që janë të vështira për ta, për shokët e klasës ose për shokë të rinj ose të vjetër në shkollën e tyre. Kjo veprimtari zhvillohet në çift. Si stimul dhe përkrahje mbledhur me shkrim kontributet e nxënësve mund të përdoret modeli i mëposhtëm:

Vendet

klasë;
oborrin;
rrugës për në shkollë.

Situatat

grindje dhe mosmarrëveshje;
nuk ka drekë;
ke harruar për të bërë detyrat e shtëpisë;
të kanë rrahur;
nuk ke asnjë mik;

nuk ke një xhaketë të ngrohtë dimrit;
nuk ke pajisjet e duhura sportive.

Udhëzime: Ne tani do të marrim rolin e magjistarëve të vegjël dhe do të ushtrohemi të gjejmë zgjidhje për këto situata.

Në raundin plenar ne shqyrtojmë dy ose tre situata dhe zgjidhje. Pastaj, nxënësit formojnë grupe të vogla dhe zgjidhin një situatë, me të cilën ata duan të merren, duke ofruar edhe një zgjidhje. Çdo grup -duhet të luajë një lojë me role poër të paraqitur situatën dhe zgjidhjen.

Mësuesi mbështet grupet, bën sugjerime nëse është e nevojshme dhe dëgjon. Për mësimin e katërt, nxënësit mund të përsosin skenat me kostumet si dhe pajisjet e tyre ndihmëse.

Mësimi 4

Mësuesi udhëzon nxënësit për lojën me role: afatet kohore, kritere të qarta vëzhgimi për shikuesit (p.sh. a është e kuptueshme situata e paraqitur? Ai janë aktorët bindës? Etj.) Udhëzimet shkruhen në tabelë.

Nxënësit luajnë lojën (problemi dhe zgjidhja). Koha duhet të vëzhgohet mne rreptësi. Pas çdo akti ose loje duhet të zhvilohet një diskutim. Projekti mund të hartohet për të kujtuar, për shembull, ditën botërore të fëmijëve dhe fëmijët mund të përgatisin edhe një veprimtari me komunitetin (informacion për një klasë tjetër për të drejtat e fëmijëve, komunikim krijues për të drejtat e fëmijëve, p.sh. një afishe në korridorin e shkollës etj.)

Kapitulli 4 (Arsimi fillor, klasa 4)
Të drejtat tona – thesari ynë
A. Planifikimi

| | Çështjet themelore/temat | Detyrat kryesore | Burimet |
|--|---|---|---|
| Mësimi 1 | Pse kemi nevojë për të drejta të veçanta të fëmijëve? | Nxënësit njihen me projektin "kutia e thesarit", dhe ata diskutojnë se si ta planifikojnë dhe ta kryejnë atë. | Objektet që mund të përdoren për të përfaqësuar disa të drejta të fëmijëve (demonstrim dhe frymëzim); kartat e të drejtave të fëmijëve. |
| Mësimi 2 | Kutia e thesarit tim personal – Diçka e veçantë | Nxënësit dekorojnë kutitë e tyre të thesarit dhe i përgatitin ato për "thesaret e të drejtave të fëmijëve të tyre". | Çdo fëmijë sjell një kuti prej metali, druri ose kartoni në shkollë; kopsa me ngjyrë, copa rrobe, etj.; ngjitës dhe gërshërë |
| Mësimi 3 (pas një intervali prej disa javësh) | Kutia ime e thesarit, kutia jote e thesarit! | Nxënësit shfaqin kutitë e tyre të thesarit duke organizuar një ekspozitë në tavolinat e tyre. | Kuti thesari i nxënësve (me përmbajtjen) |
| Mësim 4 (pak para 20 nëntorit) | Si mund të organizojmë një ekspozitë? | Fëmijët ekspozojnë thesaret e tyre dhe kutitë e thesarit për të gjithë fëmijët e tjerë në shkollë për t'i parë. | Nxënësit gjejnë një dhomë apo vend për ekspozitën e tyre |

B. Informacion dhe objektivat mësimore

Nxënësit fitojnë njohuri më të thella për të drejtat e fëmijëve. Gjatë një periudhe më të gjatë kohore, ata studiojnë përmbajtjen dhe qëllimin e këtyre të drejtave, duke u përpjekur që të lidhin çdo të drejtë me një objekt që mund të ilustrojë ose ta simbolizojë atë. Çdo fëmijë do të gjejë një zgjidhje të vetën. Për ta bërë këtë, fëmijët duhet të kuptojnë dhe interpretojnë nenet në fjalë.


Nga këndvështrimi i teorisë së mësuarit, detyra i lejon nxënësit të organizojnë në mënyrë aktive proceset e tyre të të mësuarit, të cilat rritin në mënyrë të konsiderueshme shanset e tyre për të përjetuar një rritje të qëndrueshme të dijes.

Çdo nxënës prodhon kutinë e vet të thesarit.

Nxënësit identifikojnë veten më fort me të drejtat e fëmijëve, si intelektualisht edhe emocionalisht.

Ky është një projekt klase, i cili mbulon një periudhë të gjatë kohore dhe mund të nxisë, në mënyrë të përsëritur, nxënësit për të ndarë dhe diskutuar idetë e tyre.

Me rastin e Ditës Universale të Fëmijëve (20 nëntor), mund të organizohet dhe të hapet një ekspozitë e kutive të thesarit të nxënësve në ndërtesën e shkollës. Kjo përbën një nxitje shtesë dhe do të motivojë nxënësit e vegjël për të bërë diçka të ngjashme, një ose dy vjet më vonë. Koha më e përshtatshme për të filluar projektin është fundi i shtatorit dhe mesi i tetorit.



C. Pyetjet kryesore për reflektim në orët e të drejtave të fëmijëve

| Përjetimi i të drejtave të fëmijëve | Njohja e të drejtave të fëmijëve | Zbatimi i të drejtave të fëmijëve |
|--|---|---|
| <i>Mësuesi</i> | | |
| Si janë thjeshtuar parimet e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe në klasë? | Çfarë dinë fëmijët për të drejtat e fëmijëve? | Të mësojnë si të ndërmarrin veprime jashtë shkollës: çfarë kanë mësuar nxënësit për jetën e tyre në të ardhmen? |
| Çdo nxënës ka të drejtë për të zhvilluar një mënyrë personale të shprehjes artistike. Në këtë mënyrë, nxënësit rrisin vetëbesimin e tyre dhe mësojnë më shumë për veten e tyre dhe njëritjetrin. | Të gjitha të drejtat e fëmijëve prezantohen dhe diskutohen në klasë. | Nxënësit mësojnë si të marrin vendime dhe të argumentojnë për zgjidhjet që kanë gjetur. |
| <i>Nxënësit</i> | | |
| Çfarë unë kam mësuar për të drejtat e fëmijëve? | Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në klasë? | Cilat janë veprimet që jam në gjëndje të ndërmarr tani? |
| Është e mrekullueshme nëse shkolla bëhet vendi ku ne mund të shohim kaq shumë vepra arti. Tani unë po e shijoj që jam në shkollë. | Unë kam studiuar të drejtat e fëmijëve për një kohë të gjatë. Mua më është dashur të marrë një vendim për çdo nen, dhe unë mund ta bëja këtë vetëm nëse e kisha kuptuar nenin. Unë kam zbuluar se nuk është gjithmonë e lehtë për të kuptuar konventën për të drejta te fëmijëve. | Jo të gjithë nenet në konventën e të drejtave të fëmijëve janë njësoj të rëndësishme për mua. Unë kam menduar për pyetjen se cilët prej neneve unë mund të përkrah. Unë kam menduar për problemin se cilat prej të drejtave janë veçanërisht të rëndësishme për fëmijët e tjerë në familje të tjera, rajone ose vende të tjera dhe atë se çfarë mund të bëj unë për t'i mbështetur ato. |

D. Procedura

Mësimi 1 (fundi i shtatorit/fillimi i tetorit, kohëzgjatja afërisht një orë e gjysmë)

Hyrje: Mësuesi aktivizon njohuritë paraprake të nxënësve për të drejtat e njeriut dhe përmbledh pikat më të rëndësishme. (shih kap.3, mësimi 20). Ai u jep nxënësve kopje të kartave të të drejtave të fëmijëve dhe i ndihmon fëmijët t'i kuptojnë (duke bërë lidhjen e të drejtës me ilustrimin) dhe të aftësohen për detyrën . Në qendër të veprimtarisë nuk duhet të jetë leximi i disa të drejtave, por përdorimi i ilustrimeve për të treguar një histori për të një drejtë të veçantë.

Në vijim mësuesi vendos në tryezë një kuti që ka pamjen e një thesari, pranë kartave të të drejtave.

Më pas ai i vendos objektet në mënyrë të tillë që të simbolizojnë disa të drejta. Për shembull: Neni 7 (e drejta e një emri nga lindja) me një qiri i vogël në kujtim të ditës së emri; Për neni 28 (e drejta për arsimim) mund të qëndrojë pranë një lapsi. Mësuesi shpjegon parimin e simbolizimit dhe diskuton shembuj të tjerë me nxënësit.

Pas kësaj mësuesi shpjegon planin e mëtejshëm.

Dita Universale e Fëmijëve është më 20 nëntor. Deri atëherë, secili nxënës duhet të krijojë një kuti thesari, e cila duhet mbushur me karta dhe objekte që lidhen me të drejtat e fëmijëve. Çdo nxënës vendos se cilat objekte mund të korrespondojnë me të drejtat konkrete të fëmijëve.

Detyra konkrete: Çdo nxënës ka një javë kohë për të gjetur dhe zbukuruar kutinë e tij të thesarit. Së pari ai duhet të gjejë një kuti me një kapak (një kuti prej kartoni, druri ose metali). Kjo kuti duhet të zbukurohet, pjesërisht gjatë kohës së shkollës, në orën e artit pamor, të aftësimin teknologjik etj. Kjo kërkon që fëmijët të gjejnë një kuti dhe material zbukurues për vete dhe për shokët e klasës.

Të gjithë nxënësit presin kartat e të drejtave të fëmijëve. Ata i vendosin ato në kutitë e tyre të thesarit. Udhëzime. Tani fillon gjuetia e thesarit! Fëmijët gjejnë kutitë e para të thesarit që simboollizojnë një të drejtë.

Ide e mundshme: Shkoni tek kartat përsëri dhe shkruaj disa fjalë kyçe në pjesëne prapme të tyre për të përmbledhur çdo të drejtë.

Mësimi 2 (një javë më vonë)

Fëmijët i tregojnë njëri-tjetrit materialet dhe objektet që kanë sjellë me vete për të simbolizuar të drejtat e shkruara në kartat e tyre

Diskutim/Ide

Për skimin e kutisë së thesarit

Për simbolet e përshtatshme për të drejtat individuale të fëmijëve: Çfarë ilustrimi do të ishte i përshtatshëm për këtë të drejtë. Ku mund të gjenden këta objekte? Është e rëndësishme që gjuetia e thesarit të ndihmojë fëmijët të njihen me të drejtat dhe t'i kuptojnë ato më mirë. Nëse e kanë kuptuar çfarë do të thotë e drejtë e fëmijës, atëherë ata duhet të simbolizojnë atë vetëm me një objekt.

Fëmijët fillojnë të dekorojnë kutitë e tyre të thesarit. Ata ndihmojnë njëri-tjetrin dhe shkëmbejnë materialet për zbukurim. Mësuesi cakton kohën. Kjo mund të plotësohet në shtëpi ose një orë tjetër mësimi.

Gjatë gjuetisë së thesarit, ku fëmijët mbledhin objektet dhe materialet për katër-pesa javët e ardhme, ata shkëmbejnë me njerit tjetrin edhe idetë dhe gjetjet e tyre. Çfarë ke gjetur për të simbolizuar të drejtën? Fëmijët janë të lirë të kopjojnë idetë e njeri-tjetrit. Ata mund të bëjnë edhe një konkurs për kutinë më të bukur të thesarit dhe për idetë me krijuese dhe origjinale.

Mësimi 3

Një javë para Ditës Universale të Fëmijëve (20 nëntor): të gjithë fëmijët tregojnë objektet që kanë mbledhur në një ekspozitë, në tryezat e tyre. Nuk është e nevojshme të ilustron çdo të drejtë e fëmijëve me një objekt. Ata organizojnë një tur të shkurtër për të gjithë objektet..

Fëmijët i shpjegojnë njëri-tjetrit pse kanë zgjedhur objektin.

Pas kësaj organizohet një diskutim me të gjithë klasën për mundësinë e organizimit të një ekspozite me rastin e Ditës Botërore të Fëmijëve (20 nëntor) për nxënësit e tjerë të shkollës. Pyetje për diskutim: A ka vitrina qelqi që ne mund t'i përdorim? A duhet të vendosim disa tavolina të vogla në ndërtesën e shkollës?

A duhet ta kthejmë klasën tonë në një muze për të drejtat e fëmijëve më 20 nëntor? Ndoshta një tjetër klasë e tretë ka zhvilluar të njëjtin plan. Si mund t'i ndajmë objektet tona? A duhet të ftojme drejtorin e shkollës, mësuesit e tjerë, prindërit ose stafin e kujdesit për ambientin? A duhet të kemi një lloj një ceremoniale të ekspozitës sonë? A duhet të bëjmë prova ose të shkruajmë dhe të kompozojmë një këngë për këtë rast? Dhe kështu *me radhë*.

Mësimi 4

Dita Universale e Fëmijëve, 20 nëntor (ose një ditë, sa më pranë kësaj)

Nxënësit ndërtojnë ekspozitën dhe marrin përsipër të informojnë nxënësit e tjerë. Ata bien dakord për një plan dhe shfaqin kutitë e thesarit për nxënësit e tjerë. Kjo duhet të shoqërohet me informacione për të drejtat e fëmijës, gjë që mund të bëhet në fjalimin hyrës dhe në afishen e ekspozitës.

Në vijim, klasa diskuton dhe reflekton (ndoshta me shkrim) në lidhje me këto pyetje: Si shkoi projekti? Çfarë fituam prej tij? Çfarë shkoi mirë? Çfarë mund të ishte bërë më mirë?

Kapitulli 5 (Arsimi fillor, klasa 5) Ne i bëjmë rregullat për klasën tonë

A. Planifikimi

| | Çështjet themelore/temat | Detyrat kryesore | Burimet |
|----------|---|--|---|
| Mësimi 1 | Çfarë të drejtash ka çdo person në këtë klasë? | Duke punuar në grupe, nxënësit përgatisin listën e sugjerimet për rregullat në klasën e tyre. | Letër A3 |
| Mësimi 2 | Çfarë e bën një rregull të mirë? Pse mund të jenë ato një telash? Pse mund të jenë ato të dobishme? | Nxënësit mendojnë për parimin e rendit dhe rregullave. | Broshurat mbi parimet themelore të rregullave në demokraci. Fletë letre A4 |
| Mësimi 3 | Si mund të zbatohen e vihen në jetë të drejtat e fëmijëve në klasë? | Duke punuar në grupe, nxënësit përpunojnë rregullat e tyre që harmonizohen me të drejtat e fëmijëve. | Broshura, të kopjuara ose të shkruara nga nxënësit |
| Mësimi 4 | Përpunimi i rregullave në grupe dhe rënia dakord për rregullat në klasë. | Nxënësit krahasojnë idetë e tyre dhe përpiqen të arrijnë një vendim unanim për rregullat e klasës së tyre. | |

B. Informacion dhe objektiva mësimore

Kur ne i lidhin rregullat për klasën me perspektivat e të drejtave të njeriut apo të fëmijëve, këto rregulla zhvillojnë implikime që shkojnë përtej thjesht sigurimit të paqes dhe qetësisë në klasë.

Të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve nuk janë një trup standardesh të ftohta ligjore. Nëse ato do të vihen në jetë dhe do të bëhen kuptimplote, ato duhet të shërbejnë si instrumente dhe udhëzues për përpjekjet tona për të sjellë barazi dhe drejtësi në jetën e përditshme. Për nxënësit, shkolla është një element i rëndësishëm, në një farë mënyre, edhe epiqendra e jetës së tyre të përditshme. Por shkolla është edhe më shumë se kaq: shkolla është i vetmi vend ku nxënësit mund të mësojnë se si të veprojnë në shoqëri. Shkolla, me fjalë të tjera, klasa, godina e shkollës dhe ambientet e saj si një e tërë, por edhe struktura e shkollës dhe udhëheqja shkollëre përbëjnë një model në miniaturë të shoqërisë – një mikro-shoqëri. Ajo, çka nxënësit kanë mësuar, zhvilluar dhe testuar këtu, e dobishme apo jo, do të ketë një shans të mirë që të transferohet në botën përtej klasës dhe komunitetit të shkollës. Për t'i bërë nxënësit të vetëdijshëm për këtë fakt dhe për ta përdorur atë nga pikëpamja e të drejtave të fëmijëve është një objektivi i rëndësishëm i kapitullit 5.



Të drejtat dhe detyrat formojnë një çift konceptesh që plotësojnë njëri-tjetrin. Ato i përkasin njëra-tjetrës si dita dhe nata ose vera dhe dimri. Të drejtat dhe detyrat varen nga njëra-tjetra. Të drejtat e njeriut dhe

të fëmijëve nuk mund të kuptohen pa vlerësimin e ndërvarësisë së të drejtave dhe detyrave.

Ky projekt do të përqendrohet në nenet e mëposhtme të Konventës për të Drejtat e Fëmijës:

Neni 12, dëgjimi i mendimit tonë;

Neni 13, liria për t'u shprehur;

Neni 28, e drejta për arsimim dhe

Neni 31, e drejta për kohë të lirë dhe rekreacion.

C. Pyetjet kryesore për reflektim në orët e të drejtave të fëmijëve

| Përjetimi i të drejtave të fëmijëve | Njohja e të drejtave të fëmijëve | Zbatimi i të drejtave të fëmijëve |
|--|--|---|
| <i>Mësuesi</i> | | |
| Si janë thjeshtuar parimet e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe në klasë? | Çfarë dinë fëmijët për të drejtat e fëmijëve? | Të mësojnë si të ndërmarrin veprime jashtë shkollës: çfarë kanë mësuar nxënësit për jetën e tyre në të ardhmen? |
| Në këtë njësi, nxënësit përjetojnë konkretisht se ne na nevojiten rregullat që të jetojmë së bashku dhe kuptojnë se të drejtat e fëmijëve përcaktojnë një sistem të tillë të rregullave. | Neni 12,13, 28, 31+(shih shtojcën: Konventa për të Drejtat e Fëmijës e KB) | Nxënësit kuptojnë se si bëhen rregullat në një demokraci. Ata janë në gjendje të marrin pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes. |
| <i>Nxënësit</i> | | |
| Çfarë unë kam mësuar për të drejtat e fëmijëve? | Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në klasë? | Cilat janë veprimet që jam në gjendje të ndërmarr tani? |
| Nxënësit kuptojnë se të drejtat dhe detyrat shkojnë së bashku. Ata e kuptojnë se rregullat janë bërë nga njerëzit për njerëzit, që ato mund të ndryshohen, dhe se nuk është e lehtë të bihet dakord për rregulla të detyrueshme për të gjithë anëtarët brenda një grupi. | Unë e di tani se kam të drejtë të marrë pjesë në përpilimin e rregullave për klasën tonë. Unë jam i vetëdijshëm se zhvillimi i konventës mbi të drejtat e fëmijëve ishte një lloj i ngjashëm me këtë proces. | Tani unë mund të përpiqem të gjej rregulla të ngjashme mbi mënyrën se si të jetojmë së bashku në familjen time, në klubin tonë sportiv apo bashkë me miqtë e mi. Ne duhet të sigurohemi që në përcaktimin e rregullave të tilla të marrin pjesë sa më shumë njerëz që të jetë e mundur dhe që të bien dakord për një kompromis. |

D. Procedura

Mësimi 1

Mësuesi prezanton projektin dhe planin për katër mësimet e ardhme.

Ai frillon me çështjen e "të drejtave dhe përgjegjësive" me nxënësit. Për të frymëzuar nxënësit ai drejton pyetjet e mëposhtme:

Përmendni disa nga të drejtat që keni në klasë, në oborrin e shkollës dhe në shtëpi. Kujtoni edhe të drejtat e fëmijëve për të cilat keni dëgjuar.!

Këto të drejta pëmbushen vetëm nëse edhe të tjerët i respektojnë ato. Çdo të drejte, i korrespondon një përgjegjësi. Le të mendojmë tani për shembuj të tjerë.

Klasa ndahet në tre, gjashtë ose nëntë grupe, sipas madhësisë së saj. Ju përpiquni të krijoni grupe me jo më shumë se pesë veta. Grupet janë ose A, ose B, ose C.

Çdo grup cakton një zëdhënës dhe tregon si e zgjodhi atë.

Secili grup ka një fletë letër table, të ndarë në tre pjesë. Duke përdorur një të tretën e sipërme të letrës, nxënësit regjistrojnë atë që besojnë se është e drejtë e çdo individ (duke përfshirë mësuesin) në klasën e tyre. Ata duhet të shënojnë çdo sugjerim dhe çdo sugjerim duhet të ketë një numër.

Informoni! Sa mirë mendoni se e keni plotësuar detyrën? Çfarë ju ndihmoi? Çfarë ju pengoi?

Kaloheni letrën tek grupi tjetër (A tek B, B tek C, C tek A).

Çdo grup shqyrton listën e të drejtave të gjeneruara nga grupi i mëparshëm. Ata diskutojnë pyetjet e mëposhtme: Çfarë përgjegjësish kemi ne për të respektuar këto të drejta? Çfarë është e nevojshme të bëjmë, si duhet të sillemi? Për shembull, "Kushdo ka të drejtë të dëgjohej", "Ne e kemi përgjegjësi që të dëgjojmë".

Duke përdorur të njëjtat numra si në pjesën e të drejtave, shkruani një përgjegjësi që përputhet me një të drejtë (në qoftë se iu shkon mendja për ndonjë të drejtë) në një të tretën e mesme të letrës.

Në fund të mësimi mësuesi mbledh të gjitha kontributet e bëra nga nxënësit për t'i shqyrtuar ato para mësimi tjetër.

Mësimi 2

Mësuesi nxit nxënësit të diskutojnë pyetjet themelore në lidhje me rregullat më shqetësuese:

Çfarë ka të mirë pasja e rregullave?

Çfarë më shqetëson mua në lidhje me rregullat?

Kur jam unë i kënaqur se ka rregulla?

Kush i vendos rregullat?

Kush i zbaton rregullat?

Kush ka fuqinë të detyroj zbatimin e rregullave dhe cilat janë ndeshkimet në rast se ato shkelen?

Teksti në vijim, një version i shkurtuar i tij mund të shërbejë si një stimul për të filluar mësimin.
"Disiplina dhe rendi në demokraci dhe në shkollë"

Disiplina dhe rendi në demokraci dhe në shkollë

Rendi është i nevojshëm në të gjitha rrethanat. Një grup pa rend dhe rregulla themelore nuk mund të jetë demokratik.

Kufijtë janë të nevojshëm. Rregullat mund të jenë të gabuar ose të papërshtatshme. Por për aq kohë sa ato nuk janë zëvendësuar duhet të respektohen. Por duhet, megjithatë, të ekzistojë mundësia për t'i ndryshuar ato.

Që nga fillimi, fëmijët duhet të marrin pjesë në vendosjen dhe zbatimin e rregullave. Vetëm në këtë mënyrë ata do të identifikohen me rregullat.

Një komunitet klase nuk mund të funksionojë pa besimin dhe respektin e ndërsjellë për njëri-tjetrin. Në disa raste mund të jetë e vështirë për të siguruar një atmosferë të tillë.

Shpirti i skuadrës duhet të zëvendësojë konkurrencën në klasë.

Një atmosferë miqësore në klasë është me rëndësi jetike.

Shkathtësitë shoqërore të mësuesit kanë një kontribut thelbësor për të realizuar (lidhshëpin demokratik, zhvillimin e ndjenjës së përkatësisë në grup, ndërtimin e marrëdhënieve etj).

Komunikimi në grup është një realitet i përhershëm në një klasë të udhëhequr në mënyrë demokratike.

Nxënësit, si djemtë edhe vajzat, duhet të inkurajohen të eksplorojnë gjera të reja dhe të mësojnë nga gabimet.

Brenda kufijve të caktuar, duhet të jetë e mundur të ushtrohen liritë. Vetëm në këtë mënyrë do të mundet individi të zhvillojë përgjegjësitë.

Disiplina dhe rendi do të pranohen dhe respektohen me maksimumin e dëshirës nëse ato ndihmojnë çdo individ të shprehë vetveten, dhe nëse mbështesin grupin në zhvillimin e marrëdhënieve dhe të kushteve të kënaqshme të punës.

"Një grup pa rend dhe rregulla bazë nuk mund të jetë demokratike"

Nxënësit hyjnë në të njëjta grupe si në mësimin e kaluar. Mësuesi shpërndan rrypat e letrës dhe jep udhëzimet e mëposhtme.

Shihni ato që keni shkruar deri tani. Mendoni për rregullat që i vlerësoni me rëndësi të veçantë për të jetuar së bashku dhe të cilat do të dëshironit t'ia paraqitni klasës më vonë.

Shkruani rregullat në një tabak letre. Ato shkruhen në një të tretën pjesë të poshtme të letrës:

Ato duhet të jenë formuluar pozitivisht - "bëni" diçka, në vend të "nuk duhet të" bëni diçka. Ato duhet të jenë specifike dhe të përshkruajnë sjelljen e kërkuar, për shembull, të drejtën për t'u dëgjuar; ne kemi përgjegjësinë për të dëgjuar; rregull - heshtni kur të tjerët janë duke folur!

Grupet punojnë sipas udhëzimeve të mësuesit. Në vijim, krijohen grupe më të mëdha, si rrjedhojë e bashkimit të dy grupeve. Grupet paraqesin rregullat e tyre, me fjalët e tyre dhe në mënyrë të kuptueshme.

Çdo grup duhet të zgjedhë jo më shumë se tre rregulla. Ato shkruhen me gërma të mëdha në tabakë letre (A3). Këto vendosen në tabelë dhe klasa diskuton për secilën prej tyre. Çdo grup cakton folësin për të sqaruar të tjerët kur të jetë e nevojshme.

Përmbledhje: Redaktimi përfundimtar i një grupi rregullash të cilave janë gati t'u binden të gjithë.

Cilat prej rregullave janë identike ose të ngjashme? Cila mund të hiqet ose të shkrihet me një tjetër?

Cilat duhet të shprehen ndryshe që të bëhen më e kuptueshme?

Votimi për rregullat. Çdo nxënës ka pesë fishe për të "shpenzuar" për rregullat që beson se duhet të përfshihen në klasën e tyre. Ata mund të zgjedhin duke bërë një vijë në tabelë ose duke ngjitur një letër pranë rregullës që propozon. Rregullat (jo më shumë se dhjetë) me numrin më të madh të votave shkruhen si rregullat e klasës ose bëhen pjesë e rregullave ekzistuese. Ato formulohen si një dokument i veçantë dhe firmosen nga çdo nxënës.

Reflektim për procesin e të mësuarit (ku zbatohen dhe detyrohen të zbatohen rregullat e reja): Çfarë ndihmoi? Çfarë ishte penguese? Cili ishte kontributi juaj? A dalloni ndonjë nga klasa kontributi i të cilit ishte më i vlefshëm? Pse? Çfarë bën ai?

Mësimi 3

Mësuesi aktivizon njohuritë paraprake të nxënësve për të drejtat e njeriut dhe përmbledh pikat më të rëndësishme (shih kap.3, mësimi 2, dhe Kap 4, mësimi 1): krijimi i të drejtave të fëmijëve, të drejtat më të rëndësishme, mundësisht ato që lidhen me të drejtat e njeriut.

Mësuesi paraqet zgjedhjet e mëposhtme të të drejtave të fëmijëve duke përdorur tekstin original nga Deklarata Universale e të Drejtave të Fëmijës (shih shtojcën)

Neni 12, shprehja e pikëpamjeve dhe interesave tona;

Neni 13, liria për të shprehur vetveten;

Neni 28, e drejta për arsimim;

Neni 31, e drejta për pushim dhe kohë të lirë.

Nxënësit ndahen në grupe. Çdo grup merr një fletë A4 dhe me të përgatit një fletë pune me dy kolona, si më poshtë. Në kolonën e majtë shënohen katër të drejtat, ndërsa në kolonën në të djathtë shënohen mendimet e nxënësve për të drejtat dhe përgjegjësitë që ato bartin, për ta dhe për të tjerët. Si pikë referimi mund të shërbejë pyetja: “Nëse fqinji im ose shoku pretendon jë të drejtë, çfarë detyrimi lind tek mua ose te të tjerët? Ose (neni 28): “Cilat janë detyrimet që duhet të përmbushë shoqëria dhe shkolla për të siguruar të drejtën për arsimim? Si mund të ndihmojmë ne në realizimin e kësaj të drejte. Rezultatet diskutohen në mësimin e ardhshëm.

| Të drejtat | Rregullat dhe detyrat |
|--|------------------------------|
| <p><i>Neni 12</i> <i>Shprehja e</i> <i>pikëpamjeve dhe e interesave tona</i></p> <p>Për çfarë është ajo?</p> | |
| <p><i>Neni 13</i> <i>Liria për të shprehur vetveten</i></p> <p>Për çfarë është ajo?</p> | |
| <p><i>Neni 28</i> <i>E drejta për arsimim</i></p> <p>Për çfarë është ajo?</p> | |
| <p><i>Neni 31</i> <i>E drejta për pushim dhe kohën e</i> <i>lirë</i></p> <p>Për çfarë është ajo?</p> | |

Mësimi 4

Nxënësit i paraqesin njëri-tjetrit rezultatet e tyre në klasë. Çdo grup ka një zëdhënës. Ata mund të trajtojnë aspekte të tilla si në vijim:

- Si e përballuam detyrën tonë? (Procesi i punës në grup dhe vendim-marrja)
- Çfarë ishte e rëndësishme për ne? (Kriteret dhe vlerat)
- Si mund të sigurohemi ne se janë respektuar rregullat? (Qëndrimet ndaj rregullave, zbatimi)

Përfundime të mundshme: Redaktim përfundimtar, marrëveshje për redaktimin e fundit të të drejtave dhe përgjegjësive në lidhje me katër të drejtat e shqyrtuara. Një grup merr detyrën e krijimit të një dokumenti me rregullat, si një vepër arti. Të gjithë nxënësit dhe mësuesit e nënshkruajnë këtë dokument. Rregullat janë në fuqi derisa ato të zëvendësohen me një dokument të ri. Dokumenti duhet të shfaqet në Ditën Universale të Fëmijëve si një shembull se si të praktikohet demokracia në klasë.

Kapitulli 6 (Arsimi bazë, klasa 6)
Të drejtat e fëmijëve: një vepër arti!


A. Planifikimi

| | Çështjet themelore/temat | Detyrat kryesore | Burimet |
|--------------|--|--|--|
| Mësimi 1 | Çfarë është një projekt arti? Si mund të paraqes të drejtat e fëmijëve me mjete artistike? | Nxënësit vendosin se cilin nen të veçantë nga konventa për të drejtat e fëmijëve do të paraqesin si vepër arti dhe zhvillojnë idetë e tyre të para për të. | Disa revista; të drejtat e fëmijëve në karta ose copa letre |
| Mësimi 2 - 4 | Si munden mësuesit dhe nxënësit të mbështesin njëri-tjetrin? Si i llogaritim ne punëtorët më të ngadaltë dhe më të shpejtë? | Nxënësit realizojnë një ose disa projekte arti. Ata mësojnë si të japin dhe të pranojnë ndihmë në klasë. | Letra, ngjyra, ngjitës, revista etj. |

B. Informacion dhe objektiva mësimore

Të drejtat e fëmijëve dhe të njeriut shpesh janë të lidhura me probleme komplekse politike, sociale dhe personale. Ky projekt vazhdon një traditë që ka shërbyer si pikë referimi, në mënyrë të përsëritur në kontekstin e të drejtave të fëmijëve dhe të njeriut.

Artistët marrin detyrën për të shprehur, përmes imazheve, përmbajtjen e një neni të caktuar ose pjesë të tij. Në këtë mënyrë janë krijuar shumë kartolina, kalendarë, libra dhe madje edhe filma të mrekullueshëm. Për ata nxënës që kanë punuar në projektin e kutive të thesarit në klasë e 3-të, ky projekt arti do të japë një mundësi të mëtejshme për të studiuar të drejtat e fëmijëve më në thellësi.



Ne mendojmë se përdorimi i kësaj tradite (si në rastin e kap. 3, me projektin e kutisë së thesarit) i qasjes krijuese dhe tërësore është me shumë vlerë: fëmijët duhet të mësojnë për një temë sfiduese edhe artistikisht. Një deklaratë me gojë ose me shkrim mund të shprehet me imazh, vetëm nëse ajo është kuptuar plotësisht.

Ne rekomandojmë planifikimin e veprimtarive mësimore mjaft herët, për të mundësuar që fotografitë të ekspozohen në Ditën Universale të Fëmijëve, më 20 nëntor, në shkollë, në bashkinë e qytetit ose në një ndërtesë tjetër publike.

Ky objektivi i projektit është kulmi dhe motori i saj, që nxit nxënësit të kryejnë detyrën me kujdesin e krijimtarinë e nevojshme.

Ky mësim ose vetë projekti mund të realizohet në bashkëpunim edukimin pamor ose me aftësimin teknologjik. Fëmijët mund të sugjerojnë dhe kjo mund të bëhet pjesë e planifikimit. Projekti mund të bëhet edhe në bashkëpunim me klasa të tjera.

C. Pyetjet kryesore për reflektim në orët e të drejtave të fëmijëve

| Përjetimi i të drejtave të fëmijëve | Njohja e të drejtave të fëmijëve | Zbatimi i të drejtave të fëmijëve |
|--|---|---|
| <i>Mësuesi</i> | | |
| Si janë thjeshtuar parimet e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe në klasë? | Çfarë dinë fëmijët për të drejtat e fëmijëve? | Të mësojnë si të ndërmarrin veprime jashtë shkollës: çfarë kanë mësuar nxënësit për jetën e tyre në të ardhmen? |
| Veçanërisht në klasat e artit nxënësit mund të kuptojnë se zhvillimi i mjeteve të tyre individuale të shprehjes është edhe i mundshëm edhe i rëndësishëm. Ata gjejnë mënyra individuale të përfaqësimit të neneve të të drejtave të ndryshme të fëmijëve përmes mjeteve artistike. | Nxënësit janë zgjeruar dhe thelluar njohuritë e tyre dhe të kuptuarit për të drejtat e fëmijëve dhe kanë vlerësuar në mënyrë kritike disa nga të drejtat kyçe të Konventës së të Drejtave të Fëmijës. | Nxënësit janë emocionalisht të aftë për të kapur shkeljet e të drejtave të fëmijëve dhe për t'i gjykuar ato. Ata e kanë zhvilluar këtë kompetencë përmes qasjes së tyre shumë personale në studimin dhe paraqitjen e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve. |
| <i>Nxënësit</i> | | |
| Çfarë unë kam mësuar për të drejtat e fëmijëve? | Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në klasë? | Cilat janë veprimet që jam në gjëndje të ndërmarr tani? |
| Ky projekt e ka kthyer klasën dhe të gjithë ndërtesën e shkollës në një vend ku unë kam marrë pjesë në zbulim dhe ku po ndihem si në shtëpi. Unë mund të shpreh personalitetin tim individual dhe unë trajtohem si një individ. | Së bashku me shokët e mi të shkollës, unë kam studiuar gjerësisht të drejtat e fëmijëve. Unë kam drejtuar shumë pyetje të reja, dhe kam kuptuar se nuk duhet të shqetësohen në qoftë se nuk i kam kuptuar ende të gjitha nenet mbi të drejtat e fëmijëve. Unë do të vazhdoj studimet e mia. | Unë jam bërë më i vetëdijshëm për talentet e mia artistike, dhe tani jam bërë më i guximshëm në përdorimin dhe trajnimin e tyre. Ato janë pjesë e personalitetit tim, dhe nganjëherë ato më mundësojnë mua për të shprehur më shumë seç mund të bëj me më shumë fjalë apo tekste të gjata. Unë mund të mendoj për një projekt të ngjashëm artesh për të drejtat e fëmijëve me miqtë e mi, të shesim disa fotografi dhe të dhurojmë të ardhurat tona për të mbështetur projekte për fëmijët. |

D. Procedura

Mësimi 1 (kohëzgjatja rreth 1 ½ mësimi)

Mësuesi prezanton në klasë projektin e ri, në detaje.

Është e rëndësishme që fëmijët :

mundësisht, të kenë një tjetër prezantim hyrës për të drejtat e fëmijëve të kuptojnë parimet themelore të projektit dhe synimet e projektit të jenë në gjendje të parashikojnë kërkesat e planifikimit në kohë të shohin shembuj, të ilustruar me mjete artistike, të të drejtave të fëmijëve.

Mësuesi duhet, jo vetëm të tregojë shembuj të ilustruar të drejtave të ndryshme të njeriut ose të fëmijëve, por duhet edhe të demonstrojë stile dhe qasje të ndryshme, për të mbështetur fëmijët në gjetjen e mjeteve të tyre personale të shprehjes.

Pas prezantimit, nxënësit formojnë grupe të vogla. Çdo grup merr një kopje të deklaratës së të drejtave të fëmijëve. Detyra: Gjeni tre të drejta për të cilat duhet të krijoni një vepër arti (pikturë, skulpturë, foto etj.)

Pas kësaj, vijohet me diskutim që përfundon me një seancë plenare për të finalizuar punën për të drejtat e fëmijëve. Pastaj, klasa krahason dhe qartëson pjesët e përbashkëta, në mënyrë që zgjidhja të jetë e kënaqshme për të gjitha grupet.

Grupet duhet të qartësojnë çështje të tilla si:

Mendimi i parë për konceptin e pikturës ose objektit të planifikuar;
Ngjyrat e zgjedhura
Koha e planifikuar
Ide për ekspozitën e planifikuar.

Grupet diskutojnë dhe shkëmbejnë idetë dhe konceptet në klasë.

Detyra për mësimin e ardhshëm është që grupet të formulojnë ide për projektin, të kërkojnë ide për frymëzim dhe informim në gazeta, në internet dhe në biblioteka për të bërë skica ose përshkrime dhe të mbledhin materiale. Çdo grup përgatit një prezantim të shkurtër për planin e mësimin të ardhshëm, si pikë nisjeje një të drejtë të fëmijëve dhe të ilustruar me një shembull.

Mësimi 2 (gjysma e parë)

Nxënësit ndajnë dhe komentojnë idetë e tyre. Është e rëndësishme për nxënësit të kuptojnë të drejtat e fëmijëve dhe të jenë në gjendje të japin shembuj në klasë se si janë plotësuar këto të drejta Nxënësit duhet të jenë të gatshëm të paraqesin idetë dhe planet e tyre përpara klasës. Cila është e drejta e zgjedhur për ta ilustruar, hapat që duhet të ndërmerren dhe në cilën pikë ata do të kenë nevojë për mësuesin ose për shokët e klasës.

Qartësohet edhe koncepti i projektit që do të përfundojë me një ekspozitë që duhet të hapet rreth datës 20 nëntor.

Mësimet e 2 (gjysma e dytë) deri në 4

Nxënësit mund të përdorin gjithë kohën në gjysmën e fundit të mësimin të dytë dhe dy mësimet e mëposhtme për të kryer projektin e tyre. Përvoja ka treguar se nxënësit do të jenë më të motivuar në qoftë se nuk punojnë të izoluar nga njëri-tjetri. Mësuesi duhet t'i nxisë ata që të mos jenë të kënaqur me idenë e tyre të parë.

Mësuesi mund të mbështesë klasën, duke pasur në dorë një koleksion të posterave të artit, ilustrimet nga reklama, diagrame etj, të prerë nga gazetatat dhe revistat. Nxënësit mund të sjellin libra dhe revista arti nga shtëpitë e tyre. Ky koleksion me ilustrime nuk duhet domosdoshmërisht të jetë i lidhur me temën e të drejtave të fëmijëve.

Disa sugjerime:

Nëse jeni duke planifikuar një ekspozitë në ndërtesën e shkollës, në klasë apo në një ndërtesë publike, sigurohuni që nxënësit të bien dakord për formatin dhe stilin e letrave.

Mund të organizohet edhe një konkurs në të cilin mund të marrin pjesë përfaqësues të pushtetit vendor, një aërtist, një gazetar etj.

Nëse projekti përmendet në shtypin vendor, kjo do të ishte motivuese për nxënësit.

Është ajo që dua edhe ajo për të cilën unë kam nevojë?

A. Planifikimi

| | Çështjet themelore/temat | Detyrat kryesore | Burimet |
|----------|---|---|--|
| Mësimi 1 | Cilat janë dëshirat e mia? | Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për dëshirat e tyre duke ia shpjeguar ato njëri-tjetrit. | Piktura për të formuar çifte të nxënësve |
| Mësimi 2 | Për çfarë kanë nevojë njerëzit? Çfarë do të ishte mirë që të kemi? | Nxënësit mësojnë të bëjnë dallimin mes dëshirave dhe nevojave, dhe në mes nevojave themelore dhe nevojave të vetë-përbushjes. | Revista të vjetra, gërshtë, ngjitës, letër, kapëse rrobash. |
| Mësimi 3 | Çfarë janë dëshirat? Çfarë janë nevojat? | Të udhëhequr nga kritere, nxënësit bien dakord për 10 dëshira dhe nevoja të rëndësishme. | Materiale të furnizuara nga nxënësit. |
| Mësimi 4 | A përputhen të drejtat e fëmijëve me idetë tona për nevojat dhe dëshirat? | Nxënësit krahasojnë sugjerimet e tyre me të drejtat e fëmijëve dhe krijojnë afishe për një prezantim të Ditës Botërore të Fëmijëve. | Kopje të konventës së të drejtave të fëmijëve për çdo grup, tabakë i madh letre. |

B. Informacion dhe objektiva mësimore


Për të kuptuar se cilat janë të drejtat e fëmijëve dhe ato të njeriut, nxënësit duhet të reflektojnë mbi nevojat dhe dëshirat e tyre personale. Ata duhet të bëhen të vetëdijshëm për atë që presin nga jeta në gjendjen e tyre aktuale.

Së pari, ata duhet të mendojnë lirshëm për dëshirat dhe nevojat e tyre, pa marrë parasysh sa të çmendur mund të duken dhe duhet t'i shprehin ato.

Së dyti, ata duhet të qartësojnë se cili është dallimi, në të kuptuarit e tyre, në mes të dëshirave dhe nevojave të vërteta në jetë. Kjo lloj zgjedhje, pothuajse me siguri, do t'i orientojë ata drejt shumë prej të drejtave që Konventa për të Drejtat e Fëmijës ua ka dhënë tashmë.

Në çdo fazë, është e rëndësishme që mësuesi të nxisë dhe kryesojë diskutimet. Ai duhet të jetë i kujdesshëm që të mos ndërhyjë dhe të mos i ngarkojë nxënësit me vlerat dhe normat e tij, edhe në përpjekjet që ai me qëllime të mira i bën për t'i bindur nxënësit me idetë e "drejta". Përkundrazi, në një diskutim të drejtuar prej tij me kujdes, nxënësit shpesh do të zbulojnë dhe të zgjidhin konceptet dhe vlerat kontradiktore.

Koha më e përshtatshme për kapitullin 7, do të ishte fillimi i nëntorit. Në këtë mënyrë, afishet që do të krijohen në mësimin e katërt do të jenë gati për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve. (20 nentor)



C. Pyetjet kryesore për reflektim në orët e të drejtave të fëmijëve

| Përjetimi i të drejtave të fëmijëve | Njohja e të drejtave të fëmijëve | Zbatimi i të drejtave të fëmijëve |
|---|---|---|
| <i>Mësuesi</i> | | |
| Si janë thjeshtuar parimet e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe në klasë? | Çfarë dinë fëmijët për të drejtat e fëmijëve? | Të mësojnë si të ndërmarrin veprime jashtë shkollës: çfarë kanë mësuar nxënësit për jetën e tyre në të ardhmen? |
| Ky kapitull i ofron nxënësit mundësinë për të shprehur dëshirat dhe nevojat e tyre personale. Ata zbulojnë se janë dëgjuar dhe janë marrë seriozisht. Ata mësojnë dallimin në mes nevojave themelore dhe gjërave që dëshirojnë. | Nxënësit kuptojnë që të drejtat e fëmijëve trajtojnë nevoja bazë që janë të nevojshme për të jetuar. | Nxënësit duhet të bëhen të vetëdijshëm se përballen çdo ditë me çështje kyçe të jetës, dhe se shoqëria krijon kushte jo të barabarta për anëtarët e saj për përballimin e problemeve të tilla. Ata duhet të mësojnë të mbrojnë dëshirat e tyre, duke ruajtur edhe një distancë kritike ndaj tyre. |
| <i>Nxënësit</i> | | |
| Çfarë unë kam mësuar për të drejtat e fëmijëve? | Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në klasë? | Cilat janë veprimet që jam në gjëndje të ndërmarr tani? |
| Unë mund të shpreh dëshirat e mia, vetëm nëse unë i besoj shokëve të mi të shkollës dhe mësuesit. Unë kam mësuar se ia vlen të hapësh dhe të shohësh se edhe të tjerët e bëjnë këtë. | Unë kam mësuar se të drejtat e fëmijëve përqendrohen në nevojat tona më të rëndësishme, në pjesëmarrjen, zhvillimin, mbijetesën dhe mbrojtjen, dhe se ato kanë të bëjë shumë me jetën time të përditshme. | Unë do të përpiqem të jem më i vëmendshëm për dallimin në mes të dëshirave dhe nevojave. Unë nuk do të fsheh apo mohoj dëshirat dhe ëndrrat e mia, por do të përpiqem t'i bëj ato të vërteta pa i bërë dëm nevojave të njerëzve të tjerë. |

D. Procedura

Mësimi 1

Hyrje. Mësuesi informon klasën se në arsimin e mesëm të ulët, të drejtat e fëmijëve e di të jetë tema e një numri të madh mësimesh çdo vit. Mësuesi pyet klasën për atë që kujtojnë nga arsimi fillor dhe rikujtojnë faktet më të rëndësishme (shih kap. 3, mësimi 2, dhe kap. 4, mësimi 1: origjina e të drejtave të fëmijëve, të drejtat më të rëndësishme, mundësisht të lidhura me të drejtat e njeriut).

Lajmërim. Gjatë këtij viti, tema do të jetë “dëshirat dhe nevoja”. Mësuesi përshkruan shkurtimisht temën, mbledh shembuj nga nxënësit, për çdo kategori dhe ndryshimet më të mëdha. Si mund të lidhet tema me të drejtat e fëmijëve?

Formimi i grupeve. Mësuesi ka prerë foto të makinave të bukura, objekte të modës së veshjeve ose burime tërheqëse për pushim në katër pjesë secila dhe i shpërndan në mënyrë të rastësishme të nxënësit. Nxënësit duhet të gjejnë partnerët e tyre që kanë një pjesë të së njëjtës foto; së bashku, ata formojnë një grup pune. Nëse, për t’u përshtatur me numrin e përgjithshëm të nxënësve, duhet të ketë grupe me tre ose pesë vetë, mësuesi rregullon numrin e copave në përputhje me rrethanat.

Grupet zgjedhin një zëdhënës dhe menaxher. Zëdhënësi do të flasë në emër të grupit me grupet e tjera, në seancën plenare, me mësuesin. Ai është përgjegjës për transmetimin e mendimit të grupit, jo të vetin personal. Menaxheri i grupit organizon procesin e punës, integron të gjithë anëtarët dhe vëzhgon afatet kohore.

Grupi merr detyrën të diskutojë çështjet e mëposhtme dhe të mbajë shënimet e duhura:

- Cilat janë disa nga dëshirat më të mëdha që keni sot? Çfarë do t’ju bënte të lumtur?
- Cilat janë dëshirat, ëndërrat më të mëdha për të ardhmen tuaj (p.sh. kur të bëheni 25 vjeç)?
- A mbani mend dëshirat dhe ëndërrat tuaja në moshën 5, 7, 9 dhe 11 vjeç? Cilat qenë dëshirat më të mëdha? Çfarë do t’ju kishte bërë të lumtur?
- Cilat janë dëshirat dhe ëndërrat e të rriturve (p.sh. prindërve, të njohurve të tjerëve)?

Grupi bashkon dëshirat dhe ëndërrat në një listë dhe i rendit sipas moshës me të cilën lidhen. Lista shkruhet në një tabelë (madhësia A3 ose A2). Nxënësit mund të skicojnë tabela vetë dhe mësuesi mund t’u japë udhëzimet e duhura, në varësi të moshës së klasës. Tabela duhet të ketë titullin e saj, të sugjeruar nga vetë nxënësit.

Tabelat varen në klasë si afishe. Folësit nga grupet paraqesin rezultatet. Mësuesi mund t’u japë disa ide për aspekte të tilla si dëshirat e veçanta për gjinitë e ndryshme, dëshira utopike apo reale etj.

Për mësimin e ardhshëm, nxënësit marrin detyrën e mëposhtme:

Fëmijët sjellin pjesë të prera me temë dëshirat dhe nevojat (në gazeta, revista, katalogë etj.), kapëse rrobash etj.

Mësimi 2

Hyrje. Përmbledhje e shkurtër e mësimëve të kaluara. Mësimi ishte për dëshirat dhe nevojat tani dhe kur ishim më të rinj. Sot ne dëshirojmë të përqendrohemi më shumë ndryshimet ndërmjet dëshirave (do të ishte mirë sikur të bëheshin realitet) dhe nevojave bazë (të cilat janë thelbësore për jetën tonë). Këtu janë të nevojshme disa shembuj.

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në grupet e tyre. Ata diskutojnë pyetjet e mëposhtme:

Çfarë do dëshironim të kishim? Çfarë do të ishte mirë që të kishim? Për çfarë do të na mundësonte të bënim ose të ishim? (Dëshira)
Çfarë na nevojitet me të vërtetë dhe pse?(Nevoja jetësore)

Fotot që kemi sjellë në klasë mund të shërbejnë për të nxjerrë ide spontane, veçanërisht ide për dëshira.

Pasi mësuesi shpërndan fletët A3, nxënësit marrin detyrën:

Hartoni një tabelë me të paktën 5 nevoja bazë (ushqim, siguri, kujdes, miq, arsim, ngrohtësi etj.) dhe pesë dëshira, plotësimi i të cilave do t'i shërbente vetzhvillimit (TV, udhëtim në vende të ndryshme, makinë të shtrenjtë etj.)
Prisni fotot për të ilustruar të dyja kategoritë dhe (mundësisht detyre shtëpie) gjeni foto të tjera.
Fotot duhet të etiketohen në pjesën e pasme ose në pjesën e pushtme të tyre si NB (nevojë bazë) ose D (dëshirë).

Mësimi 3

Grupet marrin detyrën e mëposhtme: fotot vendosen të gjitha në tavolinë. Ato përfaqësojnë nevoja dhe dëshira. Në mënyrë demokratike, nxënësit zgjedhin 5 foto që ilustrojnë më mirë nevojat dhe 5 të tjera që ilustrojnë më mirë dëshirat. Bëni kujdes që të merret parasysh mendimi i secilit. (Për këtë arsye çdo nxënësi i jepet një fishe ose letra të vogla me të cilat do të shënojnë nevojat ose dëshirat e tij të parapëlqyera. Zgjidhen 10 fotot me numrin më të madh të letrave ose të fisheve).

Detyra e re: Merrni një spango rreth 4 metra të gjatë dhe 10 kapse rrobash. Vareni spangon në një vend të përshatshëm dhe përdorni kapëset për të varur fotot tuaja në këtë mënyrë:

në të majtë, fotot që përfaqësojnë artikujt që na nevojiten për të jetuar me dinjitet (nevojat bazë);
në të djathtë, fotot që përfaqësojnë artikujt që na nevojiten për të jetuar këndshëm.
Disa foto mund të varen në mes, ndërmjet dy kategorive .

Prezantim nga grupet. Këtu mund të zhvillohet edhe një diskutim, i drejtuar nga mësuesi, për aspekte të ndryshme (ndryshimet që bazohen në gjini ose në ato që vlerësohen si nevoja bazë në vendet e pasura dhe në vendet e varfëra).

Mësimi 4

Çdo grup merr pesë fletë të bardha A3 si dhe një kopje të të drejtave të fëmijëve (shih shtojcën). Atyre u jepet detyra e mëposhtme:

Merrni dhjetë fotot e varura. Prej tyre merrni ato që ilustrojnë nevojat bazë.

Me radhë, lexoni konventën e të drejtave të fëmijëve për grupin tuaj. Për çdo të drejtë të lexuar, gjeni nëse ajo lidhet me ndonjë nga nevojat në fotot e zgjedhura prej jush (opse me ndonjë nga dëshirat e shprehura në foto).

Merrni pesë fleta A3. Në të majtë ose në mes të pjesës së sipërme të fletës, ngjisni një prej pesë fotove që përfaqëson një nevojë bazë. Në të djathtë ose në fund të fletës, shkruani të drejtën e fëmijëve që përputhet me fotot. Disa prej fotove mund të kenë më shumë se një të drejtë të fëmijëve.

Skiconi dhe zbukuroni pesë fletët, sa më mirë të jetë e mundur, si afishe. Ato duhet të shfaqen në ndërtesën e shkollës në 20 Nëntor (Dita Botërore e Fëmijëve)

Prezantimet e afisheve (pesë për çdo grup). Diskutime përmbyllëse për çështje të tilla si: Sa përputhet ideja juaj për nevojat bazë me ato që thuhet në Konventë?

Të drejtat e fëmijëve - hulumtuar tërësisht

A. Planifikimi

| | Çështjet themelore/temat | Detyrat kryesore | Burimet |
|-----------------|--|---|--|
| Mësimi 1 | A i kuptojmë ne nenet mbi të drejtat e fëmijëve? | Nxënësit zgjedhin nene nga konventa për studim të mëtejshëm të drejtuar gjatë dy mësimëve të mëposhtme. | Kopje të konventës për të drejtat e fëmijëve |
| Mësimet 2 dhe 3 | A i kupton gjithkush kriteret? Si mund të ndihmojë mësuesi pa ndërhyrë shumë fort? | Nxënësit punojnë me shpejtësinë e tyre në grupet e vogla. Ata analizojnë nenet nga konventa e të drejtave të fëmijëve dhe projektojnë diagramet që lidhen më shikuesit. | Revista, letër, ngjitës, gërrshërë |
| Mësimi 4 | Çfarë kemi mësuar? Sa kërkuese ishte detyra jonë? Si e kemi përdorur ne lirinë tonë? | Nxënësit pasqyrojnë procesin e tyre të punës dhe të të nxënës dhe diskutojnë se si të ekspozojnë produktet e tyre. | Posterat e përfunduar |

B. Informacion dhe objektiva mësimore

Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve do të mbeten thjesht një vizion në letër në qoftë se nuk bëhen kuptimplotë për jetën reale të një personi. Prandaj, ato duhet të kuptohen dhe të lidhen me përvojën konkrete, që do të thotë se, ato duhet të zbatohen në jetën e përditshme dhe shkeljet e tyre duhet të identifikohen. Por hapi i parë merr kohë.

Nëse nxënësit duhet të kuptojnë të drejtat e fëmijës, që është edhe fokusi ynë këtu, ata duhet të punojnë me to. Vetëm dëgjimi ose leximi nuk mjafton. Të kuptuarit kritik dhe zbatimi i të drejtave të fëmijëve është qëllimi i këtij kapitulli dhe i gjithë librit.

Një vërejtje duhet të bëhet këtu për termin "të drejtat e fëmijëve", meqenëse kjo, herë pas here, shkakton acarim të madh tek adoleshentët. Me të drejtë, ata nuk duan të quhen fëmijë. Megjithatë, të drejtat e fëmijëve janë gjithashtu të zbatueshme edhe për ta, të paktën deri në moshën 18 vjeç.

Adoleshentët duhet të kuptojnë se të drejtat e fëmijëve u sigurojnë atyre një instrument që mund t'i ndihmojë për të identifikuar rastet e padrejtësisë dhe për të kërkuar drejtësi. Duke ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijës, çdo shtet pranon detyrimin për të zbatuar këto të drejta me të gjitha mjetet e mundshme; nga ana tjetër kjo nënkupton prioritet të lartë në procesin e zbatimit dhe përfshin mbështetje për fëmijët dhe të rinjtë, që ata t'i përdorin e t'i gëzojnë të drejtat e tyre.



Në projektin mësimor për klasën e shtatë, ne sugjerojmë që nxënësit duhet të merren me konventën në thellësi, duke gjurmuar rastet e zbatimit dhe, përkatësisht, shkeljet e të drejtave të fëmijëve në sferat e jetës së tyre të përditshme. Objektivi i projektit është edhe një ekspozitë me postera për të gjitha të drejtat e fëmijëve. Çdo poster përmban elemente të përshkrimit të përmbajtjes, analizë dhe ilustrim të të drejtës në fjalë. Kjo qasje nxit analizën si dhe krijueshmërinë për temën në shqyrtim.

Nga pikëpamja didaktike, kjo ekspozitë ofron një rast dhe një nxitje për t'u marrë me një nen specifik nga konventa. Ndoshta, mësuesit nga klasat e tjera mund të shërbejnë si një juri që të përzgjedhë posterin më të bukur për të cilin jepet një çmim i vogël (për shembull, bileta për në kinema, kupon për libër).

Shembujt nga jeta lokale ose nga një kontekst ndërkombëtar duhet të merren nga media të ndryshme të shkruara e të sjella në shkollë nga nxënësit. Leximi i gazetave dhe i revistave, do të jetë një element thelbësor i përgatitjes. Pa të mësuarit bashkëpunues (puna në grupe të vogla projekti), nxënësit nuk do të arrijnë objektivat e tyre. Ky është një synim i mëtejshëm i mësimdhënies së këtij projekti.

Projekti duhet të mbulojë afërsisht katër mësimet. Lexuesi do të kuptojë se, jo çdo mësim është i plotë në vetvete, por të gjitha mësimet i përkasin një të përbashkëte. Brenda grupeve, nxënësve duhet t'i jepet mundësia të hartojnë vetë planifikime të arsyeshme për veten e tyre.

Me idenë e hapjes së ekspozitën në ditën e fëmijëve, është e këshilueshme që projekti të fillojë në fund të tetorit ose në fillim të nëntorit.

C. Pyetjet kryesore për reflektim për kapitullin 8

| Përjetimi i të drejtave të fëmijëve | Njohja e të drejtave të fëmijëve | Zbatimi i të drejtave të fëmijëve |
|--|---|--|
| <i>Mësuesi</i> | | |
| Si janë thjeshtuar parimet e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe në klasë? | Çfarë dinë fëmijët për të drejtat e fëmijëve? | Të mësojnë si të ndërmarrin veprime jashtë shkollës: çfarë kanë mësuar nxënësit për jetën e tyre në të ardhmen? |
| Nxënësit e perceptojnë klasën dhe shkollën si një mjedis të të mësuarit stimulues. Gazetat e përditshme janë shndërruar në materiale për punë. Në këtë mënyrë, shkolla bëhet një vend ku nxënësit mund të shohin jetën e tyre të përditshme. | Nxënësit mësojnë si të analizojnë të drejtat e fëmijëve, duke përdorur një qasje sistematike. | Duke mësuar se si të paraqesin një produkt (këtu, një poster), nxënësit bëhen të aftë për të vëzhguar dhe paraqitur çështje të rëndësishme jashtë shkollës. |
| <i>Nxënësit</i> | | |
| Çfarë unë kam mësuar për të drejtat e fëmijëve? | Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në klasë? | Cilat janë veprimet që jam në gjëndje të ndërmarr tani? |
| Unë kam përjetuar se si shokët e mi nxënës dhe mësuesi im më kanë inkurajuar dhe sfiduar mua. Të dyja mënyrat e ndërveprimit janë mbështetjeje për mua. | Unë bëhem i vetëdijshëm se sa saktësisht janë formuluar nenet e konventës për të drejtat e fëmijëve dhe se si shumë aspekte janë të fshehura në to. Unë kam mësuar t'i analizoj dhe të mendoj rreth tyre. | Unë jam i përgatitur për të marrë pjesë në debate publike për çështje që i kuptoj. Unë jam i gatshëm të argumentoj mendimet e për të drejtat e fëmijëve dhe të njeriut dhe jam i gatshëm të dëgjoj mendimet e njerëzve të tjerë. |

Materiale

- tabak i madh letre (A2 ose afishe)
- letra në ngjyra të ndryshme
- markera
- gërshërë
- ngjitës
- gazeta ose revista të vjetra
- piktura ose fotografi
- teksti i Konventës për të Drejtat e Fëmijës (shih shtojën), një kopje për nxënës
- fletë ku përshkruhet detyra, një kopje për grup (shih mësimin 2)

D. Procedura

Mësimi 1

Mësuesi paraqet planin e plotë të katër mësimëve të mëposhtme për nxënësit. Klasa duhet të ketë kuptuar se detyra e saj është të krijojë afishe që tregojnë të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë, ndoshta, edhe një konkurs. Është mirë që të p unohet me nxënësit për të aktivizuar njohuritë e tyre paraprake për të drejtat e fëmijëve.

Mësuesi u jep nxënësve kopje Konventës për të Drejtat e Fëmijës përfshin 54 nene, nga të cilat 41 të parët, ndoshta 42 në më të shumtën, lidhen drejtëpërdrejt me nxënësit.

Detyra: Në fillim, të gjithë nxënësit duhet të lexojnë të gjithë konventën dhe të bëjnë zgjedhjen e tyre personale për tri nene që ata i konsiderojnë më me rëndësi të veçantë për ta.

Në një listë të përgatitur ng mësuesi me numrat e neneve të ndryshme, nxënësit shënojnë nenin që sipas tyre është veçanërisht i rëndësishëm. Pastaj, shenjat numërohen dhe bëhet një listë me nenet më të zgjedhur.

Pas kësaj, mësuesi drejton diskutimin me çështje të tilla si stimuj për diskutime:

- Si u vendosën përparsitë dhe cilat janë motivet që qëndrojnë pas zgjedhjes së tyre?
- Si reflekton kjo zgjedhje e përparësish situatën reale të fëmijëve dhe adoleshentëve?
- A mund të identifikoni ju një model ose parim themelor?
- Cilat elemente janë lënë jashtë?

Mësimi 2 dhe 3

Nxënësit duhet të punojnë në grupe prej tre vetash. Mësuesi mund t'i formojë grupet në mënyrë të ndryshme:

- Së pari, grupet mund të krijohen nëpërmjet një procedure rastësore.
- Së dyti, nxënësit janë të lirë të zgjedhin partnerët e tyre, megjithëse dinamika e klasës dhe përfshirja duhet të merren parasysh.
- Së treti, mësuesi përdor kritere transparente

Para se të fillojë puna, grupet duhet të vetë-organizohen. Nxënësit i vënë një emër grupit të tyre dhe shpërndajnë tri detyra. Çdo grup ka nevojë për një menaxher kohe, një menaxher për materialet dhe një koordinator. Grupi shkruan se cila është përgjegjësia për secilin anëtar. Fletët e planifikimit në madhësi A2 varen në klasë. Më vonë, grupet do të shtojnë nenet për të cilat janë duke punuar. Përcaktimi i roleve në këtë mënyrë nuk ka të bëjë fare me punën aktuale të nxënësve, por do të mbështesë nxënësit në zhvillimin e kompetencës sociale dhe në arritjen e qëllimeve të tyre. Ndërkohë, mësuesi ka marrë 10 nenet e përzgjedhura më shpesh në dërrasën e zezë dhe i vendos mbi tavolinë, me pamje poshtë. Koordinatorët e grupeve do të zgjedhin një nen në mënyrë të rastësishme dhe u përshkruhet detyra e re si më poshtë:

Detyra

Secili grup përgatit një poster mbi të drejtat e fëmijëve.
Posterit përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

- titulli i të drejtës së fëmijëve;
- teksti i nenit nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- një foto e cila simbolizon të drejtën;
- një nen i gjetur dhe i marrë nga një gazetë ose revistë që i referohet kësaj të drejte dhe një

shpjegim se si incidenti lidhet me të. (A është ky një shembull se si është shkelur apo mbrojtur kjo e drejtë?)

Pasi ka përfunduar posteri, grupi do të zgjedhë një nen tjetër nga ato të mbetura dhe do të krijojë një poster të dytë në të njëjtën mënyrë. Grupet bëjnë një shënim të nenit mbi fletën e grupit.

Grupet e punës studiojnë detyrën e tyre dhe vendosin për përgjegjësitë në grup (sipas funksioneve të përmendura më sipër)

Për tani (mësimi 2), ata ndërtojnë listën e materialeve të duhura dhe shënojnë ndonjë pyetje që mund të kenë hasur. Pastaj grupet bien dakord për planet e tyre. Çfarë duhet bërë? Çfarë duhet të mblidhet? Çfarë mund të sjellë çdo anëtar i grupit nga shtëpia? Si i ndërton afatet kohore menaxheri i kohës? Ku do të ruhen materialet?

Mësuesi duhet të kontrollojë çdo grup deri në fund të mësimit, për të parë nëse puna është ndarë si duhet në të gjithë anëtarët e grupit. Është i rëndësishëm dialogu i ndërtuar me pyetjet e mëposhtme: Ku jemi me detyrën? Ku kemi nevojë për ndihmë? A jemi dakord me ndarjen e detyrave në grup? A janë të gjithë të qartë për çfarë do të kërkojnë ose të mbledhin në shtëpi?

Pastaj, (si detyrë shtëpie ndërmjet mësimëve 2 dhe 3, si dhe gjatë mësimit 3), fëmijët shohin në produktet e kërkimit të tyre, gjërat që paraqesin sfidat kryesore për ta, të cilat mund të kenë nevojë për ndihmën e mësuesit. Në mësimin 3, nxënësit sjellin në klasë gjërat e mbledhura. Një pikë e rëndësishme e mësimit 3 është krijimi i një afisheje që të jetë tërheqëse. Mësuesi mund të këshillojë nëse është e nevojshme..

Qartësimi i detyrave për ekspozitën. Ku duhet të vendoset ajo dhe kur? Kush do ta hapë? Kush do të jetë i ftuar në ceremoninë e hapjes? A do të ketë ndonjë çmim për afishen më të mirë? Kush do të jenë anëtarët e jurisë?

Mësimi 4

Paraqitja e afishës së përfunduar dhe diskutimi.

Qartësimi i çështjeve në lidhje me ekspozitën (nëse është e planifikuar).

Vlerësimi i punës së bërë gjatë projektit (ndarja e detyrave, problemet me kërkimin dhe mbledhjen e informacionit, cilat ishin këshillat e dobishme, përvojat e mira/të këqija, dinamika e grupit etj.)

Duke përfunduar vlerësimin e temës së të drejtave të fëmijëve: Çfarë duhet bërë për të përmirësuar gjendjen? Çfarë duhet bërë tjetër? Çfarë hapash konkretë mund të ndërmerren? Kur është e nevojshme ndërhyrja e autoriteteve? Etj.

Kapitulli 9 (arsimi bazë, klasa 9)
Përse duhet t'i bindemi rregullave?

A. Planifikimi

| | Çështjet themelore/temat | Detyrat kryesore | Burimet |
|------------|--|--|---|
| Përgatitja | Nxënësit mbledhin informacion për një rast në të cilin një rregull shkollor është shkelur dhe një kur është zbatuar. | Punë individuale: mbledhje informacioni | Fletë faktesh e standardizuar |
| Mësimi 1 | Një nxënës në telashe (studim rasti) | Puna në grup: analizë e një rasti | Fletë pune për një rast studimor |
| Mësimi 2 | Pse ka rregulla shkolla? | Puna në grup: rishikim i rregullave të shkollës, nëpërmjet lenteve të të drejtave të fëmijëve. Detyrë shtëpie: cilat rregulla qeverisin jetën tonë të përditshme? | Tabelë dhe fletë pune: "Pse ka rregulla një shkollë?" Kopje e rregullave të shkollës. Fletë pune: Cilat janë rregullat që duhet t'u bindemi gjatë ditës? |
| Mësimi 3 | Ku kemi nevojë për rregulla në jetë? | Punë në grup: Kush i "shpik", dhe cili i zbaton rregullat jo zyrtare? | |
| Mësimi 4 | Kush duhet t'i vendosë ligjet? (Rregullat për vendosjen e ligjeve). | Punë në grup: Cilat rregulla na sigurojnë nëse ligjet janë të drejta? | |
| Zgjerim | Vazhdim i diskutimit me drejtorin e shkollës ose me këshilltarin pedagogjik | | |

B. Informacion dhe objektiva mësimore

Një parim i rëndësishëm që përshkon të gjithë kapitujt për të drejtat e fëmijëve është “të mësuarit nga përvoja, të mësuarit përmes shembullit”. Kjo ka vlerë edhe për rregullat e shkollës dhe ligjet në përgjithësi. Shkolla është jeta, ajo mund të shihet si një pamje e zvogëluar e shoqërisë. Rregullat i shërbejnë shkollës si edhe ligjet i shërbejnë komunitetit politik – të mbrojnë të drejtat e njeriut.

Po t’i shohësh më nga afër, paralelet, por edhe ndryshimet ndërmjet rregullave në shkollë dhe ligjeve në nivel të bashkësisë politike, bëhen më të qarta:

Paralelet:

- Nuk ka komunitet që mund të mbijetojë pa një marrëveshje ndërmjet anëtarëve të tij për t’iu bindur ligjeve.
- Ligjet mbrojnë të dobëtit. Ligjet janë instrumente për të zbatuar të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve.
- Ligjet duhet të zbatohet, por kjo duhet të jetë përjashtim. Ato do të jenë efikase vetëm në qoftë se do të kuptohen dhe vlerësohen nga të gjithë. Prandaj ligjet duhet të jenë të drejta.

Dallimet në mes shkollës dhe komunitetit politik:

- Bërja dhe zbatimi i ligjeve është një ushtrim i pushtetit. Pushteti duhet të jetë objekt i kontrollit. Prandaj, ligjet duhet t’i përmbahen parimeve të të drejtave të njeriut dhe pushteti për të bërë ligje dhe për t’i zbatuar duhet të ndahet dhe të kontrollohet në një komunitet demokratik.
- Brenda komunitetit shkollor, përgjegjësia për përcaktimin dhe zbatimin e rregullave të shkollës mbetet mbi drejtorinë e shkollës dhe stafin arsimor. Megjithatë (sikundër me ligjet në komunitet), rregullat e shkollës duhet të jenë të hapura për diskutim në dritën e të drejtave të fëmijëve dhe nxënësit duhet të kuptojnë dhe vlerësojnë nevojën për rregullat e shkollës.

Qasja didaktike: Mësimet ndjekin një model të rrrathëve koncentrikë që zgjerohen. Mësimi 1 shqyrton një rast të veçantë të një rregulli në shkollë, që zbatohet pasi është shkelur. Mësimi 2 merret me problemin e qëllimit të cilit i shërbejnë rregullat e shkollës. Ky mësim ofron përgjigjen se shkolla i shërben disa të drejtave të fëmijës dhe se rregullat e shkollës janë mjete të rëndësishme për mirëfunksionimin e saj. Mësimi 3 kalon përtej horizontit të përvojës shkollore dhe hedh vështrimin te rregullat në sfera të tjera të jetës. Në fund, Mësimi 4 heq linjën bashkuese nga rregullat te ligjet dhe shtron pyetjen se kush duhet të ketë fuqi të imponojë ligje, të cilave, ne të gjithë, pritët t’u bindemi.



C. Pyetjet kryesore për reflektim për kapitullin 9

| Përjetimi i të drejtave të fëmijëve | Njohja e të drejtave të fëmijëve | Zbatimi i të drejtave të fëmijëve |
|---|--|---|
| <i>Mësuesi</i> | | |
| Si janë thjeshtuar parimet e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe në klasë? | Çfarë dinë fëmijët për të drejtat e fëmijëve? | Të mësojnë si të ndërmarrin veprime jashtë shkollës: çfarë kanë mësuar nxënësit për jetën e tyre në të ardhmen? |
| Nxënësit mësojnë si të përballen me përvojën e shpërndarjes së pabarabartë të pushtetit. Ata përdorin të drejtat e tyre, por zbulojnë se ekzistojnë kufizime në nivelin që mund të arrijnë. | Të drejtat e fëmijëve janë pjesë e ligjit të shtetit dhe si i tillë është i detyrueshëm për të gjithë. Pavarësisht kësaj ato nuk janë zbatuar plotësisht kudo në botë. | Për nxënësit, kjo përvojë është e rëndësishme, pasi ajo do t'i ndihmojë ata si qytetarë të rritur të shoqërisë civile për të përballuar vështirësitë e hasura në negociata ose humbje politike. |
| <i>Nxënësit</i> | | |
| Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në klasë? | Çfarë unë kam mësuar për të drejtat e fëmijëve? | Cilat janë veprimet që jam në gjëndje të ndërmarr tani? |
| Unë kam mësuar të kaloj nëpër procesin e vështirë të negociimit të të drejtave dhe detyrave. Unë kam mësuar se si të përballem me zhgënjimin dhe humbjen. | Unë di se si të drejtat edhe detyrat janë thelbësore për të jetuar në harmoni. Unë gjithashtu di se të drejtat e fëmijëve janë pjesë e kësaj kornize. | Unë diskutoj të drejtat dhe detyrat, duke përdorur njohuritë e mia. Unë mund të negocioj dhe të diskutoj me përfaqësues të autoriteteve, dhe mundem si të argumentoj edhe t'i dëgjoj ata. |

D. Procedura

Përgatitje për mësimin 1

Rreth një javë përpara mësimit të parë, mësuesi u jep nxënësve detyrën e mëposhtme: nxënësit mbledhin informacion për një rast të kohëve të fundit, në të cilin janë shkelur rregullat e shkollës dhe një nxënës është qortuar ose dënuar (nëse është e mundur, rasti duhet të jetë nga shkolla ose komuniteti, ndonëse mund të përdoren edhe shembuj të tjerë). Mbani shënime duke përdorur një grup të shkurtër pyetjesh të standardizuara.

Mësimi 1: Një nxënës në telashe (studim rasti)

Hyrje (nxënësit ulen në tavolina të vendosura për punë në grup): Disa nxënës raortojnë për kërkimin e çështjes në fjalë. Klasa duhet të vendosë për një rast, të cilin do të dëshironin ta studionin më në thellësi (nëse është e mundur, një rast nga mjedisi konkret social, për të cilin nxënësit nuk është e nevojshme të bëjnë kërkime shtesë).

Thyerja e rregullave të shkollës: Pyetje kyç

1. Çfarë ka ndodhur?
2. Kush është i përfshirë?
3. Çfarë dënimi është dhënë, nëse ka?

Diskutim: Klasa duhet të identifikojë problemin themelor të rastit në fjalë. Kjo e bën të domosdoshme referimin në një rregull të shkollës dhe interpretimin e tij. Mësuesi fton nxënësit të japin komentet e tyre (mundësisht pasi të kenë bërë më parë shënimet e nevojshme). Pikëpamjet e tyre mund të jenë të ndryshme, në varësi të rastit, por edhe mund të përputhen (për shembull, "Ishte mjaft e drejtë që të bëhej diçka" ose: "Unë mendoj se ky dënim është mjaft i padrejtë/shumë i rëndë"). Mësuesi i kërkon një nxënësi të përmbledhë komentet e bëra.

Përmbledhja e mësuesit. Nëse gërvishim pak sipërfaqen e këtij rasti, shpesh shfaqen çështje mjaft komplekse. Ato duhet të shqyrtohen me hollësi për të kuptuar më mirë çështjen dhe të gjitha aspektet e saj.

| Studim rasti: një nxënës në telashe në shkollën tonë | |
|---|--|
| 1. Çfarë ka ndodhur? | |
| 2. Kush e ka zbuluar ose ka raportuar rastin? | |
| 3. Kush është i përfshirë? | |
| 4. Cili është problemi? (Pse ishte e nevojshme për të mbrojtur punën dhe jetën në shkollë?) | |
| 5. Cili rregull i shkollës zbatohet në këtë rast? | |
| 6. Cili dënim, nëse ka, është dhënë? | |
| 7. Çfarë efekti ka dënimi mbi keqbërësin dhe nxënësit e tjerë? | |
| 8.... | |

Nëse është e nevojshme, fleta e punës mund të modifikohet ose zgjerohet në seancën plenare.

Grupet zgjedhin një folës dhe mundësisht edhe role të tjera (mbajtësi i kohës etj.). Pastaj, anëtarët e grupeve diskutojnë për rastin dhe mbajnë shënim të gjitha idetë në fletën e punës së dhënë. Në mënyrë të veçantë, ata diskutojnë pyetjen 4 dhe 7, sepse ato trajtojnë çështjen themelore të problemit

Për kohën e mbetur: Çdo grup vendos për formën dhe përmbajtjen e përgjigjeve për pyetjet 4 dhe 7, të cilat folësi i tyre i paraqet para klasës në mësimin e ardhshëm.

Mësimi 2: Përse shkolla ka rregulla? (kohëzgjatja rreth 1 ½ mësimi)

Prezantim, pastaj diskutim për detyrën e fundit të mëimit: Një folës nga çdo grup paraqet përgjigjet e pyetjeve 4 dhe 7. Pas kësaj fillon diskutimi.

Nxitje:

Për çfarë kanë rënë dakord nxënësit? Ku dallojnë pikëpamjet?

Çfarë pëlqeva unë? Më çfarë rashë dakord? Çfarë më shqetësoi? Çfarë më duket e papranueshme? Përse?

Në përgjithësi, gjetjet e nxënësve (të mbështetura nga mësuesi) duhet të jenë: Ne të gjithë i gëzojmë të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat civile që duhet të respektojmë në shkollë. Për të aftësuar shkollën që të mbrojë këto të drejta, duhet të vëzhgohen disa kushte. Mësuesi ose një nxënës përmbledh këtë ide si më poshtë: Shkolla është vendi ku shumë njerëz, të rinj e të rritur takohen dhe punojnë së bashku. Kjo duhet të organizohet, që do të thotë, kërkohen rregulla, duke përfshirë edhe rregullin që mësimi duhet të fillojë

dhe të mbarojë në kohë, edhe me mësuesin që është i pranishëm në klasë. Përveç kësaj, shkolla është përgjegjëse e drejtpërdrejtë për disa nga të drejtat më të rëndësishme të fëmijëve: së pari dhe mbi të gjitha, për të drejtën për arsimim.

Ndërhyrje e mësuesit dhe diskutim për të drejtën për arsimim: Ku është shkruar kjo e drejtë?

Diskusimi mund të mbështetet nga mësuesi, i cili jep një leksion të shkurtër për të drejtat e fëmijës dhe për lidhjen e tyre me shkollën. Në vijim mund të përdoret tabela e mëposhtme, e cila mund të zgjerohet në një tabak të madh letre ose në një projektor.

| Pse ka rregulla një shkollë? | |
|---|---|
| Të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve (konventa 1989) | Cilat rregulla i mbrojnë këto të drejta në shkollën tonë? |
| Neni 13: Liria e shprehjes | |
| Neni 14: Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë | |
| Neni 24: Mbrojtja e shëndetit | |
| Neni 28: E drejta e arsimimit, duke përfshirë qasjen në arsimin e lartë dhe masat për të siguruar vijimin e rregullt në shkollë | |
| Neni 31: E drejta e fëmijës për të pushuar dhe për të pasur kohë të lirë | |
| Neni 33: Mbrojtja nga drogat narkotike | |
| Neni 37: Mbrojtja ndaj trajtimit çnjerëzor | |

Leksion dhe diskutim për temën: Duke vëzhguar rregullat e shkollës nga pikëpamja e të drejtave të fëmijëve: Përse shkolla ka rregulla?

Mësuesi shkruan temën në dërrasën e zezë: "Pse ka rregulla një shkollë?" Ai shpërndan kopje të rregullave të shkollës ose të klasës, tabak letre dhe marker. Ai i shpjegon detyrën klasës:

- Formoni grupe me nga katër. Fillimisht punoni vetëm. Lexoni rregullat e shkollës. Ku të jetë e mundur, përpikuni të lidhni çdo rregull, me një të drejtë të fëmijëve.
- Pastaj punoni si ekip. Ndani idetë tuaja dhe përpikuni të bini dakord se cili rregull (ose rregulla) të shkollës i shërbejnë një të drejte konkrete të fëmijëve. Shkruani rezultatet në fletët tuaja të punës.
- Merrni fletën e punës "Përse shkolla ka rregulla? Lidhni nenet e Konventës së të Drejtave të Fëmijës me rregullat e shkollës ose të klasës suaj.
- Zgjidhni dy folës për të paraqitur rezultatet përpara klasës.

Nxënësit paraqesin rezultatet e tyre në klasë. Mësuesi këmbëngul në gjykimin e tyre të shëndoshë, si në prezantim edhe në çdo diskutim që mund të lindë.

Në pesë minutat e fundit të mësimit, mësuesi tërheq vëmendjen e klasës për temën e mësimit, çështjen e shkruar në dërrasën e zezë: Pse ka rregulla një shkollë? Përse shkolla ka rregulla? (nxënësit përmbledhin rezultatet e mësimit, duke iu përgjigjur pyetjes së mësipërme: "Shkolla shërben për të drejtën e çdo fëmije dhe adoleshenti për arsimim. Rregullat e shkollës janë për të siguruar që shkolla punon pa probleme dhe në mënyrë efikase në realizimin e qëllimeve të saj" etj.)

Detyra 1, mundësisht si përfundim i këtij mësimi: Shkruani, me disa fjali, një përmbledhje të asaj çfarë keni mësuar për a) temën "Një shkollë pa rregulla" dhe b) për pyetjen "Përse shkolla ka rregulla?"

Detyra 2 (detyrë shtëpie-të kopjohet si fletë pune e veçantë ose në pjesën e prapme të fletës së mëparshme të punës):

Rregullat e një dite

Zgjidhni një ditë të javës suaj. Shkruani në ditar rregullat që duhet të ndiqni (edhe të pashkruarat)

Vështroni rregullat që ju tregojnë si të silleni dhe çfarë të bëni, për shembull:

- kur jeni në shtëpi me familjen tuaj;
- kur takoheni me miqtë tuaj;
- kur blini diçka në dyqan;
- kur lëvizni nëpër qytet.

Vendosni se cilat rregulla janë shkruar si rregulla formale, dhe cilat rregulla ekzistojnë si të pashkruara, ato jo zyrtare. Për shembull, rregullat e shkollës janë zyrtare. Rregullat që na tregojnë se si të sillemi në tryezë ose kur jemi së bashku me familjen ose miqtë tanë janë jozyrtare.

| Koha | Rregulli | Zyrtar/jo zyrtar |
|-------|----------|------------------|
| | | |
| 07.00 | | |
| 08.00 | | |
| 09.00 | | |
| 10,00 | | |
| 11,00 | | |
| 12,00 | | |
| 13,00 | | |
| 14,00 | | |
| 15,00 | | |
| 16,00 | | |
| 17,00 | | |
| 18,00 | | |
| 19,00 | | |
| 20,00 | | |
| 21,00 | | |
| 22,00 | | |
| | | |

Mësimi 3: Kush i bën rregullat në jetë?

Mësuesi kërkon që secili nga nxënësit, si ekspert, të lexojë një ose dy shembuj nga detyrat e tyre të shtëpisë. Ai sigurohet që nxënësit të përfshijnë shembuj të të dy llojeve të rregullave, si të atyre zyrtare ashtu edhe jo zyrtare.

Pasi nxënësve u është dhënë shansi të japin shembujt nga shënimet e tyre, mësuesi përzgjedh dy prej tyre dhe i integron në një tabelë të thjeshtë, të paraqitur në dërrasë të zezë:

| Lloji i rregullave | Përmbajtja | I ndërtuar nga ... | I zbatuar nga ... |
|---|--|--------------------|-------------------|
| Rregull zyrtar (për shembull një ligj): | Ju nuk duhet të kapërceni rrugën kur semafori është i kuq. | | |
| Rregull jo zyrtar | Ju nuk duhet të gromësin kur jeni në tryezë. | | |

Mësuesi i fton nxënësit të shprehin mendimin e tyre në dy kolonat për dënimet që ata mendojnë se duhet të zbatohen në rastet e shkeljes së një rregulli. (Rregullat e trafikut, në fakt ligji, do të provojë se në mënyrë të drejtpërdrejtë: është vendosur nga Ministria e Trafikut (draft) dhe parlamenti (legjislativi), i zbatuar nga policia dhe nëse është e nevojshme, gjykatat (për shembull, nga gjrobat). Më të vështira (por ndoshta më interesante për diskutimin) janë ligjet e pashkruara, për shembull, të mos gromësimë në tryezën e ngrënies; ndëshkimet, në këtë rast, varen nga familja dhe nga kultura. Mësuesi duhet t'u japë nxënësve mundësinë për të vepruar si ekspertë, me fjalë të tjera, t'u kërkojë sa më shumë për të marrë pjesë në diskutimin plenar. Informacioni shtohet në tabelë.

Megjithatë, nxënësit do ta kenë mjaft të vështirë të thonë se kush i ndërton rregullat e pashkruara. Në shembullin e marrë këtu (sjelljet në tryezë), ata mund të thonë se kjo është pjesë e traditës, diçka mbi të cilën këmbëngulin prindërit e tyre dhe të rriturit. Mund të ketë nxënës që do të donin që këto rregulla të mos ekzistonin fare! Ndoshta nxënësit do të zbulojnë se ka sanksione të qarta nëse ky rregull thyhet, veçanërisht në qoftë se prindërit ose një mësues e tyre janë të pranishëm. Atyre mund t'u kërkohej të largohen ose të lënë tryezën. Madje mund të ketë edhe një ndëshkim të nënkuptuar, përshtypja e keqe që lë. E parë nga ky këndvështrim, ne të gjithë luajmë rolin tonë në zbatimin e rregullave të pashkruara. Megjithatë, dialogu në klasë nuk mund të mos arrijë në këtë pikë. Nxënësit mund të pyesin vetëm për shpikësit dhe zbatuesit e rregullave jozyrtare. Në çdo rast, nxënësit janë ekspertë për veten e tyre, dhe ata janë përgatitur duke mbledhur shembuj të rregullave që qeverisin jetën e tyre të përditshme.

Nxënësit formojnë grupe me nga katër ose pesë persona. Ata kanë për detyrë të ndajnë me të tjerët shembujt e rregullave jo zyrtare në fletën e tyre të punës dhe të zbulojnë si sigurohet zbatimi i tyre dhe cilat janë ndëshkimet nëse këto shkelen. Për veç kësaj, A ka rregulla që lidhen në mënyrë të veçantë me gjininë, normat dhe ligjet?

Nxënësit raportojnë rezultatet në seancë plenare. Pika të mundshme për t'u përqendruar gjatë diskutimit janë:

- Lloji dhe vendi i rregullave të pashkruara tek bashkëmoshatarët (me shembuj).
- Kush i përcakton ose i ndryshon rregullat e pashkruara dhe ndëshkimet në rastet e shkeljes së tyre?
- Rregullat e pashkruara që lidhen me gjininë.
- Cilat janë mundësitë tona për të përcaktuar ose për të ndryshuar rregullat e pashkruara? Ku dhe kur ne kemi të drejtë të themi mendimin tonë dhe zëri ynë mund të dëgjohet?

Mësimi 4: Kush duhet të lejohet për të hartuar ligjet? (Rregullat për hartimin e ligjeve).

Mësuesi e fillon mësimin duke i kujtuar klasës zbulimet e tyre në mësimin e fundit. Nxënësit kanë vëzhguar rregullat dhe ligjet jozyrtare. Në këtë mësim, ata do të shqyrtojnë më hollësisht procesin e hartimit të tyre.

Mësuesi jep "shembullin" e mëposhtëm të një ligji të (shkruar në një copë të madhe letre ose kartoni me një lapustil që të mund të shihet nga e gjithë klasa.

Të gjithë burrat e lindur në prill nuk duhet të paguajnë taksa.

Diskutim: Nxënësit mund të komentojnë lirisht, të nxitur, nëse është e nevojshme, edhe nga disa pyetje të hapura. Idetë e tyre mund të përqendrohen në pika të tilla si:

Ky ligj është i padrejtë, pasi kjo është shkelje e parimit të mosdiskriminimit.

Ai madje diskriminon grupe të ndryshme (të gjitha gratë, jo vetëm ato të lindura në prill).

Ai në mënyrë të qartë, u shërben interesave të një grupi të vogël njerëzish – burrave të lindur në prill.

Ligjet duhet t'i shërbejnë të mirës së përbashkët. Prandaj ligje të tilla duhet të parandalohen.

Ligjet e padrejta do mbjellin konflikt në komunitet dhe madje edhe mund ta shkatërrojnë atë.

Mësuesi u kërkon nxënësve të formojnë grupe me katër ose pesë vetë dhe u jep detyrën e mëposhtme: Nxënësit duhet të diskutojnë se cilat rregulla dhe parime janë të nevojshme për t'u mbrojtur nga legjislacioni i padrejtë. Ata duhet të bien dakord për jo më shumë se tri elemente kyçe për prezantimin e tyre të mëvonshëm.

Prezantim, diskutim, krahasim në seancë plenare.

Kush i bën ligjet në vendin tuaj? Mbledhja e përvojave paraprake të nxënësve; përmbledhja shkurtimisht e prezantimeve nga mësuesi. Çështjet kryesore:

Kushtetuta përfshin të drejtat e njeriut, duke përfshirë parimet e barazisë dhe lirisë personale. Ajo përmban edhe një seksion që përcakton kush mund të krijojë ligjet: ai është një organ i përfaqësuesve, të cilët kalojnë një ligj me shumicë votash. Këta përfaqësues kandidojnë në zgjedhje dhe, për këtë arsye, i nënshtrohen edhe kontrollit nga qytetarët. Disa ligje vendosen me votim të drejtëpërdrejt.

Nëse është e mundur, mund të zhvillohet një diskutim përmbyllës për të vlerësuar atë që është mësuar në këtë kapitull dhe për të hedhur vështrimin në të ardhmen e nxënësve, si të rritur në një shoqëri të modeluar nga normat dhe ligjet.

Pjesa 2: Informacion i përgjithshëm

1. Disa pyetje të shpeshta në lidhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Përse bën fjalë Konventa?

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve është një traktat ndërkombëtar i të drejtave të njeriut për të rinjtë. Ajo u pranua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1989. Konventa është e përbërë nga 41 nene rreth të drejtave të rinjve, një nen për ndërgjegjësimin e publikut dhe edukimin, dhe 12 nene për mënyrën se si të monitorohet, ratifikohet dhe zbatohet konventa. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve është miratuar nga më shumë vende se çdo traktat tjetër ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Deri në janar të vitit 1996, atë e kishin nënshkruar ose ratifikuar 187 vende.

Kush quhet një fëmijë sipas konventës?

Kur OKB-ja thotë "fëmijë", ajo nënkupton të gjithë të rinjtë nën 18 vjeç, përveçse kur mosha e shumicës (kur dikush konsiderohet i rritur) arrihet më herët. Neni 1 i Konventës na e thotë në këtë mënyrë.

Si funksionon konventa?

Edhe pse Konventa nuk është një ligj kombëtar, parimet e konventës duhet të pasqyrohen në legjislacionin, politikat dhe programet kombëtare të vendeve të cilat e kanë nënshkruar dhe ratifikuar atë. Qeveritë duhet të dorëzojnë raporte të rregullta në Kombet e Bashkuara për përparimin e tyre në zbatimin e konventës. Sistemi i raportimit ushtron presion mbi qeveritë që ato të respektojnë të drejtat e të rinjve.

A mundet një konventë të OKB-së të bëjë ndonjë ndryshim në jetën tonë?

Duke ratifikuar konventën, qeveritë angazhohen të respektojnë të drejtat e personave nën 18 vjeç për pjesëmarrje në vendimet që i prekin ata, për mbijetesën dhe mbrojtjen nga çdo rrezik. Neni 4 thotë se kur qeveritë miratojnë konventën, ato do të marrin "të gjitha masat e duhura" për ta vënë atë në praktikë. Ajo gjithashtu thotë se kur veprojnë për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, qeveritë bien dakord për të bërë maksimumin e mundshëm me mjetet që kanë në dispozicion. Pasi marim vesh se çfarë do të thotë dhe nënkupton konventa, ne mund të punojmë për të garantuar që këto të drejta do të jenë rregullat që do të përcaktojnë se si do të trajtohen të rinjtë.

2. Të drejtat e fëmijëve – Pjesë e procesit të të drejtave të njeriut

Të drejtat njerëzore të fëmijëve dhe standardet për të cilat duhet të aspirojnë të gjitha qeveritë në realizimin e këtyre të drejtave për të gjithë fëmijët, janë më koncize dhe plotësisht të artikuluar në një traktat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut: në Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Konventa është instrumenti më i pranuar, në nivel botëror, i të drejtave të njeriut në historik. Ajo është ratifikuar nga çdo vend në botë, përveç dy vendeve dhe për këtë arsye, në mënyrë unike, i vendos fëmijët në qendër të skenës, në përpjekjet për zbatimin universal të të drejtave të njeriut. Duke ratifikuar këtë instrument, qeveritë kombëtare janë angazhuar për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të fëmijëve dhe kanë rënë dakord për të mbajtur përgjegjësi para bashkësisë ndërkombëtare për këtë angazhim,

E ndërtuar mbi sisteme dhe tradita të ndryshme ligjore e kulturore, Konventa për të Drejtat e Fëmijës është një grup universalisht i pranuar i standardeve dhe detyrimeve të panegociueshme. Ajo deklaron drejtat themelore të njeriut që fëmijët kudo – pa diskriminim – kanë:

- e drejta për mbijetesë;
- e drejta për zhvillim sa më të plotë;
- e drejta për mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme, abuzimi dhe shfrytëzimi;

e drejta për të marrë plotësisht pjesë në jetën familjare, kulturore dhe sociale.

Çdo e drejtë e shkruar në konventë është e natyrshme për dinjitetin njerëzor dhe për zhvillimin e harmonishëm të çdo fëmije. Konventa mbron të drejtat e fëmijëve me vendosjen e standardeve në kujdesin shëndetësor, arsimin dhe shërbimet ligjore, civile dhe sociale. Këto standarde janë etaloni kundrejt të cilave mund të vlerësohet progresi. Shtetet që janë palë në konventë janë të detyruar të zhvillojnë dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet dhe politikat nën dritën e interesave më të mira të fëmijës.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës është i pari instrument ndërkombëtar, ligjërish i detyrueshëm që përfshin gamën e plotë të të drejtave të njeriut – të drejtat civile dhe politike, si dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Dy protokollat fakultative (për përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura dhe në shitjen e fëmijëve, në prostitucionin dhe pornografinë së fëmijëve, janë miratuar për të forcuar dispozitat e konventës në këto fusha. Ato hynë në fuqi, respektivisht më 12 shkurt dhe 18 shkurt të vitit 2002.

Zhvillimi i shoqërive moderne na drejton në një pyetje tjetër: të drejtat e lirisë mbështetetin zhvillimin e shoqërive pluraliste që inkurajojnë një shkallë të lartë të laicizmit dhe mënyrës së individualizuar të jetesës. Si mundën këto shoqëri të ruajnë një konsensus minimal për vlerat themelore të detyrueshme të gjithë qytetarët?

Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve kanë kontribuar jashtëzakonisht për ta bërë botën një vend më të sigurt dhe më human për të jetuar dhe për modernizimin e sistemeve politike, ekonomike dhe kulturore në të gjithë botën. Megjithatë, ato kurrë nuk duhet të merren si të mirëqena dhe çdo brez duhet të kontribuojë në zhvillimin e tyre, t'i rishqyrtojë ato përsëri dhe të luftojë për to dhe për të përmbushur angazhimin për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve në të ardhmen.

Të drejtat e njeriut, mbi të cilat mbështeten të drejtat e fëmijëve, kanë një traditë të gjatë, me shumë pararendës dhe paralele në fetë dhe filozofitë më të mëdha botërore. Të drejtat moderne të njeriut u shpallën në epokën e Iluminizmit dhe frymëzuan revolucionet në Amerikë dhe Francë. Sot, ato janë përfshirë si deklarata e të drejtave në kushtetutat e shkruara dhe të pashkruara të demokracive moderne. Gjatë gjithë historisë së tyre, të drejtat e njeriut kanë qenë me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e të dobët kundër të fortit. Këtu është vendi, ku të drejtat e fëmijëve, bëhen të rëndësishme: të miturit janë në mesin e grupeve, me statusin ligjor të më të dobët, kundrejt fuqive ekzekutive.

Procesi njerëzor i të drejtave njerëzore, si ai revolucionar edhe ai evolucionar, kanë prodhuar breza të tërë të të drejtave të njeriut: të drejtat klasike të lirisë, të drejtat sociale të përqendruara në vlerën e barazisë dhe, ende në diskutim e sipër, atë të të drejtave ekologjike dhe shoqërore që trajtojnë çështje e zhvillimit dhe varësisë reciproke në një botë gjithnjë e më të globalizuar dhe, si specifikim i mëtejshëm, në të drejtat e fëmijëve.

Zhvillimi dhe zgjerimi i të drejtave të njeriut dhe i të drejtave të fëmijëve është ende – dhe ndoshta gjithmonë do të jetë – në proces: pretendimi universal i të drejtave të njeriut dhe i të drejtave të fëmijëve ka qenë gjithmonë në pikëpyetje. Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve janë deklaruar nga diktaturat dhe regjimet autokratike në gjithë botën dhe zhvillimi dinamik i shoqërisë moderne dhe i teknologjisë shtron pyetje dhe sfida të reja. Për shembull, si mund të mbrohet privatësia e komunikimit në epokën e internetit?

Rëndësia e të drejtave të njeriut është rritur në kuadrin e etikës laike, sikundër janë kodifikuar nga Karta e OKB-së dhe Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut. Ato përfaqësojnë të vetmin grup vlerash që qëndrojnë si një rast i pranuar universalisht nga komuniteti botëror.

Megjithatë, një shtet mund të keqpërdorë të drejtat e tij të sovranitetit si mbrojtje ndërsa shkel të drejtat themelore të njeriut dhe të drejtat e fëmijëve e të qytetarëve të saj. Çështja e e hapur se si të mund të zbatohen dhe mbrohen të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve në një botë të shteteve sovrane, duke përfshirë demokracitë dhe diktaturat mbetet ende një çështje e hapur. Karta e OKB-së, me sa duket, duhet të zhvillohet më tej për të mbrojtur paqen, jo vetëm ndërmjet, por edhe brenda vetë shteteve.

Të drejtat e njeriut janë universale. Ky është angazhimi për të cilin ato qëndrojnë ose bien. Ato janë të pandashme, nuk mund të tregtohen dhe as kufizohen me statusin e folklorit të thjeshtë politik të botës perëndimore.

Të drejtat e njeriut janë të drejta natyrore – ato janë të patjetërsueshme. Asnjë autoritet shtetëror nuk ka pushtetin për të dhënë ose refuzuar të drejtat e njeriut, por ato kanë thjesht mundësinë për t'i njohur dhe mbrojtur ato. Të drejtat e njeriut nënkuptojnë që shteti i shërben individit dhe jo anasjelltas. Ato zbatohen për çdo njeri, pavarësisht nga mosha, gjinia, përkatësia etnike, kombësia dhe kështu me radhë.

Megjithatë, të drejtat e njeriut nënkuptojnë edhe përgjegjësi. Për shembull, e drejta e një individi për liri duhet të jetë e balancuar me atë të njerëzve pranë tij: sfera ime e lirisë nuk mund të shtrihet në kurriz të të tjerëve. Për shembull, liria e shprehjes nuk përfshin të drejtën për të fyer njerëzit e tjerë. Në disa vende, liria e pronës, duke përfshirë pronësinë mbi fabrikat dhe mjetet e prodhimit, është e kufizuar me ligj për kontrollin e vendimeve të menaxhimit në lidhje me sigurinë e punës të të punësuarve. Problemi i balancimit dhe i kufizimit të të drejtave të njeriut janë një burim i përhershëm i çështjeve gjyqësore që duhet të zgjidhen me vendimmarrje n politike dhe/ose juridiksinin kushtetues. Kjo shpjegon gjithashtu arsyet përse kanë lindur, si të thuash, "marka" të ndryshme të të drejtave të njeriut, në demokracitë në të gjithë botën.

3. Si u krijuan të drejtat e fëmijëve?

| | |
|-----------------|---|
| 1945 | Pas Luftës së Dytë Botërore, shumë kombe në botë formuar një bashkim – ata themeluan OKB-në, që është Organizata e Kombeve të Bashkuara. Së bashku ata donin të mbështetnin paqen dhe lirinë në botë. |
| 10 dhjetor 1948 | Në këtë ditë, Kombet e Bashkuara miratuan Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Këto të drejta themelore të të gjitha qenieve njerëzore në botë zbatoheshin edhe për për fëmijët. Por shpejt u sugjerua se fëmijët ishin diçka e veçantë dhe për këtë arsye ata kishin nevojë për mbrojtje të veçantë. |
| 1950 | U ndërtua një draft i parë i të drejtave të fëmijëve. Për disa vite, përfaqësuesit e shteteve anëtare e diskutuan atë në Kombet e Bashkuara. |
| 20 nëntor 1959 | Në këtë ditë, Kombet e Bashkuara miratuan Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës. Një deklaratë e tillë nuk është e detyrueshme për të gjitha shtetet, por ajo ka avantazhin se u drejtohet të gjitha shteteve si një rekomandim për politikat e tyre të ardhshme. |
| 1979 | Në të gjithë botën, ky vit u festua si Viti i Fëmijës. Të drejtat e fëmijëve u menduan dhe u diskutuan kudo. Gjithnjë e më shumë njerëz dëshironin që këto të drejta të përpunoheshin më në detaje për të mirën e fëmijëve dhe, ajo që ishte më e rëndësishme, të bëheshin ligjërishit më detyruese. |
| 20 nëntor 1989 | Në këtë ditë, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi unanimisht Konventën për të Drejtat e Fëmijës ose si quhet Marrëveshja për të Drejtat e Fëmijëve. Që atëherë, pothuajse të gjitha qeveritë e kombeve të botës e kanë nënshkruar këtë konventë për të drejtat e fëmijëve. Duke vepruar kështu, ata premtojnë të përhapin informacion për të drejtat e fëmijëve në vendet e tyre, për t'i zbatuar ato dhe për t'i dhënë vëmendje të veçantë mbrojtjes së fëmijëve. Por ende, në shumë vende të botës, fëmijët vuajnë padrejtësi serioze Secili prej nesh është përgjegjës dhe duhet të ndërmarrë veprime, në qoftë se duam që të gjithë fëmijët në botë të gëzojnë të drejtat e tyre. |

4. Të drejtat e fëmijëve: ushtrimi, njohja dhe zbatimi

Fëmijët nuk duhet vetëm të dinë të drejtat e tyre, por të mësojnë edhe t'i vlerësojnë dhe t'i përdorin ato. Për këtë qëllim, shkolla duhet të ofrojë kuadrin e duhur për t'u mundësuar nxënësve përvoja të gjera të mësuarit në edukimin e të drejtave të fëmijëve. Në lidhje me tre kategoritë kryesore të Edukimit për Qytetari Demokratik (EQD) këto mund të përmbledhen si më poshtë:

Ushtrimi i të drejtave të fëmijëve (të mësuarit përmes): Nxënësit i ushtrojnë të drejtat e fëmijëve si parime që qeverisin klasën dhe komunitetin e shkollës dhe, për rrjedhojë, ndikojnë drejtpërdrejt tek ta. Kjo kategori lidhet me zhvillimin e qëndrimeve, vlerave dhe aftësive.

Njohja e të drejtave të fëmijëve (të mësuarit rreth): Nxënësit njohin dhe kuptojnë të drejtat që kanë. Qëndror në këtë proces, që ka në qendër njohuritë dhe të kuptuarit e të drejtave, është roli i mësuesit.

Zbatimi i të drejtave të fëmijëve (të mësuarit për): Fëmijët nxiten të respektojnë dhe të përdorin të drejtat e tyre në klasë dhe në shkollë. Në këtë mënyrë, ata ushtrohen për rolet e tyre në të ardhmen, si qytetarë të informuar dhe aktivë në një komunitet demokratik (kjo lidhet me pjesëmarrjen, si në shkollë, ashtu edhe në jetë si të rritur).

Të mësuarit në frymën e të drejtave të fëmijëve dhe të njeriut (përmes) dhe të mësuarit si të marrin pjesë në një komunitet demokratik (për) është një përkushtim për të gjithë komunitetin e shkollës. Të gjithë mësuesit dhe drejtuesit duhet të luajnë rolin e tyre si edhe nxënësit dhe prindërit. Këto tre dimensionet e të mësuarit në EQD mbështesin dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Në këtë manual përshkruhen dhe demonstrohen mundësitë për të filluar dhe zbatuar proceset e duhura të të mësuarit. Në mënyrë të veçantë, "ushtrimi i të drejtave të fëmijëve" nënkupton një përzgjedhje të kujdesshme të metodave të mësimdhënies dhe të mësuarit, që u jep nxënësve mundësinë të përjetojnë shkollën si një mikro komunitet që qeveriset nga parimet e të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve. Për të arritur këtë, është e rëndësishme që fëmijët të ndihen të respektuar si persona, mendimi i të cilëve merret parasysh në diskutime dhe vendimmarrje. Përvojat e nxënësve dhe të rinjve duhet të respektohen dhe të studiohen, pasi kjo është pika që lidh përvojën e tyre me njohuritë dhe të kuptuarit e të drejtave të njeriut dhe fëmijëve. Që nxënësit të ushtrojnë, të njohin dhe të zbatojnë të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve, për të marrë pjesë realisht në një komunitet demokratik, në kuadrin shembull të një shkolle, përbën një sfidë të vërtetë për të gjithë komunitetin e shkollës. Për të arritur këtë, kërkohet pjesëmarrja, jo vetëm e mësuesit dhe drejtuesit të shkollës, por edhe e vetë fëmijëve dhe e prindërve të tyre. Pjesë e rëndësishme dhe jetësore në këtë proces është parimi i pjesëmarrjes. Në këtë mënyrë, shumë forma të pjesëmarrjes që janë të pranishme në shkollë dhe në komunitetin e shkollës, bëhen pjesë e edukimit të të drejtave të fëmijëve.

Forma të ndryshme të pjesëmarrjes

Pjesëmarrja mund të marrë forma të ndryshme. Pjesëmarrja mund të fillojë në klasë ose në shkollë ose në komunitetin e shkollës dhe shtrihet në shoërinë e gjerë përtej shkollës.

Të informosh veten për çështjet aktuale dhe lidershipin.
Të shkruajnë për çështjet aktuale dhe lidershipin.
Të diskutojnë për çështjet aktuale.
Të mbështetin një çështje të veçantë në komunitet.
Të formojnë një grup avokatie (ose një parti politike) ose të bashkohen me një organizatë .
Të marrin pjesë në një grup mbështetës.
Të drejtojnë një organizatë jo qeveritare.
Të votojnë në zgjedhje.
Të mbështesin një kandidat për fushatën zgjedhore.
Të shpallin veten si kandidatë elektorale dhe pas zgjedhjeve të punojnë në një zyrë.
Të paguajnë taksat.
Të përfshihen në grupe interesi.
Të kryejnë shërbimin ushtarak.
Të përdorin rrugë të ligjshme, për shembull, duke takuar qeveritarë, të çojnë një çështje në gjykatë etj.

5. Qasja pedagogjike: të mësuarit përmes shembullit

Ky manual përshtat metodën induktive me të mësuarit përmes shembullit. Duke studjuar ose përjetuar një ose disa shembuj, nxënësit mund të kuptojnë një parim abstrakt. Ky manual tregon tre hapat që mësuesi duhet të ndjekë gjatë mësimit përmes shembullit.

Përzgjedhja e kujdesshme e një ose më shumë shembujve; përzgjedhja e mjetit dhe metodës që do të përdoret për t'ia paraqitur atë nxënësve.
Krijimi i fazave të diskutimit dhe të reflektimit, të moderuara me kujdes, gjatë të cilave nxënësit, duke përdorur një shembull, zhvillojnë njohuritë e tyre të përgjithshme për një temë dhe konceptet e saj kryesore. Në fazën e diskutimit dhe të reflektimit, nxënësit zhvillojnë të kuptuarit e përgjithshëm dhe kuptojnë konceptet kryesore të paraqitur përmes shembullit.
Krijimi i shanseve të përshtatshme për të përdorur njohuritë dhe kategoritë e fituara rishtas në kontekste të reja (transferimi i njohurive)

Për të mbështetur mësuesin në realizimin e hapit të dytë, për të gjithë kapitujt mësimorë, përdoret matrica e mëposhtme, që trajton të tre përmasat e EQD dhe edukimin për të drejtat e fëmijëve. Për të drejtuar reflektimin e nxënësve në klasë sugjerohen disa pyetje kyçe. Reflektimi nga nxënësit është i rëndësishëm, pasi objektivat e të mësuarit nuk duhet të jenë vetëm si ide, por duhet të shprehën nga

nxënësit si diçka e kuptuar, e ushtruar, e trajnuar ose si dëshirë e së ardhmes. Duke ndarë idetë e tyre në klasë, nxënësit do të përfitojnë nga njëri-tjetri, ashtu sikurse do të përfitojë i tërë komuniteti i klasës.

Proceset e të mësuarit do të jenë më të efektshme nëse nxënësit e dinë përse dhe për çfarë ata po mësojnë informacionet, konceptet dhe kategoritë, aftësitë ose parimet e sjelljes në komunitetet demokratike. Për këtë arsye, fazat e reflektimit dhe të diskutimit duhet të rezultojnë në përfundime të përgjithshme, sikurse duhet të trajtojnë të gjithë procesin e të mësuarit. Nga pikëpamja e të mësuarit konstruktivist, nxënësit do të njohin metodat personale të të mësuarit në përgjithësi, ç'tipa nxënësish janë, pikat e forta dhe nevojat e tyre të të mësuarit. Mësimdhënia në frymën e të drejtave të njeriut ("përmes") nxit mësuesit t'u mundësojnë nxënësve hapësirën dhe kohën për të mësuar në interes të plotësisimit të nevojave të tyre. Në këtë mënyrë, ne do të njohim profilet tona të të mësuarit, si pjesë e identiteteve tona.

Në këndvështrimin e drejtimit demokratik, mësuesi duhet të mbajë objektivat e të mësuarit në kokën e tij, por t'i ndajë ato me nxënësit, duke e kthyer planifikimin e mësimit nga qëllim në vetvete, në një ushtrim të vendimmarrjes demokratike.

Së fundi, kjo formë e të mësuarit në klasat e të drejtave të fëmijësve u ofron nxënësve një model të organizimit të proceseve të tyre të të mësuarit. Në shoqëritë moderne, proceset e ndryshimit, për shembull, në shoqëri, teknologji, ekonomi, globalizimi ose mjedisi janë bërë më dinamike dhe komplekse. Kjo i vë brezat e ardhshëm përballë sfidave të reja. Për të arritur suksese në punë dhe në pjesëmarrjen në vendimmarrje, ata do të përshihen në një proces të mësuarit që zgjat gjatë gjithë jetës, për të zgjidhur probleme që sot është e pamundur të parashikohen. Për këtë arsye, nxënësit duhet të bëhen ekspertë në të mësuarit bashkëpunues, në punën me projekte, proceset e vlerësimit dhe të zgjidhjes së problemeve. Në këtë manual, sugjerohen disa nga hapat e parë për fëmijët, në fillimet e jetës së tyre të gjatë, si nxënës të përjetshëm.

6. Të mësuarit në bazë të detyrës: të mësuarit shoqëruar

Kapitujt janë ndërtuar si projekte të shkurtëra; nxënësit përballen me probleme tipike për punën me projekte, që lidhen me lëndën, organizimin e punës, komunikimin, regjistrimin e kohës etj. Duke gjetur rrugët për të identifikuar dhe zgjidhur problemet, nxënësit zhvillojnë një numër kompetencash (të mësuarit e bazuar në detyrë).

Në kapitullin 1, fëmijëve u është dhënë detyra të krijojnë një lule me emrat dhe fotot e nxënësve. Forma e lules është në dorën e nxënësve. Po kështu, është në zgjedhjen e tyre ku dhe si do të gjejnë materialet, fotot dhe planifikimin e kohës. Në këtë mënyrë, ata do të mësojnë shumë "duke punuar", ndërkohë që mësuesi duhet të mendojë me kujdes për planifikimin e detyrës dhe të pyetjeve të tilla si: Sa kohë do t'u lihet nxënësve për detyrën e tyre? Cilat janë materialet që ai duhet të sigurojë për ta? A duhet që ai të ndihmojë me disa nga pjesët e luleve të parapërgatitura? (shih variantet për projektin e paraqitur në kapitullin 1).

Ky shembull tregon se, që në moshën e vogël, fëmijët nxiten të marrin përsipër përgjegjësi për punën e bërë në klasë, duke ndarë faktikisht përgjegjësinë e tyre me mësuesin. Përvoja është e rëndësishme nëse nxënësit duhet të planifikojnë punën e tyre në mënyrë të pavarur, në moshë më të madhe.

Në edukimin e të drejtave të njeriut, si degë e EQD, mësuesit i duhet të kryejë role dhe veprimtari të larmishme.

Të mësuarit "rreth" të drejtat e fëmijëve ngjan me funksionin klasik të mësimit dhe të informimit: nga një lektor, duke lexuar një detyrë, duke parë një video klip etj. Nga ana tjetër, të mësuarit "përmes" dhe "për" të drejtat e fëmijëve, kërkon nga mësuesi të reflektojë për sjelljen dhe personalitetin e tij si model sjelljeje. Nxënësit e vlerësojnë mesazhin e një të rrituri si të besueshëm, nëse ai ose sjellja e tij e mbështet atë, për shembull, me tonin e zërit, mirëkuptimin, tolerancën, paanshmërinë ose nxitje. Të gjitha kapitujt e këtij libri tregojnë se metodat e mësimdhënies dhe të mësuarit lidhen ngushtë me lëndën. Metoda e të

mësuarit e bazuar në detyrë kërkon planifikim dhe përgatitje të kujdesshme nga mësuesi, i cili në këtë rast, mund të shfaqet më pasiv në klasë. Megjithatë, gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi duhet t'i vëzhgojë me vëmendje për të identifikuar kompetencat dhe nevojat e tyre të të mësuarit nga pikëpamja e njohurive dhe të kuptuarit, aftësive dhe vlerave.

7. Mësimi i të drejtave të fëmijëve: Pyetje kyç për të drejtuar zgjedhjen e metodave të mësimdhënies

Në këtë manual, ne jemi përpjekur të përshkruajmë projekte të vogla për të mësuar të drejtat e fëmijëve, në një mënyrë të tillë që qasja themelore të jetë me bazë detyre, e fokusuar në zgjidhjen e problemeve, në të mësuarit ndërveprues me në qendër nxënësit, në shkollën si model komuniteti, të udhëhequr nga parimet e të drejtave të njeriut dhe fëmijëve. Mësuesi mund të transferojë këtë qasje në detyra dhe tema të tjera. Metoda e mësimdhënies në këtë qasje merr një peshë të rëndësishme të mesazhit. Kompetenca e përzgjedhjes së metodave që mbështesin përmbajtjen dhe të mësuarit është e dukshme gjatë gjithë librit. Këto pyetje kyç mund të shërbejnë si udhëzues kur planifikojmë projektet e mëtejshme të këtij lloji.

| Pyetjet kryesore | Referencat për modulet në këtë libër |
|---|--|
| A i përshtaten metodat dhe temat njohurive, qëndrimeve dhe pritshmërive të nxënësve? | Mësuesi duhet ta vendosë vetë këtë gjë, dhe të vendosë se cilat udhëzime i nevojiten nxënësit. |
| Struktura e nxënësve (për shembull gjinia, përkatësia etnike, nevojat e të mësuarit) përcakton kushtet e mësimit në klasë. A i ka marrë mësuesi në konsideratë këto kushte specifike në zgjedhjen e tij ose të saj të metodave? | Vetëm mësuesi mund t'i përgjigjet kësaj pyetje. Ndoshta kushtet specifike të mësimit në një klasë të veçantë kërkojnë një njësi mësimore që duhet të modifikohet për t'ju përshtatur çështjeve apo nevojave të caktuara. |
| A ngjallin metodat interes dhe dëshirë për të mësuar dhe a e mbajnë atë gjallë? | Qasja e përgjithshme e modulit të të nxënësve e bazuar në detyra siguron përfshirje aktive të nxënësve. |
| A e mbështesin metodat iniciativën personale të nxënësve dhe a i lejojnë atyre të organizojnë proceset e tyre të të mësuarit? | Të gjitha modulet mësimore janë projektuar si projekte. Kjo i jep nxënësit përgjegjësinë për punën e vet, duke përfshirë edhe menaxhimin e kohës. Rreziku i dështimit korrespondon me situata të jetës reale – dhe nëse pasqyrohet me ndjeshmëri, ofron mundësi të rëndësishme të mësimit. |
| A i lejojnë metodat nxënësit për të reflektuar përvojën dhe veprimet e tyre personale? | Të gjitha modulet përfshijnë një fazë të marrjes së udhëzimeve, dhe në disa prej tyre, nxënësve iu kërkohet që të reflektojnë përvojën e tyre të të mësuarit. |
| A i inkurajojnë metodat nxënësit për t'i parë problemet dhe temat nga këndvështrime të ndryshme? | Ora 1 – Unë kam një emër. Fëmijët bëhen të vetëdijshëm se si e perceptojnë njëri-tjetrin, dhe se çdo individ është një person unik. Ora 8 – Poster. E drejta e fëmijëve analizohet nga këndvështrime të ndryshme. |
| A e mbështesin metodat mendimin kritik dhe diskutimin në klasë? | Të gjitha modulet përfshijnë diskutimin dhe të menduarit kritik. |
| A e lejojnë metodat të mësuarit me anë të "mendjes, zemrës dhe dorës"? | Punët e artit, kutia e thesarit, të vepruarit si magjistar. |
| A i lejojnë metodat nxënësit të përjetojnë kompetencat e tyre? | Mësimi në mjedise të ndryshme (punë individuale, të mësuarit bashkëpunues, seancat plenare). Projektet çojë në rezultate të dukshme. Pasqyrimi i të mësuarit i ndihmon nxënësit të bëhen të vetëdijshëm për progresin dhe arritjet e tyre. |
| A i lejojnë metodat llojet e ndryshme të nxënësve të mësojnë në mënyra të ndryshme (të mësuarit konstruktivist)? | Mjedise të të mësuarit individual dhe një gamë e gjerë e aktiviteteve lejojnë lloje të ndryshme të nxënësve të punojnë dhe zhvillohen sipas nevojave të tyre. |
| A i trajnojnë metodat nxënësit të zhvillojnë aftësitë bazë (për shembull, mbledhjen e informacionit, përgatitjen e një prezantimi, planifikimi i një projekti, punën në ekipe)? | Aftësitë themelore mund të mësohen në mënyrë ideale në punën me projekte, duke përfshirë mbledhjen e informacionit, përgatitjen e një prezantimi, planifikimin e një projekti, punën në ekipe. |

8. "Por kjo do të thotë se unë kam të drejtë të bëj një pushim, apo jo?" Të drejtat e fëmijëve në klasë

Mësuesja, Sadina Siercic ka përgatitur me kujdes klasën. Një shembull: Fëmijët janë ulur në grupe. Tavolinat e tyre shërbejnë si tavolina grupi dhe karta të vogla janë vendosur mbi to. Në një tryezë, janë lepujt, në një tjetër arinjte dhe tigrat janë ulur përreth tavolinës së tretë. Plot me entuziazëm, një lepur hap zarfin në tryezën e tij. Mësuesi i kërkon 8-vjeçarit të lexojë rreshtat me zë të lartë.

Lepuri lexon, "Fëmijët kanë të drejtë që të kenë nivelin më të lartë të mundshëm të kujdesit shëndetësor dhe mjekësor" dhe ulet përsëri. "Kemi gjithashtu edhe një numër," thërret mësuesi. "Ne nuk po bëjmë aritmetikë, por numrat janë të rëndësishëm!" I bindur, lepur i çohet përsëri në këmbë dhe lexon, "Neni 24." Mësuesi është i kënaqur. Lepuri mund të vijë në krye të klasës, te dërrasa e zezë. Neni 24 tregohet në një copë letër me ngjyrë në formën e një tullumbaceje. Kjo mund të fiksohet në dërrasë.

Në dërrasë ka hapësirë për shumë tullumbace. Së bashku, ata do të mbajnë një tullumbace me fjalët "të drejtat e fëmijëve". Mësuesi është sa më i lumtur që mundet. "Kjo është një e drejtë që ju e keni," i thotë ai fëmijëve. Dhe vazhdon: "Në të gjithë zarfat keni edhe shumë të drejta të tjera. Secila e drejtë është një tullumbace." Fëmijët e kanë kuptuar. Tani shumë duart janë lart në ajër. Ata të gjithë janë të etur të hapin një zarf, ta lexojnë dhe të dalin përpara, të fiksojnë tullumbacen në dërrasë dhe të marrin lavdërim.

Kjo vazhdon për dyzet e pesë minutat e ardhshme. Tani është radha e arushit. Një arushë e re për të qenë të saktë. Ajo ka tërhequr nenin 30. Ajo lexon, "Fëmijët që i përkasin një minoriteti kanë të drejtë të gëzojnë kulturën e tyre, të praktikojnë fenë dhe të përdorin gjuhën e tyre." Dhe nga tavolina tjetër një tigër shton, "Fëmijët kanë të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, për t'u angazhuar në lojë dhe për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe artistike. Neni 31."

Nxënësit e klasës së tretë janë në humor të mirë, entuziastë dhe aktiv. Kemi shumë lëvizje dhe pëshpëritje, dhe të gjithë duan të dëgjojnë.

A është ky mësim i mirë? A është ky një mësim i mirë për të drejtat e fëmijëve? Si mund t'i mësoni më mirë të drejtat e fëmijëve? Sa lidhet ky mësim me interesat e nxënësve? Si zhvillohen kompetencat e tyre? Ndoshta më duhet të them se unë e kam vëzhguar këtë mësim në Gorazade, në vjeshtën e vitin 1998. Gorazade është një qytet në Bosnjën Lindore, që u veçua nga bota, u izolua dhe pothuajse u harrua gjatë luftës. Ajo pothuajse vuajti të njëjtin fat të pastrimeve etnike në Srebrenicë. Në këtë kuadër, të cilit i shtohet fakti që ky mësim u zhvillua pak vjet më vonë se Marrëveshja e Paqes e Dejtonit, të shohësh tema të tilla si liria e besimit fetar dhe mbrojtja e pakicave të trajtohen në një shkollë në Gorazade, ishte një përvojë emocionuese, por edhe një detyrë jo e thjeshtë për nxënësit dhe mësuesit.

Le të shohim më me hollësi këtë mësim. Pak përpara se të bierë zilja, mësuesi pyeti nxënësit e klasës së tretë çfarë kishin mësuar. Një leurushe ngre dorën dhe thotë, "Tani unë e di se ka një nen 31 që thotë se unë kam të drejtë për pushim dhe dëfrim. Kjo do të thotë se unë kam të drejtë të kem një pushim, apo jo? Mirë, tani unë ndihem e lodhur dhe kam nevojë për pushim" E gjithë klasa fillon të qeshë. Mësuesi qesh me ta dhe pastaj shikon klasën në mënyrë kuptimplotë.

Çfarë ndodhi? Si vazhdoi? Mësuesja e pa veten në vështirësi. Nxënësit jo vetëm kishin mësuar diçka në këtë mësim, por edhe bënë një përpjekje interesante për ta zbatuar atë në një situatë konkrete jetësore. Unë nuk mund të kuptoja mendimet e mësueses, por vetëm mund të përfytyroja situatën e vështirë në të cilën ajo ndodhej. Më futi në mendime: A mund të përdoret konventa, një dokument ligjor, në këtë mënyrë? A është e mundur, duke pasur parasysh paradigmen konstruktivistë, që çdo person duhet të jetë në gjendje të ndërtojë interpretimin e tij për të? Çfarë ndodh në klasë nëse lejohet një gjë e tillë?

Në këtë çast, Sabina Siercic, mësuesja e klasës së tretë nga Bosnja Lindore, nuk kishte kohë për të reflektuar për çështjet komplekse ligjore ose shoqërore. Ajo kishte paraqitur një koncept në klasë dhe e

dinte se tani ishte çasti të merrej një vendim: Ajo tani po vendoste një pikë kthese për klasën e saj. Ajo duhet të vendoste nëse të drejtat e fëmijëve do të mbeteshin një mësim i lumtur me ballon, pa ndikim në të menduarit e përditshëm ose nëse këtu në Bosnjën Lindore, në këtë mësim në një mëngjes pranvere të fundvitit 1990, do të ndodhte diçka që e dëshironin të gjithë: një shqyrtim dhe zbatim real i konventës së të drejtave të fëmijës! Sadina Siercic reagoi në këtë mënyrë: Ajo i hodhi një vështrim klasës dhe u kthye nga vajza dhe tha: Po, ti ke të drejtë. Neni 31 ekziston dhe të garanton ty dhe fëmijëve të tjerë pushim. Kjo do të thotë se unë duhet të mendoj me kujdes për detyrat e shtëpisë që ju jap. Unë duhet të mendoj nëse është e drejtë për nxënësit që mbarojnë detyrat gjatë mësimin të mos bëjnë gjë në shtëpi dhe nëse ata që punojnë më ngadalë dhe ndoshta me më shumë kujdes gjatë mësimin duhet të marrin më shumë punë për të bërë në shtëpi dhe, për këtë arsye, të kenë më pak kohë të lirë për të pushuar dhe marrë veten. Po, unë duhet të mendoj për gjëra të tilla, sepse unë e di nenin 31". Megjithatë, Sadina Siercic kishte ende për të thënë. Ajo vazhdoi "Unë duhet t'u them edhe diçka tjetër. Ju duhet të dini edhe për nenin 28. Ky nen ju garanton të drejtën për arsimim. Për ju dhe shokët tuaj kjo do të thotë se deri në pushim, është koha për arsimim!"

Klasa ra në qetësi. Nxënësit nuk ishin shumë të kënaqur me përgjigjen e mësueses. Çfarë kishte ndodhur? Një vajzë tetë vjeçare kishte bërë një përpjekje për të kuptuar një konventë ndërkombëtare, të ratifikuar nga vendi i saj dhe i pranuar nga ligji i shtetit. Por, për më tepër, ajo u përpoq të lidhte konventën për të drejtat e fëmijës me përvojën e saj jetësore të përditshme, madje edhe ta zbatonte atë. Ajo u përpoq ta interpretonte dhe ta zbatonte në fushën e të drejtave të jetës së saj, pasi shkolla është pikërisht vendi ku një fëmijëmund të kontaktojë shtetin e saj drejtpërdrejt. Ky është vendi ku vendoset si shteti ndesh fëmijën dhe si fëmija ndesh shtetin.

Po mësuesja? Mësuesja duhet të takojë nxënësit e saj në të njëjtin nivel. Ajo na lejon ta quajmë "fuqizim", ndërkohë që përpiket të kundërpërgjigjet në mënyrën e duhur. Sadina Siercic, bashkë me nxënësit e saj filloi të hapë një rrugë të re. Në një mënyrë të kuptueshme për një fëmijë tetë vjeç, ajo tregoi se në konventë ekzistojnë nene që konkurrojnë me njeri-tjetrin. Nene që, megjithëse nuk e mohojnë njeri – tjetrin, duhet të kuptohen si të ndërvarur. Kudo, në këtë klasë, në këtë mëngjes të veçantë, konventa për të drejtat e fëmijës u zbatua si një instrument, jo thjesht për t'u njohur, por për t'u bërë një sistem vlerash i zbatueshëm, që mund të ndihmojë individët të vlerësojnë veprimet e tyre në një kontekst më të gjerë.

Pjesa 3: Dokumente dhe materiale mësimore

Në faqet në vijim përfshihen dokumente të rëndësishme me temën e të drejtave të fëmijëve për t'u përdorur në mësim si dhe udhëzime për përdorimin e tyre. Ato janë: një version i Konventës së të Drejtave të Fëmijës për nxënësit (1), grupime të mundshme të të drejtave të fëmijëve të fëmijëve në katër dimensione (2), Konventa e të Drejtave të Fëmijës e Kombeve të Bashkuara e 20 Nentorit 1989 (3), si dhe kartat e të drejtave të fëmijës, për t'u kopjuar dhe përdorur në mësim (4). Përcaktimet e përdorura në versionin e konventës së të drejtave të fëmijës për nxënësit lidhen me ato të përdorura në kartat e të drejtave të fëmijës. Në internet mund të gjenden materiale të shumta që mund të përdoren në mësim.

1. Versioni i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për nxënësit

Përse është i nevojshëm një version i tillë?

Versioni i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, i hapur nga asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e miratuar dhe e ratifikuar nga pothuajse nga të gjitha shtetet e botës, është një dokument ligjor që është shkruar me një gjuhë shumë teknike dhe të ndërlikuar. Nëse kërkojmë që të fëmijët të kuptojnë të drejtat e tyre, është e nevojshme që ato të shprehen me gjuhë të thjeshtë. Përveç kësaj, neni 42 i konventës shpall se është detyrë e qeverisë që, në mënyra të ndryshme, të informojë të rinjtë për të drejtat e tyre. Pa dyshim, ky version i Konventës së KB për të Drejtat e Njeriut është i ndryshëm nga teksti origjinal dhe u jep fëmijëve mundësinë të njihen në mënyrë aktive me të drejtat e tyre. Në këtë mënyrë, shumë njerëz mund të bëhen të vetëdijshëm për këto të drejta.

Po flasim shumë për të drejtat, por cilat janë përgjegjësitë tona?

Të drejtat dhe përgjegjësitë nuk mund të shqyrtohen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Konventa përshkruan të drejtat që fëmijëve u garantohen nga qeveritë e tyre. Si në të gjitha marrëdhëniet, si ato mes shokësh, në familje, në shkollë, në klube sportive ose ndërmjet vendeve, ne kemi përgjegjësi ndaj njerëzve të tjerë, ashtu si ata kanë ndaj nesh. Dy prej këtyre përgjegjësive janë respekti dhe toleranca. Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijës përshkruan këto përgjegjësi bazë të qeverisë ndaj njerëzve nën moshën 18 vjeç.

Versioni i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për nxënësit

| Neni | E drejta | Përshkrim i shkurtër |
|------|---|--|
| 1 | Përkufizimi i fëmijës | Fëmija është personi nën moshën 18 vjeç |
| 2 | Mos diskriminimi | Asnjë fëmijë nuk duhet të diskriminohet për shkak të ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit, vendit të origjinës, varfërisë ose pasurisë, paaftësisë ose përkatësisë në një pakicë etnike. |
| 3 | Mirëqënia e fëmijës është e rëndësishme | Në të gjitha ligjet dhe vendimet juridike, mirëqënia e fëmijës është parësore. |
| 4 | Zbatimi i të drejtave | Çdo shtet duhet të sigurojë, në maksimumin e mundësive të tij, zbatimin e të drejtave të fëmijës. |
| 5 | Respekti për të drejtat prindërore | Çdo shtet është përgjegjës për të siguruar që detyrimet, të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve të përmbushen në mënyrë të tillë që fëmijët të jenë të lirët ushtrojnë të drejtat e tyre. (Qeveritë duhet të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve, anëtarëve të familjes ose kujdestarëve ligjorë duke |

| | | |
|----|---|---|
| | | informuar dhe këshilluar fëmijët për të drejtat e tyre). |
| 6 | Mbijetesa dhe zhvillimi i fëmijës | Çdo fëmijë ka të drejtë për të jetuar dhe mbijetuar. Shteti duhet të garantojë zhvillimin fëmijës dhe të rinjve. |
| 7 | Emri dhe nënshtetësia | Çdo fëmijë, që nga lindja, ka të drejtën për një emër, për një nënshtetësi dhe për përkujdesje nga prindërit e tij. |
| 8 | Mbrojtja e identitetit | Çdo fëmijë ka të drejtë të mbajë ose të rrimarë emrin e tij, nënshtetësinë dhe marrëdhëniet familjare. |
| 9 | Ndarja e prindërve | Çdo fëmijë ka të drejtën për të jetuar me prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo është për mbrojtjen nga prindërit e tyre. Nëse një fëmijë duhet të ndahet nga njëri ose nga të dy prindërit, ata kanë të drejtën të dëgohen. Nëse një fëmijë duhet të ndahet nga njëri ose nga të dy prindërit, ata kanë të drejtë të dinë vendndodhjen e tyre. |
| 10 | Ribashkimi i familjes | Çdo fëmijë ka të drejtë të lerë çdo shtet dhe të udhëtojë për në vendin e tij, për t'u bashkuar me familjen e tij. |
| 11 | Mbrojtja nga rrëmbimi | Çdo shtet duhet të luftojë kundër rrëmbimit të fëmijës dhe largimit të tij në një vend tjetër dhe moskthimin e fëmijës nga një prind ose nga një person tjetër. |
| 12 | E drejta e opinionit vetjak | Çdo fëmijë ka të drejtë të dëgohet dhe të shprehë mendimin e tij për të gjitha çështjet që lidhen me jetën e tij. Në mënyrë të veçantë, kjo ka vlerë ligjore ose në procedurat administrative. Sa më i rritur të jetë fëmija, aq më shumë duhet të dëgohet mendimi i tij. |
| 13 | Liria e shprehjes | Çdo fëmijë ka të drejtën të shprehë lirisht opinionin e tij dhe të marrë e të përhapë informacion përmes medias. Çdo fëmijë ka edhe përgjegjësinë për të shprehur mendimin e tij, duke respektuar edhe të drejtat e të tjerëve. |
| 14 | Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë | Çdo fëmijë ka të drejtë të ushtrojë lirisht fenë e tij dhe të ushtrojë lirinë e mendimit dhe ndërgjegjes. Shteti duhet të respektojë të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve gjatë zbatimit të këtyre të drejtave. |
| 15 | E drejta për grumbullime publike paqësore | Çdo fëmijë ka të drejtë për t'u bashkuar me fëmijë të tjerë, për të hyrë ose për të krijuar shoqata ose bashkime, për sa kohë në këtë proces nuk shkelin të drejtat e të tjerëve. |
| 16 | Mbrojtja e jetës private | Çdo fëmijë ka të drejtë për të mos pasur ndërhyrje në jetën private, të familjes, të banesës ose të korrespondencës. Përveç kësaj, çdo fëmijë ka të drejtë që askush të mos dëmtojë figurën e tij. |
| 17 | E drejta për t'i siguruar informacionin e duhur | Çdo shtet duhet të sigurojë që çdo fëmijë të ketë mundësi reale për informacione përmes formave të ndryshme të medias dhe që ata të kenë mundësi të fitojnë njohuri që janë të rëndësishme për mirëqënien e tyre. Shteti ka detyrimin të mbrojë fëmijët nga informacionet e dëmshme. |
| 18 | Përgjegjësia e prindërve | Prindërit ose kujdestarët e fëmijëve janë përgjegjës për rritjen e fëmijës. Shteti ka përgjegjësinë t'i mbështesë ata në këtë, për |

| | | |
|----|--------------------------------------|---|
| | | shembull, të mundësojë kujdesin për fëmijët në rastet kur prindërit duhet të punojnë. |
| 19 | Mbrojtja nga abuzimet | Shteti është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimet e prindërve ose të njerëzve të tjerë. Ata kanë të drejtën të kenë një familje birësuese ose kujdes në institucione e duhura që marrin parasysh edhe prejardhjen fetare, kulturore e gjuhësore. |
| 20 | Të rinjtë pa familje | Çdo fëmijë që nuk jeton me familjen e tij, ka të drejtë për mbrojtje dhe mbështetje të veçantë. Ai ka të drejtë për një familje birësuese ose një institucion të përshatshëm që mban parasysh prejardhjen fetare, kulturore ose gjuhësore. |
| 21 | Birësimi | Një fëmijë mund të birësohet, nëse birësimi autorizohet, pranohet dhe aprovohet nga vendi dhe nëse i shërben mirëqenies së fëmijës |
| 22 | Fëmijët refugjatë | Çdo fëmijë, i cili është i detyruar të largohet nga vendi i tij, që është refugjat dhe kërkon azil, ka të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti. |
| 23 | Fëmijët me aftësi të kufizuar | Çdo fëmijë me aftësi të kufizuar ka të drejtën për kujdes dhe arsim të veçantë. Ai duhet të ndihmohet për të qenë i pavarur dhe për të marrë pjesë aktive në komunitetin e tij. |
| 24 | Shërbimet shëndetësore dhe mjekësore | Çdo fëmijë ka të drejtë për kujdesin më të mirë të mundshëm mjekësor. Shteti ka detyrimin të luftojë vdekshmërinë foshnjore, të sigurojë mundësitë mjekësore për të rinjtë, të luftojë ushqimin e pamjaftueshëm dhe sëmundjet, të garantojë kujdes mjekësor për gratë shtatzëna dhe nënat e reja, të garantojë edukimin shëndetësor, të zhvillojë parandalimin në sektorin e shëndetit publik dhe të zhdukë zakonet që janë në dëm të fëmijëve. |
| 25 | Rishikimi i trajtimit ose kujdesit | Çdo fëmijë që ka qenë pranuar në një institucion për mbrojtjen, kujdesin ose trajtimin e tij ka të drejtë të kërkojë kontrollin dhe rishikimin e pranimit. |
| 26 | Sigurimi shoqëror | Çdo fëmijë ka të drejtën për siguri shoqërore, të tillë si sigurimet shoqërore. Shteti garanton pagesat për fëmijën, më varësi të situatës financiare të familjes ose të kujdestarit. |
| 27 | Standardi i jetesës | Çdo fëmijë ka të drejtë për një standard jetese në përputhje me zhvillimin e tij fizik, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Prindërit ose kujdestarët janë përgjegjës kryesorë për të siguruar një gjë të tillë. Shteti ka detyrimin t'i mbështesë ata. |
| 28 | Arsimi | Çdo fëmijë ka të drejtë të për arsimim dhe shkollim. Shteti ka detyrimin të bëjë arsimin bazë falas dhe detyruar dhe arsimin e mesëm të mundur për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Shteti ka detyrimin të sigurojë që fëmijët dhe të rinjtë të trajtohen si duhet në shkollë dhe të drejtat e tyre njerëzore të mos shkelen. |
| 29 | Qëllimet arsimore | Arsimimi shkollor duhet të zhvillojë personalitetin dhe talentin e çdo fëmije, të përgatisë çdo fëmijë për jetën e rritur dhe të nxisë fëmijët për të respektuar të drejtat e njeriut dhe |

| | | |
|----|---|--|
| | | të drejtat e tyre, si dhe kulturën dhe vlerat e të tjerëve. |
| 30 | Fëmijët e pakicave | Çdo fëmijë që i përket një pakice ka të drejtën të mësojë për kulturën, fenë dhe jetën e tij artistike dhe t'i ushtrojë ato. |
| 31 | Pushimi, loja dhe koha e lirë | Çdo fëmijë ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, në të cilën mund të luajë dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike. |
| 32 | Puna e fëmijëve | Çdo fëmijë ka të drejtë për mbrojtje nga çdo formë e shfrytëzimit dhe pune, që mund të dëmtojë arsimimin dhe zhvillimin e tij. Shteti ka detyrimin të përcaktojë një moshë minimale të fëmijës për t'u lejuar të punojë dhe një numër orësh në ditë dhe kushte pune. |
| 33 | Mbrojtja nga drogat narkotike | Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga prodhimi dhe tregtimi i drogave të paligjshme. |
| 34 | Mbrojtja nga shfrytëzimi seksual | Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual dhe nga prostitucioni dhe pornografia. |
| 35 | Mbrojtja nga shitja dhe trafikimi | Shteti duhet të ndërmarrë të gjitha masat në juridiksionin e tij, për të garantuar që fëmijët dhe të rinjtë të mos shiten dhe trafikohen. |
| 36 | Mbrojtja nga të gjitha format e tjera të shfrytëzimit | Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e tjera të shfrytëzimit (p.sh. të lypurit) |
| 37 | Tortura dhe burgimi | Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga tortura, trajtimi ose ndëshkimi mizor, arrestimi i paligjshëm ose nga çdo formë tjetër e shkeljes së lirisë personale. Shteti ka detyrimin të ndalojë dënimin me vdekje dhe burgimin e përjetshëm për të rinjtë. Nëse një fëmijë burgoset, ai ka të drejtën për trajtim njerëzor dhe me respekt. Nëse një fëmijë ose i ri arrestohet, ai duhet të mbahet i izoluar nga të rriturit, t'i mundësohet kontakti me familjarët dhe të ketë të drejtë për mbrojtje ligjore. |
| 38 | Lufta dhe konfliktet e armatosura | Fëmijët dhe të rinjtë nën moshën 15 vjeç kanë të drejtë të mos përfshihen në luftë dhe në konflikte të armatosura. Shteti ka detyrimin të sigurojë mbrojtje të veçantë për fëmijët që janë të prekur nga lufta. |
| 39 | Rehabilitimi dhe integrimi | Çdo fëmijë, që është viktimë e konfliktit të armatosur, torturës, shpërfilljes dhe shfrytëzimit, ka të drejtë për kujdesin e duhur për riaftësimin e shëndetit të tij mendor dhe fizik dhe për integrimin e tij në një komunitet. |
| 40 | Drejtësia për rininë | Çdo fëmijë i akuzuar për një krim ka të drejtën të trajtohet me dinjitet në gjykatë. Ai është i pafajshëm, deri sa fajësia e tij të jetë provuar në gjykatë. Çdo fëmijë ka të drejtën për një gjyq të drejtë, një intepretues (nëse është e nevojshme), për mbrojtjen e jetës private dhe për apelim të vendimit të gjykatës. Shteti ka detyrimin të vendosë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët nuk mbajnë përgjegjësi penale. Shteti ka edhe detyrimin të ofrojë alternativa për ndëshkimin e fëmijëve dhe të rinjve, përveç burgosjes. |

| | | |
|----|--|--|
| 41 | Standardet e larta kombëtare kanë përparësi | Nëse një vend ka ligje që mbrojnë fëmijët dhe të rinjtë më mirë se konventa e të drejtave të fëmijës, atëherë këto ligje kanë përparësi në zbatim. |
| 42 | Informimi i të gjithëve për të drejtat e njeriut | Çdo shtet ka përgjegjësinë të bëjë të drejtat e fëmijëve, në mënyrë të kuptueshme për të rriturit dhe fëmijët. |

2. Grupimi i të drejtave të fëmijëve në katër dimensione

Konventa për të Drejtat e Fëmijës mund të ndahet në katër grupime të të drejtave. Këto kategori mund të përdoren në veprimtaritë mësimore, duke u lejuar nxënësve përpjekjet për t'i grupuar të drejtat në katër kategori. Kjo mund të bëhet individualisht ose në grupe,

I. Të luajmë një rol – do të thotë të jesh i aftë të marrësh pjesë në proceset e vendimmarrjes, liria për të formuar grupe, liria e mendimit dhe liria për të fituar informacion nga burime të ndryshme.

II. Të arrijmë potencialin tonë – do të thotë se duhet të përmbushen kushte të veçanta, në mënyrë që të arrihet zhvillimi i duhur personal. Në këtë grup bëjnë pjesë të drejtat që lidhen me arsimimin, familjen, kulturën dhe identitetin personal si pjesë të rëndësishme të jetës sonë.

III. Të jetojmë mirë – E drejta për mbijetesë përfshin nevojat tona bazë. Këto përfshinë ushqimin dhe mbrojtje, standardin e jetesës dhe shëndetin.

IV. Të qenit i lirë nga dëmtimet – do të thotë që të rinjtë kanë të drejtën e mbrojtjes nga abuzimi, shpërfillja, shfrytëzimi ekonomik, tortura, trafiku dhe prostitucioni.

Në listën e mëposhtme, të drejtat renditen në këto katër kategori:

| Grupi | Neni | Titulli i shkurtuar |
|--|--|--|
| I. Të luajmë rolin tonë: E drejta për pjesëmarrje | Neni 3 | Përparësia e nevojave të fëmijës në vendimet politike, juridike dhe legjislacion |
| | Neni 12 | Liria e mendimit dhe e drejta për t'u dëgjuar për të gjitha çështjet vetjake |
| | Neni 13 | Liria e shprehjes |
| | Neni 14 | Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar |
| II. Të zhvillojmë potencialin tonë: e drejta për t'u zhvilluar | Neni 5 | Respektimi i të drejtave të prindërve |
| | Neni 7 | Emri dhe nënshtetësia |
| | Neni 8 | Mbrojtja e identitetit të fëmijës |
| | Neni 10 | Ribashkimi familjar |
| | Neni 21 | Birësimi |
| III. Të jetojmë mirë: e drejta jonë për mbijetesë | Neni 6 | Mbrojtja e mbijetesës dhe zhvillimit |
| | Neni 9 | Parimi i mosndarjes nga prindërit |
| | Neni 18 | Parimi i mosndarjes nga prindërit |
| | Neni 24 | Përgjegjësia e prindërve dhe kujdestarëve |
| | Neni 26 | Përgjegjësia e prindërve dhe kujdestarëve |
| | Neni 27 | Mbrojtja e shëndetit dhe e të drejtës për kujdes shëndetësor |
| Neni 31 | Mbrojtja e shëndetit dhe e të drejtës për kujdes shëndetësor | |

| | | |
|---|----------------------------------|--------------------------------------|
| IV. Liria nga lëndimi: e drejta jonë për mbrojtje | Neni 2 | Mos diskriminimi |
| | Neni 11 | Mbrojtja nga rrëmbimi |
| | Neni 19 | Mbrojtja nga abuzimi |
| | Neni 20 | Të rinjtë pa familje |
| | Neni 22 | Fëmijët refugjatë |
| | Neni 25 | Rishikimi i trajtimit ose i kujdesit |
| | Neni 32 | Puna e fëmijëve |
| | Neni 33 | Mbrojtja nga drogat narkotike |
| Neni 34 | Mbrojtja nga shfrytëzimi seksual | |

Në tabelën e mësipërme, mungojnë katër të drejta. Ato nuk mund të renditen në një nga kategoritë, sepse ato përqendrohen kryesisht në përgjegjësitë e shtetit. Ato janë:

| | |
|---------|---|
| Neni 1 | Përkufizimi i fëmijës |
| Neni 4 | Zbatimi i të drejtave |
| Neni 41 | Standardet kombëtare më të larta kanë përparësi |
| Neni 42 | Detyrimi për të bërë të njohura të drejtat |

3. Konventa për të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989.

Ka hyrë në fuqi në 2 shtator 1990, në përputhje me nenin 49

Preambula

Shtetet Palë në këtë Konventë,

Duke pasur parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është baza e lirisë, drejtësisë dhe e paqes në botë,

Duke mbajtur parasysh faktin se popujt e Kombeve të Bashkuara kanë ripohuar në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut dhe në dinjitetin dhe vlerën e njeriut dhe kanë vendosur të nxisin përparimin shoqëror e të krijojnë kushte më të mira jetese, në një liri më të madhe,

Duke pranuar se Kombet e Bashkuara, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në Paktet ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut, kanë shpallur dhe kanë pranuar që çdonjëri mund të përfitojë nga të gjitha të drejtat dhe të gjitha liritë e parashtruara në to, pa asnjë dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, opinionin politik ose çdo lloj opinionin tjetër, origjine kombëtare ose shoqërore, pasurie, prejardhjeje ose çdo lloj gjendjeje tjetër,

Duke kujtuar se në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkuqdesje dhe përkrahje të veçantë,

Të bindur se familja, si njësi bazë e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj dhe veçanërisht të fëmijëve, duhet të ketë mbrojtjen dhe përkrahjen e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi,

Duke pranuar se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi,

Duke pasur parasysh se fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri dhe të edukohet në frymën e idealeve të shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe sidomos në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit,

Duke mbajtur parasysh se domosdoshmëria për t'i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës është pohuar në Deklaratën e Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1924 dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijës,

Duke mbajtur parasysh se, ashtu siç është thënë në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës "fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes",

Duke kujtuar dispozitat e Deklaratës mbi Parimet Shoqërore dhe Juridike lidhur me Mbrojtjen dhe Mirëqenien e Fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vendosjen e fëmijës në një familje ushqyese dhe birësimin e fëmijës brenda dhe jashtë vendit; me rregullat minimale standard të Kombeve të Bashkuara mbi administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit) dhe të Deklaratës mbi Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Periudha të Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe Konflikti të Armatosur,

Duke pranuar se në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se është e nevojshme që këtyre fëmijëve t'u kushtohet një vëmendje e veçantë,

Duke mbajtur parasysh si duhet rëndësinë e traditave dhe të vlerave kulturore të çdo populli në mbrojtjen dhe zhvillimin e harmonishëm të fëmijës,
Duke pranuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve në të gjitha vendet, dhe veçanërisht në vendet në zhvillim,
U morën vesh për sa vijon:

PJESA I

Neni 1

Në këtë Konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

Neni 2

1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Neni 3

1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

2. Shtetet Palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

Neni 4

Shtetet Palë angazhohen të marrin të gjitha masat legjislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë dhe, kur është nevoja, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 5

Shtetet Palë respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose, sipas rastit, anëtarët e familjes së zgjeruar ose të bashkësisë, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët ose persona të tjerë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, për t'i dhënë këtij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave që i njeh atij kjo Konventë.

Neni 6

1. Shtetet Palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.

2. Shtete Palë, marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

Neni 7

1. Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.

2. Shtetet Palë sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetej pa shtetësi.

Neni 8

1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.

2. Në qoftë se një fëmije i mohohen në mënyrë të paligjshme disa ose të gjithë elementet e identitetit të tij, Shtetet Palë i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

Neni 9

1. Shtetet Palë garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveç rastit kur autoritetet kompetente, në bazë të rishikimit gjyqësor, vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse kjo ndarje është e domosdoshme, në interesin më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si ai kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija.

2. Në të gjitha rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutim dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.

3. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

4. Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga një Shtet Palë, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga shteti) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, ky Shtet Palë, sipas kërkesës, u jep prindërve, fëmijës ose, kur është rasti, një anëtar tjetër të familjes, të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhen anëtarit ose anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu, që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.

Neni 10

1. Në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë sipas paragrafit 1 të nenit 9, kërkesat e bëra nga një fëmijë ose nga prindërit e tij, me qëllim që të hyjnë në një Shtet Palë ose të largohen prej tij, për arsye ribashkimi të familjes, trajtohen nga Shtetet Palë në një frymë pozitive, me humanizëm dhe me shpejtësi. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë pasoja të dëmshme për autorët e kërkesës dhe anëtarët e familjes së tyre.

2. Një fëmijë, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe takime të rregullta të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim dhe në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë, sipas paragrafit 1 të nenit 9, Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës dhe të prindërve të tij për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehen në vendin e tyre. E drejta për t'u larguar nga çdo vend bëhet objekt kufizimesh vetëm në rastet e përcaktuara me ligj, të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe që janë në pajtim me të drejtat e njohura në këtë Konventë.

Neni 11

1. Shtetet Palë marrin masa për të luftuar zhvendosjet dhe mosriktimet e paligjshme të fëmijëve në vend të huaj.
2. Për këtë qëllim, Shtetet Palë nxisin përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ose aderimin në marrëveshjet ekzistuese.

Neni 12

1. Shtetet Palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.
2. Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar

Neni 13

1. Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kujfijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur nga fëmija.
2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve, por vetëm kur përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme për:

- (a) Respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve; ose
- (b) Mbrojtjen e sigurimit kombëtar, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni 14

1. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë.
2. Shtetet Palë respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe, sipas rastit, të përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, për ta drejtuar atë në ushtrimin e të drejtës së tij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij.
3. Liria për të manifestuar fenë ose bindjet e tij mund t'u nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik, ose liritë dhe të drejtat themelore të të tjerëve.

Neni 15

1. Shtetet Palë njohin të drejtat e fëmijës për lirinë e organizimit dhe lirinë e grumbullimit paqësor.
2. Asnjë kufizim nuk mund të ketë në ushtrimin e këtyre të drejtave, përveç atyre të përcaktuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar, të sigurisë publike ose të rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Neni 16

1. Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cënimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij.
2. Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose cënimeve të tilla.

Neni 17

Shtetet Palë njohin funksionin e rëndësishëm që përmbushin mjetet e komunikimit masiv dhe garantojnë që fëmija të marrë informacione dhe materiale që vijnë nga burime të ndryshme kombëtare dhe

ndërkombëtare, sidomos ato që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor. Për këtë qëllim Shtetet Palë:

- (a) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv për të përhapur një informacion dhe materiale me dobi shoqërore dhe kulturore për fëmijën dhe në përputhje me frymën e nenit 29;
- (b) Inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në prodhimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e të tilla informacioneve dhe materialeve nga burime të ndryshme kulturore, kombëtare e ndërkombëtare;
- (c) Inkurajojnë prodhimin dhe përhapjen e librave për fëmijë;
- (d) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv, mbajnë parasysh, në mënyrë të veçantë nevojat gjuhësore, të fëmijës që i përket një grupi etnik ose është autokton;
- (e) Nxisin përpunimin e orientimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës nga informacioni dhe materialet që dëmtojnë mirëqenien e tij, duke pasur parasysh dispozitat e neneve 13 dhe 18.

Neni 18

1. Shtetet Palë përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në radhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës.
2. Për të garantuar dhe zhvilluar të drejtat e përmendura në këtë Konventë, Shtetet Palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët.
3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar fëmijëve, prindërit e të cilëve janë në marrëdhënie pune, të drejtën të përfitojnë nga shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijët, për të cilat janë ngritur.

Neni 19

1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.
2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

Neni 20

1. Një fëmijë, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti.
2. Shtetet Palë sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.
3. Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, inter alia, formën e vendosjes në një familje, të "Kafalasë" sipas të drejtës islamike, të birësimit ose, në rast nevojë, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Në gjetjen e këtyre zgjidhjeve, duhet të mbahen mirë parasysh dëshira për vazhdimësinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

Neni 21

Shtetet Palë, të cilët pranojnë dhe/ose lejojnë sistemin e birësimit, garantojnë që konsiderata mbizotëruese të jetë interesi më i lartë i fëmijës dhe:

(a) Sigurojnë që birësimi i fëmijës të autorizohet vetëm nga autoritetet kompetente, të cilët përcaktojnë, në përputhje me ligjin dhe procedurat e zbatueshme dhe mbi bazën e të gjitha të dhënave përkatëse dhe të besueshme, që birësimi të lejohet duke mbajtur parasysh gjendjen e fëmijës në raport me prindërit, të afërmit dhe përfaqësuesit e tij ligjorë dhe, kur është e nevojshme, personat e interesuar të kenë dhënë pëlqimin e tyre të ndërgjegjshëm për birësimin, mbi bazën e këshillimit të nevojshëm;

(b) Pranojnë se birësimi në një vend tjetër mund të shihet si një alternativë për të siguruar kujdesin për fëmijën, në qoftë se fëmija nuk mund të vendoset në një familje ushqyese ose birësuese, ose të ketë një mënyrë tjetër të përshtatshme për kujdesjeje në vendin e tij të origjinës;

(c) Sigurojnë që, në rast birësimi në një vend tjetër, fëmija të gëzojë mbrojtjen dhe normat e barazvlershme me ato që ekzistojnë në rastin e birësimit në vendin e tij;

(d) Marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që, në rast birësimi në një vend tjetër, vendosja e fëmijës të mos kthehet në një përfitim material të pavend për personat e implikuar në të;

(e) Mbështesin, sipas rastit, objektivat e këtij neni, duke përfunduar rregullime ose marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe dhe përpunon në këtë kuadër të sigurojnë që vendosja e fëmijës në një vend tjetër të bëhet nga autoritetet ose organet kompetente.

Neni 22

1. Shtetet Palë marrin masat e duhura për të siguruar që një fëmijë, i cili kërkon të marrë statusin e refugjatit ose që konsiderohet si i tillë sipas rregullave dhe procedurave të së drejtës ndërkombëtare ose të brendshme të zbatueshme, qoftë vetëm apo i shoqëruar nga prindërit e tij ose nga çdo person tjetër, të përfitojë nga mbrojtja dhe përkrahja humanitare e duhur, për t'i lejuar atij të gëzojë të drejtat që i njohin kjo Konventë dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose me karakter humanitar, në të cilat Shtetet janë Palë.

2. Për këtë qëllim, Shtetet Palë bashkëpunojnë, kur e gjykojnë të nevojshme, në çdo përpjekje të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të tjera ndërqeveritare ose joqeveritare kompetente, që bashkëpunojnë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për të mbrojtur dhe ndihmuar fëmijën dhe për të kërkuar prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes të çdo fëmije refugjat, me qëllim që të sigurojnë informacionin e nevojshëm për bashkimin me familjen. Në rastet kur as prindërit, as anëtarët e tjerë të familjes nuk gjenden, fëmijës do t'i jepet e njëjta mbrojtje, si çdo fëmije tjetër që i mungon ngaherë ose përkohësisht mjedisi familjar, cilado qoftë arsyeja, sikundër parashikohet në këtë Konventë.

Neni 23

1. Shtetet Palë pranojnë se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.

2. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë, brenda mundësive të të ardhurave të disponueshme, dhënien e fëmijës, i cili përmbush kushtet, si dhe atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të.

3. Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me paaftësi, ndihma e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe kjo synon që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi efektive të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integritet shoqëror dhe zhvillim vetiak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror.

4. Shtetet Palë, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën e kujdesit shëndetësor parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundësinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimit, edukimit dhe shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet Palë të kenë mundësi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojën e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 24

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

2. Shtetet Palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:

(a) Për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmimore.

(b) Për t'u siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor.

(c) Për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror.

(d) Për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes.

(e) Për të mundësuar që gjithë grupet shoqërore dhe në veçanti prindërit dhe fëmijët të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi dhe të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe shëndoshjen e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve.

(f) Për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.

3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e efektshme dhe të nevojshme për të zhdukur praktikat tradicionale të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.

4. Shtetet Palë marrin përsipër të nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim që të sigurojnë gradualisht realizimin e plotë të së drejtës së njohur në këtë nen. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 25

Shtetet Palë i njohin fëmijës, për të cilin është vendosur nga autoritetet kompetente për të qenë nën kujdesje, mbrojtje ose trajtim fizik ose mendor, të drejtën e një ekzaminimi periodik të këtij trajtimi dhe të çdo rrethane tjetër lidhur me këtë vendosje.

Neni 26

1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmije të drejtën për të përfituar përkrahje shoqërore, përfshirë sigurime shoqërore dhe marrin masat e nevojshme për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

2. Ndihamat, ku është e nevojshme, duhet të jepen duke pasur parasysh të ardhurat dhe kushtet e fëmijës dhe personave përgjegjës për mbajtjen e tij si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Neni 27

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e çdo fëmije për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.
2. Përgjegjësinë për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës, brenda kufijve të mundësive dhe mjeteve të tyre financiare, e kanë në radhë të parë prindi ose prindërit ose personat e tjerë përgjegjës për rritjen e fëmijës.
3. Shtetet Palë marrin masat e duhura, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindërit dhe personat e tjerë përgjegjës për fëmijën, që të vënë në jetë këtë të drejtë dhe, në rast nevojë, për të siguruar një përkrahje materiale dhe programe mbështetjeje, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe banimin.
4. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar marrjen e pensionit ushqimor të fëmijës nga prindërit e tij ose nga personat e tjerë që kanë përgjegjësi financiare ndaj tij, qoftë brenda ose jashtë vendit. Në veçanti, në rastet kur personi që ka një përgjegjësi financiare ndaj fëmijës jeton në një shtet tjetër nga ai i fëmijës, Shtetet Palë favorizojnë aderimin në marrëveshjet ndërkombëtare ose përfundimin e marrëveshjeve të tilla si dhe miratimin e rregullimeve të tjera të duhura.

Neni 28

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:
 - (a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë.
 - (b) Inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë.
 - (c) U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme.
 - (d) Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional.
 - (e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.
2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.
3. Shtetet Palë nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 29

1. Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:
 - (a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës.
 - (b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.
 - (c) Të rrisë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti.

(d) Ta përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymë e mirëkuptimit, paqes, tolerimit, barazisë midis sekseve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone;

(e) T'i zhvillojë fëmijës respektin për mjedisin natyror.

2. Asnjë dispozitë e këtij neni ose e nenit 28 nuk do të interpretohet në mënyrë të atillë që të cënojë lirinë e personave fizikë ose juridikë, për të krijuar e drejtuar qendra arsimore, gjithmonë me kusht që parimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni të respektohen dhe që arsimi që jepet në këto qendra të jetë në përputhje me normat minimale që përcaktohen nga Shteti.

Neni 30

Në Shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmije që i përket një minoriteti ose është autokton, nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën e vet, të ushtrisë dhe praktikojë fenë e vet, ose të përdorë gjuhën e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.

Neni 31

1. Shtetet Palë i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.

2. Shtetet Palë respektojnë dhe nxisin të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike, inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kohën e lirë dhe për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.

Neni 32

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

2. Shtetet Palë marrin masa legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të siguruar zbatimin e këtij neni. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, Shtetet Palë në mënyrë të veçantë:

(a) Përcaktojnë një moshë minimale ose moshat minimale të pranimit në punë.

(b) Parashikojnë një rregullim të përshtatshëm të orarit të punës dhe të kushteve të punës.

(c) Japin dënime ose sanksione të tjera të përshtatshme për të siguruar zbatimin efektiv të këtij neni.

Neni 33

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohen në konventat përkatëse ndërkombëtare dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të këtyre lëndëve.

Neni 34

Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që:

(a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale.

(b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme.

(c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Neni 35

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Neni 36

Shtetet Palë mbrojnë fëmijën nga çdo formë tjetër shfrytëzimi, që dëmton në çfarëdo aspekti mirëqënien e tij.

Neni 37

Shtetet Palë sigurojnë që:

(a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burigimi i përjetshëm nuk duhet të jepet për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç.

(b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.

(c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që të kihet parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në intresin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme.

(d) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Neni 38

1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë dhe të bëjnë të respektohen rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare, që janë të zbatueshme për ta në rast konflikti të armatosur dhe që kanë të bëjë me fëmijën.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që personat, të cilët nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në veprimet luftarake.

3. Shtetet Palë nuk rekrutojnë në forcat e tyre të armatosura asnjë person që nuk ka mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Kur ata rekrutojnë persona më të rritur se 15 vjeç por më të vegjël se 18 vjeç, Shtetet Palë përpunon të rekrutojnë më përpara më të mëdhenjtë në moshë.

4. Në përputhje me detyrimin që u takon në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, për të mbrojtur popullsinë civile në rast konflikti të armatosur, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, për të siguruar mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët e prekur nga konflikti i armatosur.

Neni 39

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

Neni 40

1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmijë të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.

2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Shtetet Palë kujdesen në veçanti që:

(a) Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer;

(b) Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijojnë:

(i) Të prezumohet i pafajtshëm derisa të provohet pafajësia ligjërisht.

(ii) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose nga çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij.

(iii) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

(iv) Të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të pyeten ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta.

(v) Në qoftë se vendoset se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankim kundër këtij vendimi si dhe çdo masë të marrë si pasojë, para një autoriteti ose një instance gjyqësore kompetente më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me ligjin.

(vi) Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret.

(vii) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës.

3. Shtetet Palë përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti:

(a) Përcaktojnë një moshe minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal.

(b) Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore.

4. Parashikohen dispozita të ndryshme, siç janë kujdesi, orientimi dhe kontrolli; këshillat; periudha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit të përgjithshëm dhe profesional dhe zgjidhje të tjera, veç atyre institucionale, për t'u siguruar fëmijëve një trajtim në përputhje me mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit.

Neni 41

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk cënon dispozitat më të favorshme për realizimin e të drejtave të fëmijës, që mund të parashikohen:

(a) në legjislacionin e një Shteti Palë; ose

(b) në të drejtën ndërkombëtare në fuqi për atë Shtet.

PJESA II

Neni 42

Shtetet Palë marrin përsipër t'ua bëjnë gjerësisht të njohura parimet dhe dispozitat e kësaj Konvente, si të **rriturve ashtu edhe fëmijëve, me anë të mjeteve energjike të përshtatshme.**

Neni 43

1. Me qëllim që të shqyrtohen përparimet e arritura nga Shtetet Palë në përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër prej tyre në bazë të kësaj Konvente, krijohet një Komitet për të Drejtat e Fëmijës, i cili kryen funksionet e caktuara si më poshtë.

2. Komiteti përbëhet nga dhjetë ekspertë me moral të lartë dhe që njihen si kompetentë në fushën që trajton kjo Konventë. Anëtarët e tij zgjidhen nga Shtetet Palë midis shtetasve të tyre dhe marrin pjesë me titull personal, duke pasur parasysh një shpërndarje gjeografike të drejtë dhe sistemet juridike kryesore.

3. Anëtarët e Komitetit zgjidhen me votë të fshehtë, nga një listë personash të caktuar nga Shtetet Palë. Çdo Shtet Palë mund të caktojë një kandidat nga shtetasit e tij.

4. Zgjedhja e parë bëhet jo më vonë se gjashtë muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Më pas zgjedhjet bëhen çdo dy vjet. Të paktën katër muaj para datës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara fton me shkrim Shtetet Palë të propozojnë kandidatët e tyre brenda një afati dymujor. Sekretari i Përgjithshëm bën më pas listën alfabetike të kandidateve të caktuar, duke cilësuar Shtetet Palë që i kanë caktuar dhe ua paraqit ata Shteteve Palë në këtë Konventë.

5. Zgjedhjet bëhen gjatë mbledhjeve të Shteteve Palë, të organizuara nga Sekretari i Përgjithshëm në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, në të cilat duhet të jenë të pranishëm jo më pak se dy të tretat e Shteteve Palë, kandidatët të zgjedhur në Komitet janë ata që fitojnë numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të Shteteve Palë të pranishëm dhe votues.

6. Anëtarët e Komitetit zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Ata mund të rizgjidhen në qoftë se kandidatura e tyre paraqitet përsëri. Mandati i pesë prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë mbaron pas dy vjetësh. Emrat e këtyre pesë anëtarëve hidhen në short nga Kryetari i mbledhjes, menjëherë pas zgjedhjes së parë.

7. Në rast se një anëtar i Komitetit vdes ose jep dorëheqjen ose deklaron se për çdo

arsye tjetër nuk mund t'i kryejë më funksionet e tij në Komitet, Shteti Palë, që kishte paraqitur kandidaturën e tij, emëron një tjetër ekspert nga shtetasit e vet, për të plotësuar vendin e lirë deri në përfundimin e mandatit korrespondues, gjë që i

nënshtrohet miratimit të Komitetit.

8. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

9. Komiteti zgjedh byronë e tij për një periudhë prej dy vjetësh.

10. Mbledhjet e Komitetit zakonisht mbahen në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose në çdo vend tjetër të përshtatshëm, të caktuar nga Komiteti. Komiteti mbledhet zakonisht çdo vit. Zgjatja e sesioneve të tij përcaktohet dhe ndryshohet, në rast se është e nevojshme, nga një mbledhje e Shteteve Palë në këtë Konventë, me rezervën e miratimit nga Asambleja e Përgjithshme.

11. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara vë në dispozicion të Komitetit personelin dhe pajisjet e nevojshme, për të kryer me efektshmëri funksionet që i janë besuar në bazë të Konventës.

12. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, anëtarët e Komitetit të krijuar në bazë të kësaj Konvente paguhen nga të ardhurat e OKB-së, sipas kushteve dhe modaliteteve të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 44

1. Shtetet Palë marrin përsipër të paraqitin në Komitet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, raporte mbi masat e marra për të përmbushur të drejtat e njohura në këtë Konventë dhe mbi përparimet e realizuara në gëzimin e këtyre të drejtave:

(a) Brenda dy vjetëve, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për Shtetet Palë.

(b) Në vazhdim në çdo pesë vjet.

2. Raportet e paraqitura në zbatim të këtij neni tregojnë faktorët dhe vështirësitë, në rast se ka, që kanë ndikuar në shkallën e përmbushjes nga Shtetet Palë të detyrimeve të parashikuara në këtë Konventë. Raportet duhet të përmbajnë gjithashtu të dhëna të mjaftueshme për t'i dhënë Komitetit një ide të plotë për zbatimin e Konventës në vendin përkatës.

3. Shtetet Palë, që kanë paraqitur në Komitet raportin e parë të plotë, nuk përsërisin në raportet që i paraqesin atij në vazhdim, sipas pikës (b) të paragrafit të parë të këtij neni, sqarimet kryesore, të komunikuar qysh më parë.

4. Komiteti mund t'u kërkojë Shteteve Palë të dhëna plotësuese, që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës.

5. Komiteti i paraqit çdo dy vjet Asamblesë së Përgjithshme, nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror, një raport mbi veprimtarinë e tij.

6. Shtetet Palë sigurojnë një shpërndarje të gjerë të raporteve të tyre në vendet e tyre.

Neni 45

Për të arritur zbatimin efektiv të Konventës dhe për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën që mbulon kjo Konventë:

- (a) Agjencitë e specializuara, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara, kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë shqyrtimit të zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente, që kanë të bëjnë me mandatin e tyre. Komiteti mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe të gjitha organet e tjera kompetente, që ai do ta gjykojë të arsyeshme, për të dhënë mendime të specializuara mbi zbatimin e Konventës në fusha që kanë të bëjnë me mandatin e tyre përkatës. Ai mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara për t'i paraqitur raporte mbi zbatimin e Konventës në sektorët që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së tyre;
- (b) Komiteti u transmeton agjencive të specializuara, Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organeve të tjera kompetente, në rast se e sheh të nevojshme, çdo raport të Shteteve Palë, që përmban një kërkesë ose që tregon një nevojë për këshilla ose ndihmë teknike, së bashku me vërejtjet dhe sugjerimet e Komitetit, në rast se ka të tilla.
- (c) Komiteti mund t'i rekomandojë Asamblesë së Përgjithshme, që t'i kërkojë Sekretarit të përgjithshëm, të ndërmarrë në emër të tij studime për çështje të veçanta, që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës.
- (d) Komiteti mund të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme, të bazuara në të dhënat e marra në zbatim të neneve 44 dhe 45 të kësaj Konvente. Këto sugjerime dhe rekomandime të

natyrës së përgjithshme i transmetohen çdo Shteti Palë të interesuar dhe i përcillen për dijeni Asamblesë së Përgjithshme, të shoqëruara, në rast se ka të tilla, me vërejtjet e Shteteve Palë.

PJESA III

Neni 46

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjithë Shtetet.

Neni 47

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 48

Konventa do të qëndrojë e hapur për aderim nga çdo Shtet. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 49

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit.
2. Për secilin Shtet që ratifikon këtë Konventë ose aderon në të, pas depozitimit të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit, Konventa hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ky Shtet, të instrumentit të tij të ratifikimit ose të aderimit.

Neni 50

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë një amendament dhe të depozitojë tekstin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ua komunikon pastaj amendamentin e propozuar Shteteve Palë, duke kërkuar që t'i bëjnë të ditur nëse janë për thirrjen e një konference të Shteteve Palë për shqyrtimin e propozimit dhe të hedhjes në votë. Nëse brenda katër muajve pas datës së këtij komunikimi, të paktën një e treta e Shteteve Palë shprehen për thirrjen e një konference të tillë, Sekretari i Përgjithshëm thërret konferencën nën kujdesin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica e Shteteve Palë të pranishëm dhe votues në konferencë i paraqitet për miratim Asamblesë së Përgjithshme.
2. Një amendament i miratuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni hyn në fuqi pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe të jetë pranuar nga dy të tretat e Shteteve Palë.
3. Kur një amendament hyn në fuqi, ai bëhet i detyrueshëm për të gjithë Shtetet Palë, që e kanë pranuar dhe Shtetet e tjerë që mbeten të lidhur me dispozitat e kësaj Konvente dhe me të gjithë amendamentet e mëparshme të pranuar prej tyre.

Neni 51

1. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara merr dhe ua dërgon të gjithë Shteteve tekstin e rezervave të bëra nga Shtetet në çastin e ratifikimit ose të aderimit.
2. Nuk lejohet asnjë rezervë e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.
3. Rezervat mund të tërhiqen në çdo kohë, nëpërmjet njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili informon për këtë të gjithë Shtetet Palë në

Konventë. Njoftimi hyn në fuqi në datën kur ky është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 52

Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës kur njoftimi është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 53

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara caktohet si depozitues i kësaj Konvente.





Neni 54





Origjinali i kësaj Konvente, bërë në gjuhët angleze, arabe, kineze, spanjolle, franceze dhe ruse, me vlerë të barabartë, depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Për vërtetim, të nënshkruarit, të plotfuqishëm e të ngarkuar ligjërish nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë Konventë.





4. Të drejtat e fëmijëve të ilustruara (Kartat e të drejtave të fëmijëve)





Në fillim, të drejtat e fëmijës u trajtuan si një instrument juridik. Megjithatë, në kontekstin e shkollës, është e qartë që çdo nen duhet të kuptohet dhe të interpretohet nga pikëpamja e grupit të synuar. Kartat e të drejtave të fëmijës ndihmojnë në arritjen e qëllimit, që është zhvillimi i kuptimit dhe i zbatimit të këtyre të drejtave. Këto karta mund të përdoren në mënyra të ndryshme:

- Ilustrimet dhe tekstet mund të priten së bashku, të palosen dhe të ngjiten për të prodhuar karta me dy anë të plotësuara. Nxënësit mund t'i përdorin ato për të testuar veten ose njeri-tjetrin.
- Ilustrimet dhe tekstet mund të priten për të krijuar karta kujtese. Në këtë mënyrë, nxënësit mund të mësojnë të drejtat e fëmijëve përmes lojës.
- Ilustrimet dhe tekstet mund të priten dhe të renditen sipas kritereve të ndryshme:
 - Ato mund të grupohen në katër kategori (pjesëmarrja: e drejta për të marrë pjesë, përmbushja e potencialit tonë: e drejta për zhvillim personal; mirëqenia: e drejta për mbijetesë; mbrojtja nga lëndimet: e drejta për mbrojtje).
 - Ato mund të grupohen në kategoritë e vlerave personale: Çfarë është e rëndësishme në jetë? Cilat çështje janë të rëndësishme për vendin tim, komunitetin tim dhe shkollën time?
 - Ilustrimet dhe pjesët e tjera të prera nga revistat dhe artikujt e gazetave mund të mblidhen për të ilustruar tema të ngjashme.
 - Nxënësit mund të frymëzohen nga këto ilustrime dhe të ilustrojnë vetë të drejtat e fëmijëve.
- Ilustrimet mund të zgjerohen dhe të ngjyrosen nga nxënësit (dhe, më pas, mund të vihen në kornizë). Ato mund të përdoren për të zbukuruar klasën dhe korridoret e shkollës.
- Ilustrimet mund të plotësohen me përshkrime të shkurtëra të përvojave personale dhe, më pas, të kthehen në broshura.

| | |
|--|--|
| <p>Neni 1</p>  | <p>Përkufizimi i fëmijës</p> <p>Fëmija është personi nën moshën 18 vjeç.</p> |
| <p>Neni 2</p>  | <p>Mosdiskriminimi</p> <p>Asnjë fëmijë nuk duhet të diskriminohet për shkak të ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit, vendit të origjinës, varfërisë ose pasurisë, paaftësisë ose përkatësisë në një pakicë etnike.</p> |
| <p>Neni 3</p>  | <p>Mirëqënia e fëmijës është e rëndësishme</p> <p>Në të gjitha ligjet dhe vendimet juridike, mirëqënia e fëmijës është parësore.</p> |
| <p>Neni 4</p>  | <p>Zbatimi i të drejtave</p> <p>Çdo shtet duhet të sigurojë, në maksimumin e mundësive të tij, zbatimin e të drejtave të fëmijës.</p> |

| | |
|--|--|
| <p>Neni 5</p>  | <p>Respekti për të drejtat prindërore</p> <p>Çdo shtet është përgjegjës për të siguruar që detyrimet, të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve të përmbushen në mënyrë të tillë që fëmijët të jenë të lirëtë ushtrojnë të drejtat e tyre. (Qeveritë duhet të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve, anëtarëve të familjes ose kujdestarëve ligjorë duke informuar dhe këshilluar fëmijët për të drejtat e tyre).</p> |
| <p>Neni 6</p>  | <p>Mbijetesa dhe zhvillimi i fëmijës</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë për të jetuar dhe mbijetuar. Shteti duhet të garantojë zhvillimin fëmijës dhe të rinjve.</p> |
| <p>Neni 7</p>  | <p>Emri dhe nënshtetësia</p> <p>Çdo fëmijë, që nga lindja, ka të drejtën për një emër, për një nënshtetësi dhe për përkujdesje nga prindërit e tij.</p> |
| <p>Neni 8</p>  | <p>Mbrojtja e identitetit</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të mbajë ose të rrimarë emrin e tij, nënshtetësinë dhe marrëdhëniet familjare.</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Neni 9</p>  | <p>Ndarja e prindërve</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtën për të jetuar me prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo është për mbrojtjen nga prindërit e tyre. Nëse një fëmijë duhet të ndahet nga njëri ose nga të dy prindërit, ata kanë të drejtën të dëgjoen. Nëse një fëmijë duhet të ndahet nga njëri ose nga të dy prindërit, ata kanë të drejtë të dinë vendndodhjen e tyre.</p> |
| <p>Neni 10</p>  | <p>Ribashkimi i familjes</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të lerë çdo shtet dhe të udhëtojë për në vendin e tij, për t'u bashkuar me familjen e tij.</p> |
| <p>Neni 11</p>  | <p>Mbrojtja nga rrëmbimi</p> <p>Çdo shtet duhet të luftojë kundër rrëmbimit të fëmijës dhe largimit të tij në një vend tjetër dhe moskthimin e fëmijës nga një prind ose nga një person tjetër.</p> |
| <p>Neni 12</p>  | <p>E drejta e opinionit vetjak</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të dëgjoet dhe të shprehë mendimin e tij për të gjitha çështjet që lidhen me jetën e tij. Në mënyrë të veçantë, kjo ka vlerë ligjore ose në procedurat administrative. Sa më i rritur të jetë fëmija, aq më shumë duhet të dëgjoet mendimi i tij.</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Neni 13</p>  | <p>Liria e shprehjes</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtën të shprehë lirisht opinionin e tij dhe të marrë e të përhapë informacion përmes medias. Çdo fëmijë ka edhe përgjegjësinë për të shprehur mendimin e tij, duke respektuar edhe të drejtat e të tjerëve.</p> |
| <p>Neni 14</p>  | <p>Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të ushtrojë lirisht fenë e tij dhe të ushtrojë lirinë e mendimit dhe ndërgjegjes. Shteti duhet të respektojë të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve gjatë zbatimit të këtyre të drejtave.</p> |
| <p>Neni 15</p>  | <p>E drejta për grumbullime publike paqësore</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë për t'u bashkuar me fëmijë të tjerë, për të hyrë ose për të krijuar shoqata ose bashkime, për sa kohë në këtë proces nuk shkelin të drejtat e të tjerëve.</p> |
| <p>Neni 16</p>  | <p>Mbrojtja e jetës private</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë për të mos pasur ndërhyrje në jetën private, të familjes, të banesës ose të korrespondencës. Përveç kësaj, çdo fëmijë ka të drejtë që askush të mos dëmtojë figurën e tij.</p> |



Neni 17

E drejta për t'i siguruar informacionin e duhur

Çdo shtet duhet të sigurojë që çdo fëmijë të ketë mundësi reale për informacione përmes formave të ndryshme të medias dhe që ata të kenë mundësi të fitojnë njohuri që janë të rëndësishme për mirëqënien e tyre. Shteti ka detyrimin të mbrojë fëmijët nga informacionet e dëmshme.



Neni 18

Përgjegjësia e prindërve

Prindërit ose kujdestarët e fëmijëve janë përgjegjës për rritjen e fëmijës. Shteti ka përgjegjësinë t'i mbështesë ata në këtë, për shembull, të mundësojë kujdesin për fëmijët në rastet kur prindërit duhet të punojnë.



Neni 19

Të rinjtë pa familje





Çdo fëmijë që nuk jeton me familjen e tij, ka të drejtë për mbrojtje dhe mbështetje të veçantë. Ai ka të drejtë për një familje birësuese ose një institucion të përshatshëm që mban parasysh prejardhjen fetare, kulturore ose gjuhësore.



Neni 20

Mbrojtja nga abuzimet

Shteti është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimet e prindërve ose të njerëzve të tjerë. Ata kanë të drejtën të kenë një familje birësuese ose kujdes në institucione e dhura që marrin parasysh edhe prejardhjen fetare, kulturore e gjuhësore.

| | |
|---|---|
|  <p>Neni 21</p> | <p>Birësimi</p> <p>Një fëmijë mund të birësohet, nëse birësimi autorizohet, pranohet dhe aprovet nga vendi dhe nëse i shërben mirëqenies së fëmijës.</p> |
|  <p>Neni 22</p> | <p>Fëmijët refugjatë</p> <p>Çdo fëmijë, i cili është i detyruar të largohet nga vendi i tij, që është refugjat dhe kërkon azil, ka të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti.</p> |
|  <p>Neni 23</p> | <p>Fëmijët me aftësi të kufizuar</p> <p>Çdo fëmijë me aftësi të kufizuar ka të drejtën për kujdes dhe arsim të veçantë. Ai duhet të ndihmohet për të qenë i pavarur dhe për të marrë pjesë aktive në komunitetin të tij.</p> |
|  <p>Neni 24</p> | <p>Shërbimet shëndetësore dhe mjekësore</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë për kujdesin më të mirë të mundshëm mjekësor. Shteti ka detyrimin të luftojë vdekshmërinë foshnjore, të sigurojë mundësitë mjekësore për të rinjtë, të luftojë ushqimin e pamjaftueshëm dhe sëmundjet, të garantojë kujdes mjekësor për gratë shtatzëna dhe nënat e reja, të garantojë edukimin shëndetësor, të zhvillojë parandalimin në sektorin e shëndetit publik dhe të zhdukë zakonet që janë në dëm të fëmijëve.</p> |



Neni 25

Rishikimi i trajtimit ose kujdesit


Çdo fëmijë që ka qenë pranuar në një institucion për mbrojtjen, kujdesin ose trajtimin e tij ka të drejtë të kërkojë kontrollin dhe rishikimin e pranimit.



Neni 26

Sigurimi shoqëror

Çdo fëmijë ka të drejtën për siguri shoqërore, të tillë si sigurimet shoqërore. Shteti garanton pagesat për fëmijën, më varësi të situatës financiare të familjes ose të kujdestarit.



Neni 27

Standardi i jetesës

Çdo fëmijë ka të drejtë për një standard jetese në përputhje me zhvillimin e tij fizik, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Prindërit ose kujdestarët janë përgjegjës kryesorë për të siguruar një gjë të tillë. Shteti ka detyrimin t'i mbështesë ata.



Neni 28

Arsimi

Çdo fëmijë ka të drejtë të për arsimim dhe shkollim. Shteti ka detyrimin të bëjë arsimin bazë falas dhe detyruar dhe arsimin e mesëm të mundur për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Shteti ka detyrimin të sigurojë që fëmijët dhe të rinjtë të trajtohen si duhet në shkollë dhe të drejtat e tyre njerëzore të mos shkelen.



Neni 29

Qëllimet arsimore

Arsimimi shkollor duhet të zhvillojë personalitetin dhe talentin e çdo fëmije, të përgatisë çdo fëmijë për jetën e rritur dhe të nxisë fëmijët për të respektuar të drejtat e njeriut dhe të drejtat e tyre, si dhe kulturën dhe vlerat e të tjerëve.



Neni 30

Fëmijët e pakicave

Çdo fëmijë që i përket një pakice ka të drejtën të mësojë për kulturën, fenë dhe jetën e tij artistike dhe t'i ushtrojë ato.



Neni 31

Pushimi, loja dhe koha e lirë

Çdo fëmijë ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, në të cilën mund të luajë dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.



Neni 32

Puna e fëmijëve

Çdo fëmijë ka të drejtë për mbrojtje nga çdo formë e shfrytëzimit dhe pune, që mund të dëmtojë arsimimin dhe zhvillimin e tij. Shteti ka detyrimin të përcaktojë një moshë minimale të fëmijës për t'u lejuar të punojë dhe një numër orësh në ditë dhe kushte pune.



Neni 33

Mbrojtja nga drogat narkotike

Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga prodhimi dhe tregtimi i drogave të paligjshme.



Neni 34

Mbrojtja nga shfrytëzimi seksual

Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual dhe nga prostitucioni dhe pornografia.



Neni 35

Mbrojtja nga shitja dhe trafikimi





Shteti duhet të ndër marrë të gjitha masat në juridiksionin e tij, për të garantuar që fëmijët dhe të rinjtë të mos shiten dhe trafikohen.



Neni 36

Mbrojtja nga të gjitha format e tjera të shfrytëzimit

Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e tjera të shfrytëzimit (p.sh. të lypurit).

| | |
|---|---|
| <p>Neni 37</p>  | <p>Tortura dhe burgimi</p> <p>Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga tortura, trajtimi ose ndëshkimi mizor, arrestimi i paligjshëm ose nga çdo formë tjetër e shkeljes së lirisë personale. Shteti ka detyrimin të ndalojë dënimin me vdekje dhe burgimin e përjetshëm për të rinjtë. Nëse një fëmijë burgoset, ai ka të drejtën për trajtim njerëzor dhe me respekt. Nëse një fëmijë ose i ri arrestohet, ai duhet të mbahet i izoluar nga të rriturit, t'i mundësohet kontakti me fëmiljarët dhe të ketë të drejtë për mbrojtje ligjore.</p> |
| <p>Neni 38</p>  | <p>Lufta dhe konfliktet e armatosura</p> <p>Fëmijët dhe të rinjtë nën moshën 15 vjeç kanë të drejtë të mos përfshihen në luftë dhe në konflikte të armatosura. Shteti ka detyrimin të sigurojë mbrojtje të veçantë për fëmijët që janë të prekur nga lufta.</p> |
| <p>Neni 39</p>  | <p>Rehabilitimi dhe integrimi</p> <p>Çdo fëmijë, që është viktimë e konfliktit të armatosur, torturës, shpërfilljes dhe shfrytëzimit, ka të drejtë për kujdesin e duhur për riaftësimin e shëndetit të tij mendor dhe fizik dhe për integrimin e tij në një komunitet.</p> |
| <p>Neni 40</p>  | <p>Drejtësia për rininë</p> <p>Çdo fëmijë i akuzuar për një krim ka të drejtën të trajtohet me dinjitet në gjykatë. Ai është i pafajshëm, deri sa fajësia e tij të jetë provuar në gjykatë. Çdo fëmijë ka të drejtën për një gjyq të drejtë, një interpretues (nëse është e nevojshme), për mbrojtjen e jetës private dhe për apelim të vendimit të gjykatës. Shteti ka detyrimin të vendosë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët nuk mbajnë përgjegjësi penale. Shteti ka edhe detyrimin të ofrojë alternativa për ndëshkimin e fëmijëve dhe të rinjve, përveç burgosjes.</p> |

Fëmijët duhet të njohin të drejtat që kanë dhe edhe t'i vlerësojnë dhe t'i përdorin ato. Për të arritur këtë, shkolla duhet të lejojë përfshirjen e përvojave të larmishme të të mësuarit në edukimin për të drejtat e fëmijëve. Fëmijët kuptojnë dhe vlerësojnë të drejtat e tyre duke i ushtruar ato, si në shkollë ashtu edhe në jetën e përditshme. Kjo është sfidë e madhe për mësuesit, pasi ai duhet të krijojë një mjedis që qeveriset nga shpirti i demokracisë dhe i të drejtave të njeriut.

Ky manual është hartuar për mësuesit të cilët kërkojnë instrumente për t'u mësuar nxënësve të arsimit bazë të drejtat e fëmijëve. Të veçantën e këtij manuali e përbëjnë:

Një hyrje e shkurtër me informacion për kuadrin konceptual dhe për të mësuarit përmes shembullit.

Nëntë projekte të shkurtër për nxënësit, me nga katër mësimore secili, për t'u zhvilluar në nëntë vitet e para të shkollimit të tyre

Mësimore të hollësishme dhe plane mësimore

Qasja e të mësuarit me bazë detyre.

Shtojca me burime mësimore dhe informacion për të drejtat e fëmijëve (këtu përfshihet edhe

Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe një version i ilustruar i saj)

EQD/EDNJ Vëllimi I

Edukimi për demokraci - Materiale në ndihmë të mësuesve të edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut

EQD/EDNJ Vëllimi II

Rritimi në demokraci - Njësi mësimore për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut në arsimin fillor

EQD/EDNJ Vëllimi III

Të jetojmë në demokraci - Veprimtari mësimore për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut për arsimin e mesëm të ulët

EQD/EDNJ Vëllimi IV

Të marrim pjesë në demokraci - Njësi mësimore për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut në ciklin e mesëm të lartë

EQD/EDNJ Vëllimi V

Të eksplorojmë të drejtat e njeriut - Nëntë projekte të shkurtëra për arsimin fillor

EQD/EDNJ Vëllimi VI

Mësimdhënia e demokracisë - Një përmbledhje modelesh për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

<http://book.coe.int>
Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare, duke mbuluar pothuajse të gjithë kontinentin e Evropës. Ai kërkon të zhvillojë parime të përbashkëta demokratike dhe ligjore në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dokumente të tjera të referencë për mbrojtjen e individëve. Që kur ai u themelua në vitin 1949, pas Luftës së Dytë Botërore, Këshilli i Evropës ka simbolizuar pajtimin.